

32004L0018

Direktiva 2004/18/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 mars 2004, për koordinimin e procedurave për shpalljen fituese të kontratave për punë publike, furnizime dhe shërbime publike

Gazeta Zyrtare L 134, 30/04/2004 fq. 0114 - 0240

Direktivë 2004/18/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit datë 31 mars 2004, për koordinimin e procedurave për shpalljen fituese të kontratave për punë publike, furnizime dhe shërbime publike
PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe sidomos nenin 47 pika 2 dhe nenet 55 dhe 95 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [2],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit të Rajoneve [3],

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit [4], nisur nga teksti i përbashkët i miratuar nga Komisioni i Pajtimit më 9 dhjetor 2003,

Duke pasur parasysh se:

(1) Me rastin e ndryshimeve të reja që u janë bërë Direktivave të Këshillit 92/50/ KEE, datë 18 qershor 1992, në lidhje me koordinimin e procedurave për shpalljen fituese të kontratave për shërbime [5] publike, 93/36/ KEE , datë 14 qershor 1993, që koordinon procedurat për shpalljen fituese të kontratave për furnizime publike [6], dhe 93/37/KEE, datë 14 qershor 1993, në lidhje me koordinimin e procedurave për shpalljen fituese të kontratave për punë publike [7], të cilat janë të nevojshme për të plotësuar kërkesat për thjeshtësim dhe modernizim të bëra nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomikë në përgjigjet e tyre ndaj Librit të Gjelbër të miratuar nga Komisioni në 27 nëntor 1996, direktiva, për hir të qartësisë, duhet të riformulohet. Kjo direktivë bazohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës të Drejtësisë, sidomos në praktikën gjyqësore për kriteret e shpalljes së kontratës fituese, e cila qartëson mundësinë që autoritetet kontraktuese të plotësojnë nevojat e publikut, duke përfshirë fushën e mjedisit dhe/ose sociale, me kusht që këto kriteret të lidhen me objektin e kontratës, të mos i japin autoritetit kontraktues liri të pakufizuar të zgjedhjes, të përmenden shprehimisht dhe të respektojnë parimet themelore të përmendura në deklamimin 2.

(2) Shpallja fituese e kontratave të lidhura në Shtetet Anëtare në emër të autoriteteve shtetërore, rajonale ose vendore, dhe organeve të tjera që rregullohen nga e drejta publike, i nënshtrohet respektimit të parimeve të Traktatit dhe sidomos parimit të lirisë së lëvizjes së mallrave, parimit të lirisë së vendosjes dhe parimit të lirisë së ofrimit të shërbimeve dhe parimeve që rrjedhin prej tyre, siç janë parimi i trajtimit të barabartë, parimi i mosdiskriminimit, parimi i njohjes së ndërsjellë, parimi i proporcionalitetit dhe parimi i transparencës. Megjithatë, për kontratat publike mbi një vlerë të caktuar, këshillohet të hartohen dispozita për koordinimin komunitar të procedurave kombëtare për shpalljen fituese të këtyre kontratave, të cilat bazohen në këto parime, me qëllim që të sigurohen efektet e tyre dhe të garantohet hapja e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Prandaj këto dispozita koordinuese duhet të interpretohen në përputhje me rregullat dhe parimet e sipërpërmendura dhe rregullat e tjera të Traktatit.

(3) Këto dispozita koordinuese duhet të përputhen sa më shumë të jetë e mundur me procedurat dhe praktikat ekzistuese në çdo Shtet Anëtar.

(4) Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që pjesëmarrja e një organi që rregullohet nga e drejta publike si ofertues në një procedurë për fitimin e një kontrate publike të mos shkaktojë shtrembërim të konkurrencës në lidhje me ofertues privatë.

(5) Sipas nenit 6 të Traktatit, kërkesat e mbrojtjes mjedisore duhet të integrohen me përkufizimin dhe zbatimin e politikave dhe veprimtarive komunitare të përmendura në nenin 3 të atij Traktati, në veçanti për të nxitur zhvillim të qëndrueshëm. Prandaj kjo direktivë qartëson sesi autoritetet kontraktuese mund të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, duke siguruar ndërkohë mundësinë për të marrë vlerën më të mirë monetare për kontratat e tyre.

(6) Asnjë dispozitë e kësaj direktive nuk duhet të pengojë marrjen ose zbatimin e masave të nevojshme për të mbrojtur politikat publike, moralin publik, sigurinë publike, shëndetin, jetën e njeriut dhe të kafshëve ose ruajtjen e jetës së bimëve sidomos me qëllim arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm me kusht që këto masa të jenë në përputhje me Traktatin.

(7) Vendimi i Këshillit 94/800/KE, datë 22 dhjetor 1994, për lidhjen, në emër të Komunitetit Europian sa u përket çështjeve brenda kompetencës së tij, e marrëveshjeve të arritura në negociatat shumëpalëshe të Raundit të Uruguajt (1986-1994) [8], miraton në veçanti Marrëveshjen e OBT-së për Prokurimin Publik, quajtur më poshtë “Marrëveshja”, qëllimi i së cilës është të krijojë një kuadër shumëpalësh të të drejtave dhe detyrimeve të ekuilibruara në lidhje me kontratat publike me qëllim realizimin e liberalizimit dhe zgjerimit të tregtisë botërore.

Nisur nga të drejtat dhe angazhimet ndërkombëtare që merr përsipër Komuniteti si rezultat i pranimit të marrëveshjes, rregullimet që duhet të zbatohen për ofertuesit dhe produktet nga vende të treta nënshkruese janë ato që përcakton marrëveshja. Kjo marrëveshje nuk ka efekt të drejtpërdrejtë. Autoritetet kontraktuese që mbulon marrëveshja të cilat respektojnë këtë direktivë dhe e zbatojnë këtë të fundit për operatorët ekonomik të vendeve të treta që janë palë nënshkruese e marrëveshjes, duhet të respektojnë marrëveshjen. Gjithashtu është me vend që ato dispozita koordinuese të garantojnë për operatorët ekonomik të Komunitetit kushte për pjesëmarrje në prokurimin publik, që janë po aq favorizuese sa ato që rezervohen për operatorët ekonomikë të vendeve të treta, të cilat janë palë nënshkruese të marrëveshjes.

(8) Përpara fillimit të një procedure për shpalljen e një kontrate fituese, autoritetet kontraktuese, me anë të dialogut teknik, mund të kërkojnë ose pranojnë këshilla të cilat mund të përdoren në përgatitjen e specifikimeve, me kusht që këto këshilla të mos pengojnë konkurrencën.

(9) Nisur nga larmia e kontratave për punë publike, autoritetet kontraktuese duhet të jenë në gjendje të parashikojnë kontrata për projektim dhe ekzekutim të punimeve të cilat fitohen veçmas ose bashkërisht. Kjo direktivë nuk ka për qëllim të përcaktojë kontrata fituese të përbashkëta apo të veçanta. Vendimi për kontratën fituese, veçmas ose bashkërisht, duhet të vendoset bazuar në kritere ekonomike dhe cilësore, që mund të përcaktohen nga legjislacioni kombëtar.

(10) Një kontratë konsiderohet kontratë për punë publike vetëm nëse objekti i saj mbulon në mënyrë specifike kryerjen e veprimtarive të renditura në Shtojcën I, edhe nëse kontrata mbulon ofrimin e shërbimeve të tjera të nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive. Kontratat për shërbime publike, në veçanti në fushën e shërbimeve të menaxhimit të pronës, në disa rrethana mund të përfshijnë punimet. Megjithatë, nëse këto punime janë të rastësishme për objektin parësor të kontratës dhe janë pasojë e mundshme e tyre ose plotësim i tyre, fakti që këto punime janë përfshirë në kontratë nuk justifikon cilësimin e kontratës si një kontratë për punë publike.

(11) Duhet të parashikohet një përkufizim komunitar i marrëveshjeve kuadër, së bashku me rregullat specifike për marrëveshjet kuadër të lidhura për kontratat që përfshihen në fushën e veprimit të kësaj direktive. Sipas këtyre rregullave, nëse një autoritet kontraktues lidh një marrëveshje kuadër në përputhje me dispozitat e kësaj direktive, sidomos në lidhje me shpalljen, afatet kohore dhe kushtet për paraqitjen e ofertave, ai mund të lidhë kontrata bazuar në këtë marrëveshje kuadër gjatë kohës së vlefshmërisë së saj, ose duke zbatuar kushtet e paraqitura në marrëveshjen kuadër, ose, nëse të gjitha kushtet nuk janë vendosur paraprakisht në marrëveshjen kuadër, duke rihapur konkurrencën ndërmjet

palëve në marrëveshjen kuadër në lidhje me ato kushte. Rihapja e konkurrencës duhet të përputhet me disa rregulla qëllimi i të cilave është garantimi i fleksibilitetit të kërkuar dhe garantimi i respektimit për parimet e përgjithshme, sidomos parimit të trajtimit të barabartë. Për të njëjtat arsye, afati i marrëveshjeve kuadër nuk duhet të kalojë katër vjet, përveç rasteve të justifikuara siç duhet nga autoritetet kontraktuese.

(12) Teknika të reja të blerjes elektronike po zhvillohen në vazhdimësi. Këto teknika ndihmojnë rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të blerjes publike, sidomos sa i përket kursimeve në kohë dhe parë që do të mundësojë përdorimi i tyre. Autoritetet kontraktuese mund të përdorin teknika të blerjes elektronike, nëse përdorimi i tyre respekton rregullat e hartuara sipas kësaj direktive, parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës. Në këtë masë, një ofertë e paraqitur nga ofertuesi, sidomos nëse konkurrenca është hapur përsëri sipas një marrëveshjeje kuadër, ose nëse përdoret sistemi dinamik i blerjes, mund të marrë formën e katalogut elektronik të ofertuesit, nëse ky i fundit përdor mjetet e komunikimit të zgjedhura nga autoriteti kontraktues në përputhje me nenin 42.

(13) Nisur nga shtrirja e shpejtë e sistemeve të blerjes elektronike, duhet të prezantohen rregullat e duhura për të bërë të mundur që autoritetet kontraktuese të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e ofruara nga këto sisteme. Kundrejt këtij sfondi, është e nevojshme të përcaktohet një sistem dinamik blerjeje, tërësisht elektronik, për blerje të zakonshme si edhe të përcaktohen rregullat specifike për krijimin dhe funksionimin e një sistemi të tillë, me qëllim që të sigurohet trajtim i drejtë i çdo operatori ekonomik që dëshiron të marrë pjesë në të. Çdo operator ekonomik që paraqet një ofertë indikative në përputhje me specifikimin dhe plotëson kriteret e përzgjedhjes duhet të lejohet të futet në këtë sistem. Kjo teknikë blerjeje lejon autoritetin kontraktues, nëpërmjet krijimit të një liste të ofertuesve të përzgjedhur tashmë dhe mundësisë që u jepet ofertuesve të rinj për të marrë pjesë, të ketë një gamë veçanërisht të gjerë ofertash, si rezultat i lehtësirave elektronike në dispozicion, dhe të sigurojë në këtë mënyrë përdorimin optimal të fondeve publike nëpërmjet konkurrencës me bazë të gjerë.

(14) Meqë përdorimi i teknikës së ankandeve elektronike ka mundësi të shtohet, këto ankande duhet të kenë një përkufizim komunitar dhe të rregullohen me rregulla specifike, me qëllim që të sigurohet funksionimi i tyre i plotë në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës. Për këtë qëllim, duhet parashikuar që këto ankande elektronike të trajtojnë vetëm kontratat për punime, furnizime ose shërbime për të cilat mund të përcaktohen me saktësi specifikimet. I tillë mund të jetë sidomos rasti i kontratave të përsëritura për shërbime, punime dhe furnizime. Me të njëjtin objektiv, duhet të mundësohet gjithashtu përcaktimi i renditjes përkatëse të ofertuesve në çdo fazë të ankandit elektronik. Përdorimi i ankandeve elektronike bën të mundur që autoritetet kontraktuese t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin çmime të reja, të ulura dhe të përmirësojnë gjithashtu elemente të ofertave, përveç çmimeve, në rastin kur kontratën e ka fituar oferta me përfitim më të madh ekonomik. Për të garantuar respektimin e parimit të transparencës, objekt i ankandit elektronik mund të jenë vetëm elementet e përshtatshme për vlerësim automatik nëpërmjet mjeteve elektronike, pa ndërhyrje dhe/ose pa vlerësim nga autoriteti kontraktues, pra, vetëm elementet që janë të matshme, në mënyrë që të mund të shprehen në shifra ose përqindje. Nga ana tjetër, ato aspekte të ofertave që nënkuptojnë një vlerësim të elementeve josasiore nuk duhet të jenë objekt i ankandeve elektronike. Rrjedhimisht, disa kontrata për punë dhe disa kontrata për shërbime që kanë si objekt punë intelektuale, si projektimin e punimeve, nuk duhet të jenë objekt i ankandeve elektronike.

(15) Në Shtetet Anëtare janë zhvilluar disa teknika të blerjes së përqëndruar. Disa autoritete kontraktuese janë përgjegjëse për blerjen ose për shpalljen fituese të kontratave publike/marrëveshjeve kuadër për autoritete të tjera kontraktuese. Nisur nga vëllimi i madh i blerë, këto teknika duhet të ndihmojnë në rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të blerjes publike. Prandaj duhet parashikuar një përkufizim komunitar për organet qendrore blerëse që u është dhënë kompetenca e të qenit autoritet kontraktues. Duhet të përkufizohen kushtet sipas të cilave, në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, autoritetet kontraktuese që blejnë

punime, furnizime dhe/ose shërbime nëpërmjet një organi qendror blerës, të konsiderohen se respektojnë këtë direktivë.

(16) Shtetet Anëtare, për të marrë parasysh rrethanat e ndryshme në Shtetet Anëtare, duhet të lejohen të zgjedhin nëse autoritetet kontraktuese mund të përdorin marrëveshje kuadër, organe qendrore blerëse, sisteme dinamike blerjeje, ankande elektronike ose procedura të dialogut konkurrues, siç përkufizohet dhe rregullohet në këtë direktivë.

(17) Shumëfishimi i numrit të kufijve monetarë për zbatimin e dispozitave koordinuese i ndërlikon çështjet për autoritetet kontraktuese. Gjithashtu, në kuadër të bashkimit monetar, këta kufij monetarë duhet të përcaktohen në euro. Gjithashtu, këta kufij monetarë duhet të përcaktohen në euro në mënyrë të tillë që të thjeshtojnë zbatimin e dispozitave duke siguruar në të njëjtën kohë respektimin e kufijve monetarë të përcaktuar në marrëveshje, të shprehur në të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes. Në këtë kontekst, duhen parashikuar dhe rishikime të vazhdueshme të kufirit monetar të shprehur në euro për ta përshtatur atë, kur është e nevojshme, në përputhje me variacionet e mundshme në vlerën e euros në lidhje me Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes.

(18) Me qëllim zbatimin e rregullave procedurale të kësaj direktive dhe monitorimin, fusha e shërbimeve është kufizuar më mirë, duke u ndarë në nënkategori që u korrespondojnë zërave të veçantë të një klasifikimi të përbashkët dhe duke i bashkuar ato në dy Shtojca, II A dhe II B, sipas regjimit të cilit i nënshtrohen. Në lidhje me shërbimet në Shtojcën II B, dispozitat përkatëse të kësaj direktive nuk duhet të prekin zbatimin e rregullave komunitare specifike për shërbimet në fjalë.

(19) Në lidhje me kontratat për shërbime publike, zbatimi i plotë i kësaj direktive për një periudhë kalimtare duhet të bëhet vetëm për kontratat për të cilat dispozitat e kësaj direktive do të mundësojnë realizimin e potencialit të plotë për tregtinë e përforcuar ndërkuftare. Kontratat për shërbimet e tjera duhet të monitorohen gjatë kësaj periudhe kalimtare përpara se të merret një vendim për zbatimin e plotë të kësaj direktive. Në këtë drejtim, duhet të përcaktohet mekanizmi për këtë monitorim. Në të njëjtën kohë, ky mekanizëm duhet të bëjë të mundur që palët e interesuara të kenë liri hyrjeje në informacionin përkatës.

(20) Kontratat publike që shpallen fituese nga autoritetet kontraktuese që veprojnë në sektorët e shërbimit uhor, energjetik, të transportit dhe postar dhe që përfshihen në fushën e veprimit të këtyre veprimtarive mbulohen nga Direktiva 2004/17/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 mars 2004, që koordinon procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorët e shërbimit uhor, energjetik, të transportit dhe postar [9]. Megjithatë, kontratat e shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese në kuadër të veprimtarive të tyre të shërbimit për transportin detar, bregdetar ose lumor, duhet të përfshihen në fushën e veprimit të kësaj direktive.

(21) Nisur nga situata e konkurrencës efektive në treg në sektorin e telekomunikacionit pas zbatimit të rregullave komunitare që synojnë liberalizimin e këtij sektori, kontratat publike në këtë fushë duhet të përjashtohen nga fusha e veprimit të kësaj direktive për aq sa ato synojnë të lejojnë kryesisht autoritetet kontraktuese të ushtrojnë disa veprimtari në sektorin e telekomunikacionit. Këto veprimtari janë përkufizuar në përputhje me përkufizimet e përdorura në nenet 1, 2 dhe 8 të Direktivës së Këshillit 93/38/KEE, datë 14 qershor 1993, që koordinon procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorin uhor, energjetik, të transportit dhe të telekomunikacionit [10], në mënyrë të tillë që kjo direktivë të mos zbatohet për kontratat që janë përjashtuar nga fusha e veprimit të Direktivës 93/38/KEE sipas nenit 8 të saj.

(22) Duhet parashikuar rastet kur është e mundur të mos zbatohen masat për koordinimin e procedurave për arsye që lidhen me sigurinë e shtetit ose me ruajtjen e sekretit, ose për shkak se zbatohen rregulla specifike për shpalljen e kontratave fituese që rrjedhin nga marrëveshje ndërkombëtare, në lidhje me stacionimin e trupave, ose që janë specifike për organizatat ndërkombëtare.

(23) Sipas nenit 163 të Traktatit, inkurajimi i kërkimit dhe zhvillimit teknologjik është mjet për forcimin e bazës shkencore dhe teknologjike të industrisë së Komunitetit dhe hapja e kontratave për shërbime publike kontribuon për këtë qëllim. Kjo direktivë nuk duhet të mbulojë bashkëfinancimin e programeve të kërkimit dhe zhvillimit: po kështu kjo direktivë nuk mbulon kontratat për kërkim dhe zhvillim të ndryshme nga ato në të cilat përfitimet i përkasin në mënyrë ekskluzive autoritetit kontraktues që t'i përdorë në kryerjen e veprimtarive të tij, me kushtin që shërbimi i ofruar të shpërblehet tërësisht nga autoriteti kontraktues.

(24) Në kuadër të shërbimeve, kontratat për blerjen ose marrjen me qira të pronës së paluajshme ose të drejtave mbi këto prona, kanë karakteristika të veçanta që e bëjnë të papërshtatshëm zbatimin e rregullave të prokurimit publik.

(25) Shpallja fituese e kontratave publike për disa shërbime audiovizive në fushën e transmetimit, duhet të lejojë marrjen parasysh të aspekteve të rëndësishme kulturore ose sociale që e bëjnë të papërshtatshëm zbatimin e rregullave të prokurimit. Për këto arsye, duhet të bëhet një përjashtim për kontratat për shërbime publike për blerje, zhvillim, prodhim ose bashkëprodhim të programeve gati për t'u shpërndarë dhe shërbime të tjera përgatitore, si ato që lidhen me skenarin ose interpretimin artistik të nevojshme për prodhimin e programit dhe kontratat në lidhje me kohën e transmetimit. Megjithatë, ky përjashtim nuk duhet të zbatohet për sigurimin e pajisjes teknike të nevojshme për prodhimin, bashkëprodhimin dhe transmetimin e këtyre programeve. Transmetimi duhet të përkufizohet si transmetim dhe shpërndarje nëpërmjet çdo forme të rrjetit elektronik.

(26) Shërbimet e arbitrazhit dhe ndërmjetësimit zakonisht ofrohen nga organe ose individë të përcaktuar ose të përzgjedhur, në një mënyrë që nuk mund të rregullohen nga rregullat e prokurimit.

(27) Në përputhje me marrëveshjen, shërbimet financiare që mbulon kjo direktivë nuk përfshijnë instrumente të politikave monetare, kurset e këmbimit, borxhin publik, politikat e menaxhimit të rezervave ose politika të tjera që kanë të bëjnë me transaksionet me letrat me vlerë ose instrumentet e tjera financiare, sidomos transaksionet nga autoritetet kontraktuese për të siguruar fonde ose kapital. Nuk mbulohen kontratat në lidhje me nxjerrjen, blerjen, shitjen ose transferimin e letrave me vlerë ose instrumenteve të tjera financiare. Përjashtohen shërbimet e Bankës Qendrore.

(28) Punësimi dhe zënia me punë janë elemente kyçe në garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë dhe kontribuojnë për integrimin në shoqëri. Në këtë kontekst, strehëzat e punës dhe programet e punësimit në strehëza kontribuojnë në mënyrë të efektshme në integrimin ose riintegrimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës. Megjithatë, këto strehëza pune mund të mos jenë në gjendje të sigurojnë kontrata në kushtet normale të konkurrencës. Rrjedhimisht, duhet të parashikohet që Shtetet Anëtare të rezervojnë për këto strehëza pune të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e shpalljes fituese të kontratave publike ose të rezervojnë zbatimin e kontratave në kuadër të programeve të punësimit në strehëzat e punës.

(29) Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publikë duhet të lejojnë që prokurimi publik të jetë i hapur ndaj konkurrencës. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur paraqitja e ofertave që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Në këtë linjë, duhet të jetë i mundur hartimi i specifikimeve teknike sa u përket kërkesave të zbatimit dhe funksionale dhe, nëse bëhet lidhje me standardet europiane, ose me standardet kombëtare në mungesë të të parave, autoritetet kontraktuese duhet t'i shqyrtojnë ofertat bazuar në të njëjtat rregulla. Për të dëshmuar barasvlershmërinë, ofertuesve u duhet lejuar përdorimi i çdo lloji prove. Autoritetet kontraktuese duhet të jenë në gjendje të japin arsyetimin për çdo konstatim të pabarasvlershmërisë në një rast të caktuar. Autoritetet kontraktuese që dëshirojnë të përcaktojnë kërkesa mjedisore për specifikimet teknike në një kontratë të caktuar mund të përcaktojnë karakteristikat mjedisore, si për shembull një metodë të caktuar prodhimi, dhe/ose pasojat specifike mjedisore të grupeve ose shërbimeve të prodhimit. Ato mund të përdorin, por nuk janë të detyruara të përdorin, specifikimet e duhura që janë përcaktuar në eko-etiketë, siç janë eko-etiketa europiane, eko-etiketa (shumë) kombëtare dhe çdo eko-etiketë tjetër nëse kërkesat për etiketë hartohen dhe miratohen në bazë të informacionit specifik nëpërmjet një procedure sipas të cilës mund të marrin pjesë, aktorët, që mund të jenë organet e qeverisë, konsumatorët, prodhuesit, shpërndarësit dhe

organizatat mjedisore dhe me kusht që etiketa të jetë e dukshme dhe në dispozicion të palëve të interesuara. Autoritetet kontraktuese, kur është e mundur, duhet të përcaktojnë specifikime teknike për të marrë parasysh mundësinë e përdorueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose të projektimit për të gjithë përdoruesit. Specifikimet teknike duhet të tregohen qartë, në mënyrë që të gjithë ofertuesit të dinë se çfarë mbulojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktues.

(30) Informacion shtesë në lidhje me kontratat, siç ndodh zakonisht në Shtetet Anëtare, duhet të jepet në dokumentet e kontratave për çdo kontratë ose në një dokument tjetër të njëjtë.

(31) Autoritetet kontraktuese që realizojnë projekte veçanërisht të ndërlikuara mund ta kenë objektivisht të pamundur, jo për faj të tyre, të përcaktojnë mjetet e plotësimit të nevojave të tyre ose të vlerësojnë atë që mund të ofrojë tregu për zgjidhjet teknike dhe/ose zgjidhjet financiare/ligjore. Kjo situatë mund të krijohet sidomos për zbatimin e projekteve të rëndësishme të transportit të integruar, rrjeteve të mëdha kompjuterike ose projekteve që përfshijnë financim kompleks dhe të strukturuar, financimi dhe kuadri ligjor i të cilave nuk mund të përcaktohet paraprakisht. Në masën që përdorimi i procedurave të hapura ose të kufizuara nuk lejon shpalljen fituese të këtyre kontratave, duhet të parashikohet një procedurë fleksibël që të ruajë jo vetëm konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, por dhe nevojën që autoritetet kontraktuese të diskutojnë të gjitha aspektet e kontratës me çdo kandidat. Megjithatë, kjo procedurë nuk duhet përdorur në mënyrë të tillë që të kufizojë ose të shtrembërojë konkurrencën, sidomos nëpërmjet ndryshimit të aspekteve themelore të ofertave, nëpërmjet vendosjes së kërkesave të reja thelbësore për ofertuesin e suksesshëm ose nëpërmjet përfshirjes së një ofertuesi tjetër të ndryshëm nga ai i përzgjedhur si me përfitim më të madh ekonomik.

(32) Për të inkurajuar përfshirjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në tregun e prokurimit të kontratave publike, këshillohet të përfshihen dispozitat e nënkontraktimit.

(33) Kushtet e zbatimit të kontratës janë në përputhje me këtë direktivë nëse nuk janë drejtpërdrejt apo tërthorazi diskriminuese dhe nëse tregohen në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e kontratës. Ato, në veçanti mund të synojnë favorizimin e trajnimit profesional në terren, punësimin e personave që kanë vështirësi të veçantë në arritjen e integritit, luftës kundër papunësisë ose mbrojtjen e mjedisit. Për shembull, duhen përmendur, mes të tjerash, kërkesat e zbatueshme gjatë zbatimit të kontratës për të rekrutuar punëkërkes afatgjatë ose për të zbatuar masa trajnimi për të papunët a të rinjtë, me qëllim që të respektohen në thelb dispozitat e konventave bazë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP), duke supozuar që këto dispozita nuk janë zbatuar në të drejtën kombëtare dhe për të rekrutuar persona me aftësi të kufizuara fizike më shumë sesa kërkohet sipas legjisllacionit kombëtar.

(34) Ligjet, rregulloret dhe marrëveshjet kolektive, në nivel kombëtar dhe komunitar, që janë në fuqi në fushat e kushteve të punësimit dhe të sigurisë në punë zbatohen gjatë zbatimit të kontratës publike, nëse këto rregulla dhe zbatimi i tyre, përputhen me të drejtën komunitare. Në situata ndërkufitare, ku punëtorët nga një Shtet Anëtar ofrojnë shërbime në një Shtet tjetër Anëtar me qëllim zbatimin e një kontrate publike, Direktiva 96/71/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 16 dhjetor 1996, në lidhje me dërgimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve [11] përcakton kushtet minimale që duhen respektuar nga vendi pritës në lidhje me këta punëtorë të dërguar. Nëse legjisllacioni kombëtar përmban dispozita për këtë qëllim, mosrespektimi i këtyre detyrimeve mund të konsiderohet shkelje e rëndë ose vepër penale në lidhje me etikën profesionale të operatorit ekonomik të përfshirë, që çon në përjashtimin e atij operatori ekonomik nga procedura për shpalljen fituese të kontratës publike.

(35) Nisur nga zhvillimet e reja në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit dhe thjeshtimet që këto mund të sjellin në lidhje me publikimin e kontratave dhe efikasitetin dhe transparencën e proceseve të prokurimit, mjetet elektronike duhet të vihen në një nivel me mjetet tradicionale të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit. Sa të jetë e mundur, mjetet dhe teknologjia e zgjedhur duhet të përputhen me teknologjitë e përdorura në Shtete të tjera Anëtare.

(36) Për të siguruar zhvillimin e konkurrencës efektive në fushën e kontratave publike, është e nevojshme që njoftimet e kontratave të hartuara nga autoritetet kontraktuese të Shtetit Anëtar të shpallen në gjithë Komunitetin. Informacioni që përmbajnë këto njoftime duhet të bëjë të mundur që operatorët ekonomikë në Komunitet të vendosin nëse janë apo jo me interes për ata kontratat e propozuara. Për këtë qëllim, duhet që atyre t'u jepet informacion i përshtatshëm për objektin e kontratës dhe kushtet e saj. Prandaj duhet të sigurohet rritja e pranisë së dukshme për njoftimet publike me anë të instrumenteve të përshtatshme, siç janë formularët standardë të njoftimit të kontratës dhe Fjalori i Përbashkët për Prokurimet (FPP) i parashikuar në Rregulloren (KE) nr. 2195/2002 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit [12] si nomenklatura referencë për kontratat publike. Në procedura të kufizuara, njoftimi synon veçanërisht të mundësojë që sipërmarrësit e Shteteve Anëtare të shprehin interesin e tyre në kontrata duke kërkuar nga autoritetet kontraktuese ftesa për ofertë sipas kushteve të kërkuara.

(37) Direktiva 1999/93/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 13 dhjetor 1999, për një kuadër komunitar për nënshkrimet elektronike [13] dhe Direktiva 2000/31/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 8 qershor 2000, për disa aspekte ligjore të shërbimeve të shoqërisë së informacionit, sidomos tregtisë elektronike, në tregun e brendshëm ("Direktiva për tregtinë elektronike") [14] duhet të zbatohen, në kuadër të kësaj direktive, për përcjelljen e informacionit me mjete elektronike. Procedurat e prokurimit publik dhe rregullat e zbatueshme për konkurse shërbimi kërkojnë një nivel sigurie dhe konfidencialiteti më të lartë se ai që kërkohet nga këto direktiva. Në përputhje me këtë, pajisjet për marrjen elektronike të ofertave, kërkesave për pjesëmarrje dhe planeve dhe projekteve duhet të jenë në përputhje me kërkesa specifike shtesë. Për këtë qëllim, duhet të inkurajohet, sa më shumë të jetë e mundur, përdorimi i nënshkrimeve elektronike, sidomos nënshkrimeve elektronike të avancuara. Gjithashtu, skemat e akreditimit vullnetar duhet të përbëjnë një kuadër të favorshëm për të rritur nivelin e ofrimit të shërbimit të certifikimit për këto pajisje.

(38) Përdorimi i mjeteve elektronike çon në kursimin e kohës. Si rezultat, duhet parashikuar shkurtimi i afateve minimale nëse përdoren mjetet elektronike, që megjithatë i nënshtrohen kushtit që duhet të jenë në përputhje me mënyrën specifike të transmetimit të parashikuar në nivel komunitar.

(39) Verifikimi i përshtatshmërisë së ofertuesve në procedura të hapura dhe të kandidatëve në procedura të kufizuara dhe me negociim me publikimin e një njoftimi kontrate dhe në dialogun konkurrues, dhe përzgjedhja e tyre duhet të bëhet në kushte transparente. Për këtë qëllim, duhet të tregohen kritere mosdiskriminuese, të cilat mund t'i përdorin autoritetet kontraktuese kur përzgjedhin konkurruesit, dhe mjetet që mund të përdorin operatorët ekonomikë për të provuar që i kanë plotësuar këto kritere. Në të njëjtën frymë të transparencës, autoritetit kontraktues duhet t'i kërkohet të tregojë kriteret që do të përdorë sapo kontrata të nxirret për konkurrim dhe niveli i aftësive specifike që mund të kërkojë ose jo nga operatori ekonomik përpara se t'i pranojë në procedurën e prokurimit.

(40) Autoriteti kontraktues mund ta kufizojë numrin e kandidatëve në procedura të kufizuara dhe me negociim me publikimin e një njoftimi kontrate dhe në dialog konkurrues. Kjo ulje e numrit të kandidatëve duhet të bëhet në bazë të kriterëve objektive të treguara në njoftimin e kontratës. Këto kritere objektive jo domosdoshmërisht nënkuptojnë shkallë rëndësie. Për kriteret në lidhje me situatën personale të operatorëve ekonomikë, mund të mjaftojë përmendja në mënyrë të përgjithshme në njoftimin e kontratës, e situatave të përcaktuara në nenin 45.

(41) Në dialogun konkurrues dhe në procedura me negociim me publikimin e një njoftimi kontrate, nisur nga fleksibiliteti që mund të kërkohet dhe niveli i lartë i kostove që lidhen me këto metoda prokurimi, autoritetet kontraktuese duhet të kenë të drejtë të parashikojnë që procedura të kryhet në fazat vijuese me qëllim që të reduktohet gradualisht, në bazë të kriterëve të mëparshme për kriteret e përcaktuara të shpalljes së kontratës fituese, të ulet numri i ofertave që do të diskutohen ose negocohen. Ky shkurtim, në masën që e lejon numri i zgjidhjeve të mundshme ose kandidatëve, duhet të sigurojë konkurrencën e vërtetë.

(42) Rregullat e rëndësishme komunitare për njohjen e ndërsjellë të diplomave, dëshmive ose provave të tjera të kualifikimeve formale zbatohen, nëse për pjesëmarrje në një procedurë prokurimi ose një konkurs projektimi kërkohen prova për një kualifikim të veçantë.

(43) Duhet të shmangët shpallja e kontratave fituese për operatorë ekonomikë që kanë marrë pjesë në organizata kriminale ose që janë shpallur fajtor për korrupsion a mashtrim në dëm të interesave financiare të Komuniteteve Europiane a për pastrim parash. Sipas rastit, autoritetet kontraktuese duhet t'u kërkojnë kandidatëve ose ofertuesve të paraqesin dokumente përkatëse dhe, kur kanë dyshime për situatën personale të një kandidati ose ofertuesi, ato mund të kërkojnë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar të përfshirë. Përgjashtimi i këtyre operatorëve ekonomikë duhet të bëhet sapo autoriteti kontraktues të vihet në dijeni për një vendim në lidhje me vepra penale të kryera sipas legjislacionit kombëtar që ka forcën *res judicata*. Nëse legjislacioni kombëtar përmban dispozita për këtë qëllim, mosrespektimi i legjislacionit mjedisor ose i legjislacionit për marrëveshjet e paligjshme në kontratat publike, i cili ka qenë objekt i një vendimi të formës së prerë ose i një vendimi që ka efekt të njëjtë, mund të konsiderohet vepër penale në lidhje me etikën profesionale të operatorit ekonomik në fjalë ose shkelje e rëndë.

Mosrespektimi i dispozitave kombëtare në zbatim të Direktivave të Këshillit 2000/78/KE [15] dhe 76/207/KEE [16] në lidhje me trajtimin e barabartë të punonjësve, që ka qenë subjekt i një vendimi të formës së prerë ose vendimi me efekt të njëjtë, mund të konsiderohet vepër penale në lidhje me etikën profesionale të operatorit ekonomik në fjalë ose shkelje e rëndë.

(44) Në rastet e duhura, ku natyra e punimeve dhe/ose shërbimeve justifikon zbatimin e masave ose skemave të menaxhimit mjedisor gjatë zbatimit të një kontrate publike, mund të kërkohet zbatimi i këtyre masave ose skemave. Skemat e menaxhimit mjedisor, të regjistruara apo jo sipas instrumenteve komunitare të tilla si Rregullorja (KE) nr. 761/2001 [17] (EMAS), mund të tregojnë që operatori ekonomik e ka aftësinë teknike për të zbatuar kontratën. Gjithashtu, një përkrahim i masave të zbatuara nga operatori ekonomik për të siguruar të njëjtin nivel të mbrojtjes mjedisore duhet të pranohet si alternativë për skemat e regjistrimit të menaxhimit mjedisor si një lloj prove.

(45) Kjo direktivë u jep mundësi Shteteve Anëtare që të krijojnë lista zyrtare të kontraktuesve, furnizuesve ose ofruesve të shërbimit ose një sistem të certifikimit nga organe shtetërore ose private, dhe parashikon pasojat e këtij regjistrimi ose certifikimi në një procedurë të shpalljes së kontratës fituese në një Shtet tjetër Anëtar. Në lidhje me listat zyrtare të operatorëve ekonomikë të miratuar, është e rëndësishme të merret parasysh praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë, nëse një operator ekonomik që i përket një grupi kërkon aftësitë financiare ose teknike të shoqërive të tjera të grupit në mbështetje të kërkesës së tij për regjistrim. Në këtë rast, i takon operatorit ekonomik të provojë që këto burime në fakt do të jenë në dispozicion gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së regjistrimit. Për qëllimet e këtij regjistrimi, një Shtet Anëtar mund të përcaktojë nivelin e kërkesave që duhet të plotësohen, dhe sidomos, për shembull nëse operatori kërkon të drejtat e veta mbi burimet financiare të një shoqërie tjetër tregtare të grupit, mund të kërkojë që kjo shoqëri të mbajë përgjegjësi ligjore, nëse është e nevojshme, bashkërisht dhe veçmas.

(46) Kontratat duhet të shpallen fituese në bazë të kriterëve objektive që sigurojnë respektimin e parimit të transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë dhe që garantojnë vlerësimin e ofertave në kushtet e konkurrencës efektive. Si rezultat, duhet të lejohet zbatimi vetëm i dy kriterëve për shpalljen e fituesit: “çmimi më i ulët” dhe “oferta me përfitim më të madh ekonomik”.

Për të siguruar respektimin e parimit të trajtimit të barabartë në shpalljen e kontratës fituese, duhet përcaktuar detyrimi i krijuar nga praktika gjyqësore për të siguruar transparencën e nevojshme, me qëllim që të gjithë ofertuesit të informohen në mënyrë të arsyeshme për kriteret dhe rregullat që do të zbatohen për të identifikuar ofertën me përfitim më të madh ekonomik. Prandaj është përgjegjësia e autoriteteve kontraktuese që të përcaktojnë kriteret për shpalljen e kontratës fituese dhe shkallën e rëndësisë relative që i jepet secilit kriter në kohë të mjaftueshme që ofertuesit të jenë në dijeni për to në kohën e përgatitjes së ofertës. Autoritetet kontraktuese mund të shmangin përcaktimin e shkallës së rëndësisë së kriterëve për shpalljen e kontratës fituese në raste të justifikuara për të cilat duhet të

jenë në gjendje të japin arsyet, kur shkalla e rëndësisë nuk mund të përcaktohet paraprakisht, sidomos për shkak të kompleksitetit të kontratës. Në këto raste, ato duhet të diktojnë rendin zbritës të shkallës së rëndësisë së kritereve.

Nëse autoritetet kontraktuese zgjedhin të shpallin kontratën fituese për ofertën me përfitim më të madh ekonomik, ato vlerësojnë ofertat me qëllim që të përcaktojnë se cila prej tyre ofron vlerën më të mirë monetare. Për të bërë këtë, ato përcaktojnë kriteret ekonomike dhe cilësore që, të marra në tërësi, duhet të bëjnë të mundur përcaktimin e ofertës me përfitim më të madh ekonomik për autoritetin kontraktues. Përcaktimi i këtyre kritereve varet nga objekti i kontratës pasi ato duhet të lejojnë që niveli i zbatimit i ofruar nga çdo ofertë të vlerësohet nën dritën e objektit të kontratës, siç e përcaktojnë specifikimet teknike, dhe që të llogaritet vlera monetare e çdo oferte.

Për të garantuar trajtim të barabartë, kriteret për shpalljen e kontratës fituese duhet të mundësojnë krahasimin dhe vlerësimin e ofertave në mënyrë objektive. Nëse plotësohen këto kushte, kriteret ekonomike dhe cilësore për fitimin e kontratës, si plotësimi i kritereve mjedisore, mund të bëjnë të mundur që autoriteti kontraktues të plotësojë nevojat e publikut të përfshirë, siç përcaktohet në specifikimet e kontratës. Në të njëjtat kushte, një autoritet kontraktues mund të përdorë kriteret që synojnë plotësimin e kërkesave sociale, në përgjigje sidomos të nevojave të përcaktuara në specifikimet e kontratës të grupeve të personave, veçanërisht në disavantazh, të cilëve u përket marrja/përdorimi i punimeve, furnizimeve ose shërbimeve që janë objekt i kontratës.

(47) Në rastin e kontratave për shërbime publike, kriteret e shpalljes së kontratës fituese nuk duhet të cenojnë zbatimin e dispozitave kombëtare për shpërbllimin e disa shërbimeve, si për shembull, shërbimet e kryera nga arkitektët, inxhinierët ose avokatët dhe, nëse bëhet fjalë për kontrata publike për furnizim, kriteret e shpalljes së kontratës fituese nuk duhet të prekin zbatimin e dispozitave kombëtare që përcaktojnë çmime fikse për librat shkollorë.

(48) Disa kushte teknike, dhe sidomos ato në lidhje me njoftimet dhe raportet statistikore, si dhe nomenklatura e përdorur dhe kushtet e referencës për këtë nomenklaturë, do të duhet të miratohen dhe të ndryshohen nisur nga ndryshimi i kërkesave teknike. Listat e autoriteteve kontraktuese në shtojcat do të duhet të përditësohen gjithashtu. Prandaj për këtë qëllim duhen përdorur procedura miratimi fleksibël dhe të shpejta.

(49) Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj direktive duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE, datë 28 qershor 1999, që përcakton procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i janë dhënë Komisionit [18].

(50) Rregullore e Këshillit (KEE, Euratom) nr. 1182/71, datë 3 qershor 1971, që përcakton rregullat e zbatueshme për periudhat, datat dhe afatet ligjore [19] duhet të zbatohet për llogaritjen e afateve kohore që përmban kjo direktivë.

(51) Kjo direktivë nuk duhet të prekë afatin kohor të përcaktuar në Shtojcën XI, brenda të cilit Shteteve Anëtare u kërkohet të transpozojnë dhe zbatojnë Direktivat 92/50/KEE, 93/36/KEE dhe 93/37/KEE,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

TABELA E PËRMBAJTJES

TITULLI I PËRKUFIZIME DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1 - Përkufizime

Neni 2 - Parimet e shpalljes së kontratës fituese

Neni 3 - Dhënia e të drejtave të veçanta ose ekskluzive: klauzola e mosdiskriminimit

TITULLI II RREGULLA PËR KONTRATAT PUBLIKE

KAPITULLI I Dispozita të Përgjithshme

Neni 4 - Operatorët ekonomikë

Neni 5 - Kushtet në lidhje me marrëveshjet e lidhura në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë

Neni 6 - Konfidencialiteti

KAPITULLI II Fusha e veprimit

Seksioni 1 Kufijtë monetarë

Neni 7 - Vlerat e kufijve monetarë për kontratat publike

Neni 8 - Kontratat e subvencionuara në masën më të madhe se 50% nga autoritetet kontraktuese

Neni 9 - Metodat për llogaritjen e vlerës së çmuar të kontratave publike, marrëveshjeve kuadër dhe sistemeve dinamike të blerjes

Seksioni 2 Situata specifike

Neni 10 - Prokurimi në fushën e mbrojtjes

Neni 11 - Kontratat publike dhe marrëveshjet kuadër të shpallura fituese nga organe qendrore blerëse

Seksioni 3 Kontratat e përjashtuara

Neni 12 - Kontratat në sektorët e shërbimeve ujore, energjetike, të transportit dhe postare

Neni 13 - Përjashtime specifike në fushën e telekomunikacionit

Neni 14 - Kontratat e fshehta dhe kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie

Neni 15 - Kontratat e shpallura fituese sipas rregullave ndërkombëtare

Neni 16 - Përjashtime specifike

Neni 17 - Koncesionet për shërbim

Neni 18 - Kontratat për shërbim të fituara në bazë të një të drejte ekskluzive

Seksioni 4 Rregulla të veçanta

Neni 19 - Kontratat e rezervuara

KAPITULLI III Rregullat e kontratave për shërbime publike

Neni 20 - Kontratat për shërbime të renditura në Shtojcën II A

Neni 21 - Kontratat për shërbime të renditura nga Shtojcën II B

Neni 22 - Kontratat e përziera që përfshijnë shërbimet e renditura në Shtojcën II A dhe shërbimet e renditura në Shtojcën II B

KAPITULLI IV Rregulla specifike që rregullojnë specifikimet dhe dokumentet e kontratës

Neni 23 - Specifikime teknike

Neni 24 - Variantet

Neni 25 - Nënkontraktimi

Neni 26 - Kushtet e zbatimit të kontratave

Neni 27 - Detyrimet në lidhje me tatimet, mbrojtjen mjedisore, dispozitat e mbrojtjes së punësimit dhe kushtet e punës

KAPITULLI V Procedurat

Neni 28 - Përdorimi i procedurave të hapura, të kufizuara dhe me negociim dhe i dialogut konkurrues

Neni 29 - Dialogu konkurrues

Neni 30 - Raste që justifikojnë përdorimin e procedurës me negociim me publikim paraprak të një njoftimi kontrate

Neni 31 - Rastet që justifikojnë përdorimin e procedurës me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës

Neni 32 - Marrëveshjet kuadër

Neni 33 - Sistemet dinamike të blerjes

Neni 34 - Kontratat për punë publike: rregulla të veçanta për banesat sociale të subvencionuara

KAPITULLI VI Rregullat për shpalljen dhe transparencën

Seksioni 1 Publikimi i njoftimeve

Neni 35 - Njoftimet

Neni 36 - Forma dhe mënyra e publikimit të njoftimeve

Neni 37 - Publikim jo i detyrueshëm

Neni 38 - Afatet kohore për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje dhe për marrjen e ofertave

Seksioni 2 Afatet kohore

Neni 39 - Procedurat e hapura: Specifikimet, dokumentet dhe informacioni shtesë

Seksioni 3 Përmbajtja e informacionit dhe mënyra e dërgimit të tij

Neni 40 - Ftesa për të paraqitur oferta, për të marrë pjesë në dialog ose për të negociuar

Neni 41 - Informimi i kandidatëve dhe ofertuesve

Seksioni 4 Komunikimi

Neni 42 - Rregullat e zbatueshme për komunikimin

Seksioni 5 Raportet

Neni 43 - Përmbajtja e raporteve

KAPITULLI VII Zhvillimi i procedurës

Seksioni 1 Dispozita të Përgjithshme

Neni 44 - Verifikimi i përshtatshmërisë dhe zgjedhja e pjesëmarrësve dhe shpallja e kontratave fituese

Seksioni 2 Kriteret për përzgjedhjen cilësore

Neni 45 - Situata personale e kandidatit ose ofertuesit

Neni 46 - Përshtatshmëria për ndjekjen e veprimtarisë profesionale

Neni 47 - Gjendja ekonomike dhe financiare

Neni 48 - Aftësia teknike dhe/ose profesionale

Neni 49 - Standardet e sigurimit të cilësisë

Neni 50 - Standardet e menaxhimit mjedisor

Neni 51 - Dokumentacion dhe informacion shtesë

Neni 52 - Listat zyrtare të operatorëve ekonomikë të miratuar dhe certifikimi i organeve të krijuara sipas të drejtës publike ose private

Seksioni 3 Shpallja e kontratës fituese

Neni 53 - Kriteret për shpalljen e kontratës fituese

Neni 54 - Përdorimi i ankandëve elektronike

Neni 55 - Oferta jonormale të ulëta

TITULLI III RREGULLAT PËR KONCESIONET NË PUNËT PUBLIKE

KAPITULLI I Rregullat që rregullojnë koncesionet në punë publike

Neni 56 - Fusha e veprimit

Neni 57 - Përjashtimet nga fusha e veprimit

Neni 58 - Publikimi i njoftimeve në lidhje me koncesionet për punë publike

Neni 59 - Afati kohor

Neni 60 - Nënkontraktimi

Neni 61 - Ngarkimi i koncesionarit me punë shtesë

KAPITULLI II Rregullat për kontratat e shpallura fituese nga koncesionarët që janë autoritete kontraktuese

Neni 62 - Rregullat e zbatueshme

KAPITULLI III Rregullat e zbatueshme për kontratat e shpallura fituese nga koncesionarët që nuk janë autoritete kontraktuese

Neni 63 - Rregullat e shpalljes: kufiri monetar dhe përjashtimet

Neni 64 - Publikimi i njoftimit

Neni 65 - Afatet kohore për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje dhe marrjen e ofertave

TITULLI IV RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONKURSET E PROJEKTIMIT

Neni 66 - Dispozita të Përgjithshme

Neni 67 - Fusha e veprimit

Neni 68 - Përjashtime nga fusha e veprimit

Neni 69 - Njoftimet

Neni 70 - Forma dhe mënyra e publikimit të njoftimeve të konkurseve

Neni 71 - Mjetet e komunikimit

Neni 72 - Përzgjedhja e konkurrentëve

Neni 73 - Përbërja e jurisë

Neni 74 - Vendimet e jurisë

TITULLI V DETYRIMET STATISTIKORE, KOMPETENCAT EKZEKUTIVE DHE DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 75 - Detyrime statistikore

Neni 76 - Përmbajtja e raportit statistikor

Neni 77 - Komiteti Këshillimor

Neni 78 - Rishikimi i kufijve monetarë

Neni 79 - Ndryshimet

Neni 80 - Zbatimi

Neni 81 - Mekanizmat e monitorimit

Neni 82 - Shfuqizime

Neni 83 - Hyrja në fuqi

Neni 84 - Adresa

SHTOJCAT

Shtojca I - Lista e veprimtarive të përmendura në nenin 1 pika 2, shkronja (b)

Shtojca II - Shërbime të përmendura në nenin 1 pika 2 shkronja (d)

Shtojca II A

Shtojca II B

Shtojca III - Lista e organeve dhe kategorive të organeve që rregullohen nga e drejta publike të përmendura në paragrafin e dytë të nenit 1 pika 9

Shtojca IV - Autoritete të qeverisjes qendrore

Shtojca V - Lista e produkteve të përmendura në nenin 7 në lidhje me kontratat e shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese në fushën e mbrojtjes

Shtojca VI - Përkufizimi i disa specifikimeve teknike

Shtojca VII - Informacioni që duhet të përfshihet në njoftime

Shtojca VII A - Informacioni që duhet të përfshihet në njoftimet e kontratës

Shtojca VII B - Informacion që duhet të jepet në njoftimet e koncesioneve për punë publike

Shtojca VII C - Informacion që duhet të jepet në njoftimet e kontratës për punë të koncesionarëve të cilët nuk janë autoritetet kontraktuese

Shtojca VII D - Informacion që duhet të jepet në njoftimet e konkursit të projektimit

Shtojca VIII - Veçori në lidhje me publikimin

Shtojca IX - Regjistra

Shtojca IX A - Kontratat për punë publike

Shtojca IX B - Kontrata për furnizime publike

Shtojca IX C - Kontrata për shërbime publike

Shtojca X - Kërkesat në lidhje me marrjen elektronike të ofertave, kërkesave për pjesëmarrje, dhe planeve dhe projekteve në konkurse

Shtojca XI - Afati për transpozim dhe zbatim (neni 80)

Shtojca XII - Tabela e përputhshmërisë

TITULLI I PËRKUFIZIME DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Përkufizime**

1. Në kuptim të kësaj direktive zbatohen përkufizimet e përcaktuara në pikat 2 deri në 15.

2. (a) "Kontratat publike" janë kontrata me interes monetar të lidhura me shkrim ndërmjet një ose më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktuese, dhe që kanë si objekt realizimin e punimeve, furnizimin e produkteve ose ofrimin e shërbimeve sipas kuptimit të kësaj direktive.

(b) "Kontratat për punë publike" janë kontratat publike që kanë si objekt të tyre realizimin ose projektimin, dhe realizimin e punimeve që lidhen me një nga veprimtaritë sipas kuptimit të Shtojcës I, ose një punim apo realizimin me çfarëdolloj mjete të një punimi që u korrespondon kërkesave të specifikuar nga autoriteti kontraktues. "Punim" është rezultati i një tërësie punësh ndërtimore a civile të mjaftueshme për përmbushjen e një funksioni ekonomik ose teknik.

(c) "Kontratat e furnizimit publik" janë kontrata të ndryshme nga ato që parashikon shkronja (b) të cilat kanë si objekt blerjen, qiranëdhënien financiare qiranëdhënien ose blerjen me këste, me ose pa mundësinë e blerjes, së produkteve.

Një kontratë publike me objekt furnizimin e produkteve dhe që mbulon gjithashtu, në mënyrë plotësuese, vendosjen dhe instalimin vlerësohet si "kontratë publike për furnizim";

(d) "Kontratat publike për shërbim" janë kontratat publike të ndryshme nga kontratat publike për punë ose furnizime që kanë objekt ofrimin e shërbimeve të përmendura në Shtojcën II.

Një kontratë publike që ka objekt si produktet ashtu dhe shërbimet sipas kuptimit të Shtojcës II konsiderohet "kontratë për shërbim publik" nëse vlera e shërbimeve në fjalë e kalon vlerën e produkteve që mbulon kontrata.

Një kontratë publike që ka objekt shërbime sipas kuptimit të Shtojcës II dhe përfshin veprimtari sipas kuptimit të Shtojcës I, që janë thjesht plotësuese për objektin parësor të kontratës, konsiderohet kontratë për shërbim publik.

3. (a) "Koncesion për punë publike" është kontratë njësoj si kontrata për punë publike, përveç faktit që shpërblimi për punimet konsiston ose vetëm në të drejtën e shfrytëzimit të veprës ose në këtë të drejtë së bashku me të drejtën për të përfituar pagesë.

4. (b) "Koncesion për shërbim" është kontratë njësoj si kontrata për shërbime publike, përveç faktit që shpërblimi për ofrimin e shërbimeve konsiston ose vetëm në të drejtën e shfrytëzimit të shërbimit ose në këtë të drejtë së bashku me të drejtën për të përfituar pagesë.

5. "Marrëveshje kuadër" është marrëveshja ndërmjet një ose më shumë autoriteteve kontraktuese dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i të cilës është të përcaktojë kushtet që rregullojnë kontratat të cilat duhet të shpallen fituese gjatë një periudhe të caktuar sidomos në lidhje me çmimin dhe, sipas rastit, sasinë e parashikuar.

6. "Sistem dinamik blerjeje" është një procedurë tërësisht elektronike, që përdoret për të bërë blerje të zakonshme, karakteristikat e të cilave, siç gjenden përgjithësisht në treg, plotësojnë kërkesat e autoritetit kontraktues, që është me kohëzgjatje të kufizuar dhe i hapur gjatë gjithë vlefshmërisë të tij ndaj çdo operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes dhe që ka paraqitur një ofertë indikative e cila iu përmbahet specifikimeve.

7. "Ankand elektronik" është një proces i përsëritur që përfshin një pajisje elektronike për paraqitjen e çmimeve të reja dhe të ulura, dhe/ose të vlerave të reja në lidhje me disa elemente të ofertës, e cila ndodh pas një vlerësimi të plotë fillestar të ofertave, duke mundësuar renditjen e tyre nëpërmjet metodave automatike të vlerësimit.

Rrjedhimisht, disa kontrata për shërbim dhe disa kontrata për punë që kanë si objekt performancën intelektuale, siç janë projektimi i punimeve, nuk mund të jenë objekt i ankandeve elektronike.

8. Termat "sipërmarrës", "furnizues" dhe "ofrues shërbimi" nënkuptojnë një person fizik ose juridik ose një subjekt shtetëror ose një grup personash të tillë dhe/ose organesh të tilla që ofrojnë në treg, përkatësisht, ekzekutimin e punimeve dhe/ose një punim, produkte ose shërbime.

Termi "operator ekonomik" mbulon po kështu konceptet e sipërmarrësit, furnizuesit dhe ofruesit të shërbimit. Ky term përdoret në funksion të thjeshtësimit.

Një operator ekonomik që ka paraqitur një ofertë emërtohet si "ofertues". Ai që ka kërkuar ftesë për pjesëmarrje në një procedurë të kufizuar ose me negociim ose në dialog konkurrues emërtohet si "kandidat".

9. (a) "Autoritete kontraktuese" janë autoritetet shtetërore, rajonale ose lokale, organe që rregullohen nga e drejta publike, shoqata të krijuara nga një ose disa autoritete të tilla ose një ose disa organe të tilla që i rregullon e drejta publike.

"Organ i rregulluar nga e drejta publike" është organi:

(a) i krijuar për qëllimin specifik të plotësimit të nevojave me interes të përgjithshëm, i cili nuk ka karakter industrial apo tregtar;

(b) me personalitet juridik; dhe

(c) i financuar, në pjesën më të madhe, nga autoritetet shtetërore, rajonale ose lokale, ose organet e tjera që i rregullon e drejta publike; ose niveli drejtues i të cilit i nënshtrohet mbikëqyrjes nga këto organe; ose që ka këshill administrativ, drejtues apo mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve janë emëruar nga autoritetet shtetërore, rajonale ose lokale, ose nga organe të tjera që i rregullon e drejta publike.

Lista joshteruese e organeve dhe kategorive të organeve që rregullohen nga e drejta publike, të cilat plotësojnë kriteret e përmendura në shkronjën (a), (b) dhe (c) të paragrafit të dytë jepet në Shtojcën III. Shtetet Anëtare njoftojnë rregullisht Komisionin për çdo ndryshim të listave të organeve dhe kategorive të organeve të tyre.

10. "Organ qendror blerës" është autoriteti kontraktues që:

- siguron furnizime dhe/ose shërbime për autoritete kontraktuese ose

- shpall kontratat fituese ose lidh marrëveshje kuadër për punë, furnizime ose shërbime të caktuara për autoritetet kontraktuese.

11. (a) "Procedura të hapura" janë ato procedura sipas të cilave çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë;

(b) "Procedura të kufizuara" janë ato procedura ku çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë, dhe ku vetëm operatorët ekonomikë të ftuar nga autoriteti kontraktues mund të paraqesin një ofertë.

(c) "Dialog konkurrues" është procedura ku çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë dhe ku autoriteti kontraktues zhvillon dialog me kandidatët e pranuar në procedurë, me qëllim që të zhvillojë një ose më shumë alternativa të përshtatshme që mund të plotësojnë kërkesat e tij, dhe në bazë të të cilës kandidatët e zgjedhur ftohen për ofertë.

Në kuptim të procedurës së përmendur në paragrafin e parë, kontrata publike konsiderohet "veçanërisht komplekse", nëse autoritetet kontraktuese:

- nuk janë objektivisht të afta të përcaktojnë mjetet teknike në përputhje me nenin 23 pika 3 shkronja (b), (c) ose (d), që mund të plotësojnë nevojat apo objektivat e tyre, dhe/ose

- nuk janë objektivisht të afta të specifikojnë kuadrin ligjor dhe/ose gjendjen financiare të një projekti.

(d) "Procedura me negociim" janë ato procedura sipas të cilave autoritetet kontraktuese konsultojnë operatorët ekonomikë të zgjedhur prej tyre dhe negociojnë kushtet e kontratës me një ose më shumë prej tyre.

"Konkurse projektimi" janë ato procedura që bëjnë të mundur që autoriteti kontraktues të sigurojë, kryesisht në fushën e planifikimit urban dhe rural, arkitekturës dhe inxhinierisë ose përpunimit të të dhënave, një plan ose projekt të përzgjedhur nga një juri pasi është paraqitur për konkurrim, me apo pa ndonjë çmim.

12. "E shkruar" ose "me shkrim" është çdo shprehje me fjalë ose shifra që mund të lexohet, riprodhohet dhe rrjedhimisht të komunikohet. Mund të përmbajë informacion që përcillet dhe ruhet me mjete elektronike.

13. "Mjete elektronike" janë mjetet elektronike që përdoren për përpunimin (përfshirë kompresionin dixhital) dhe ruajtjen e të dhënave që transmetohen, përçohen dhe merren me kabëll, radio, mjete optike ose mjete të tjera elektromagnetike.

14. “Fjalori i Përbashkët për Prokurimet (FPP)” përcakton nomenklaturën referencë të zbatueshme për kontratat publike të miratuara nga Rregullore (KE) nr. 2195/2002, ndërsa sigurohet barasvlershmëri me nomenklaturat e tjera ekzistuese.

Në rast të interpretimeve të ndryshme të fushës së veprimit të kësaj direktive për shkak të dallimeve të mundshme ndërmjet nomenklaturës së FPP-së dhe KSVE-së të renditura në Shtojcën I, ose ndërmjet nomenklaturës FPP dhe CPC (variant i përkohshëm) të renditura në Shtojcën II, epërsi do të kenë nomenklatura KSVE ose CPC përkatësisht.

15. Për qëllimet e nenit 13, nenit 57 shkronja (a) dhe nenit 68 shkronja (b), termat e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

(a) “rrjet publik i telekomunikacionit” është infrastruktura publike e telekomunikacionit, që bën të mundur dërgimin e sinjaleve ndërmjet pikave fundore të përcaktuara të rrjetit me kabëll, mikrovalë, mjete optike ose mjete të tjera elektromagnetike;

(b) “pikë fundore rrjeti” nënkupton të gjitha lidhjet fizike dhe specifikimet teknike të aksesit, që janë pjesë e rrjetit publik të telekomunikacionit dhe që janë të nevojshme për akses në atë rrjet publik dhe komunikim të efektshëm nëpërmjet atij rrjeti publik;

(c) “shërbime publike të telekomunikacionit” janë shërbimet e telekomunikacionit, ofrimin e të cilave Shtetet Anëtare ia kanë caktuar në mënyrë të veçantë një ose më shumë subjekteve të telekomunikacionit;

(d) “shërbime telekomunikacioni” janë shërbimet ofrimi i të cilave ka të bëjë pjesërisht apo plotësisht me transmetimin dhe rrugëzimin e sinjaleve në rrjetet e telekomunikacionit publik nëpërmjet proceseve të telekomunikacionit, me përjashtim të transmetimit dhe televizionit.

Neni 2

Parimet e shpalljes së kontratës fituese

Autoritetet kontraktuese i trajtojnë operatorët ekonomikë njësoj dhe pa diskriminim dhe veprojnë në mënyrë transparente.

Neni 3

Dhënia e të drejtave të veçanta ose ekskluzive: klauzola e mosdiskriminimit

Nëse një autoritet kontraktues i jep një subjekti, që nuk është ky autoritet kontraktues, të drejta të veçanta ose ekskluzive për të kryer një veprimtari të shërbimit publik, akti me anë të të cilit jepet kjo e drejtë parashikon që, në lidhje me kontratat për furnizim që u jep palëve të treta si pjesë e veprimtarive të tij, subjekti në fjalë duhet të respektojë parimin e mosdiskriminimit për shkak të shtetësisë.

TITULLI II

RREGULLA PËR KONTRATAT PUBLIKE

KAPITULLI I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 4

Operatorët ekonomikë

1. Kandidatët ose ofertuesit që, sipas ligjit të Shtetit Anëtar ku janë vendosur, kanë të drejtë të ofrojnë shërbimin përkatës, nuk refuzohen vetëm për arsyen se sipas ligjit të Shtetit Anëtar ku është shpallur fituese kontrata, atyre do u kërkohej të ishin persona fizikë ose juridikë.

Megjithatë, në rastin e kontratave për shërbime dhe punë publike si dhe të kontratave për furnizime publike që mbulojnë gjithashtu shërbime dhe/ose vendosje dhe instalime, personave juridikë mund t'u kërkohej të tregojnë, në ofertë ose kërkesën për pjesëmarrje, emrat dhe kualifikimet përkatëse profesionale të personelit që do të jetë përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë.

2. Grupet e operatorëve ekonomikë mund të paraqesin oferta ose të dalin vetë si kandidatë. Për të paraqitur një ofertë ose kërkesë për pjesëmarrje, autoritetet kontraktuese nuk mund t'u kërkojnë këtyre grupeve që të marrin një formë specifike ligjore; megjithatë, grupit të përzgjedhur mund t'i kërkohej kjo gjë pasi të jetë shpallur kontrata fituese, në masën që ky ndryshim të jetë i nevojshëm për zbatimin e kënaqshëm të kontratës.

Neni 5

Kushtet në lidhje me marrëveshjet e lidhura në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë

Shtetet Anëtare, për qëllimet e shpalljes së kontratave fituese nga autoritetet kontraktuese, në marrëdhëniet e tyre zbatojnë kushte po aq të favorshme sa ato që u japin operatorëve ekonomikë të vendeve të treta në zbatimin e Marrëveshjes për Prokurimin Publik (quajtur më poshtë "Marrëveshja"), të lidhur në kuadër të negociatave shumëpalëshe të Raundit të Uruguajit. Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare konsultojnë njëra-tjetrën brenda Komitetit Këshillimor për Kontratat Publike të përmendur në nenin 77 në lidhje me masat që duhen marrë sipas Marrëveshjes.

Neni 6

Konfidencialiteti

Autoriteti kontraktues, pa cenuar dispozitat e kësaj direktive, sidomos ato në lidhje me detyrimet për shpalljen e kontratave fituese dhe për informacionin për kandidatët dhe ofertuesit e përcaktuar në neneve 35 pika 4 dhe 41, dhe në përputhje me të drejtën kombëtare të cilës i nënshtrohet autoriteti kontraktues, nuk zbulon informacionin që u dërgon operatorëve ekonomikë të cilin ato e kanë përcaktuar si konfidencial; ky informacion përfshin, sidomos, të fshehta teknike ose tregtare dhe aspekte konfidenciale të ofertave.

KAPITULLI II

Fusha e veprimit

Seksioni 1

Kufijtë monetarë

Neni 7

Vlerat e kufijve monetarë për kontratat publike

Direktiva zbatohet për kontratat publike që nuk janë përjashtuar, sipas përjashtimeve të parashikuara në nenet 10 dhe 11 dhe nenet 12 deri në 18, të cilat kanë një vlerë pa TVSH që çmohet se është e barabartë ose më e madhe se kufijtë e mëposhtëm:

(a) 162 000 euro për kontratat për furnizime dhe shërbime publike që nuk mbulohen në shkronjën (b), paragrafi i tretë, të shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese të cilat janë renditura si autoritete të qeverisjes qendrore në Shtojcën IV; në rastin e kontratave për furnizimet publike të shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese që veprojnë në fushën e mbrojtjes, kjo zbatohet vetëm për kontratat që përfshijnë produkte të cilat i mbulon Shtojca V;

(b) 249 000 euro

- për kontratat për furnizime dhe shërbime publike të shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese jo të renditura në Shtojcën IV,

- për kontratat për furnizime publike të shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese të renditura në Shtojcën IV dhe që veprojnë në fushën e mbrojtjes, nëse këto kontrata përfshijnë produkte që nuk i mbulon Shtojca V,

- për kontratat për shërbime publike të shpallura fituese nga autoriteti kontraktues në lidhje me shërbimet e renditura në Kategorinë 8 të Shtojcës IIA, Kategorinë 5 shërbimet e telekomunikacionit pozicionet e të cilave në FPP janë të njëjta me numrat e referencës CPC 7524, 7525 dhe 7526 dhe/ose shërbimet e renditura në Shtojcën II B;

(c) 6 242 000 euro për kontratat për punë publike.

Neni 8

Kontratat e subvencionuara në masën më të madhe se 50% nga autoritetet kontraktuese

Kjo direktivë zbatohet për shpalljen fituese të:

(a) kontratave që janë subvencionuar drejtpërdrejt nga autoritetet kontraktuese në masën më të madhe se 50% dhe vlera e llogaritur e të cilave, pa TVSH, është e barabartë ose më e madhe se 6 242 000 euro,

- nëse këto kontrata përfshijnë ndërtime veprash civile, sipas kuptimit të Shtojcës I,

- nëse këto kontrata përfshijnë ndërtime të spitaleve, ambienteve sportive, rikrijuese dhe të argëtimit, shkollave dhe universiteteve dhe ndërtesa që përdoren për qëllime administrative;

(b) kontratave për shërbim që janë subvencionuar drejtpërdrejt nga autoritetet kontraktuese në masën më të madhe se 50% dhe vlera e të cilave pa TVSH çmohet se është e barabartë ose më e madhe se 249 000 euro dhe që lidhen me një kontratë për punë sipas kuptimit të shkronjës (a).

Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që autoritetet kontraktuese që japin këto subvencione të sigurojnë respektimin e kësaj direktive, nëse kontrata është shpallur fituese nga një ose më shumë subjekte të tjera, ose ta respektojnë këtë direktivë nëse ato vetë e shpallin fituese kontratën për llogari të subjekteve të tjera.

Neni 9

Metodat për llogaritjen e vlerës së çmuar të kontratave publike, marrëveshjeve kuadër dhe sistemeve dinamike të blerjes

1. Llogaritja e vlerës së çmuar të një kontrate publike bazohet në shumën e plotë të pagueshme, pa TVSH, sikurse çmohet nga autoriteti kontraktues. Në llogaritje merret parasysh shuma totale, përfshirë çdo lloj opsiioni dhe çdo ripërtëritje të kontratës.

Nëse autoriteti kontraktues u jep kandidatëve ose ofertuesve çmime a pagesa, këto i merr parasysh kur llogarit vlerën e çmuar të kontratës.

2. Çmuarja duhet të jetë e vlefshme në momentin e dërgimit të njoftimit të kontratës, siç e parashikon neni 35 pika 2, ose në rastet kur nuk kërkohet ky njoftim, në momentin kur autoriteti kontraktues fillon procedurën e shpalljes së kontratës fituese.

3. Asnjë projekt punimi apo blerje e propozuar e një sasive të caktuar furnizimesh dhe/ose shërbimesh nuk mund të ndahet në pjesë për të parandaluar përfshirjen në fushën e veprimit të kësaj direktive.

4. Në lidhje me kontratat për punë publike, llogaritja e vlerës së çmuar merr parasysh si koston e punës ashtu dhe vlerën totale të çmuar të furnizimeve të nevojshme për të kryer punën, dhe që vihen në dispozicion të sipërmarrësit nga autoritetet kontraktuese.

5. (a) Nëse një punim i propozuar ose blerje e shërbimeve mund të rezultojë në kontrata të shpallura fituese në të njëjtën kohë në formën e loteve të veçanta, merret parasysh vlera totale e çmuar e të gjitha këtyre loteve.

Nëse vlera agregate e loteve është e njëjtë ose më e madhe se kufiri i përcaktuar në nenin 7, kjo direktivë zbatohet për shpalljen e fituesit të çdo loti.

Megjithatë, autoritetet kontraktuese mund të mos e zbatojnë këtë për lotet vlera e çmuar e të cilave, pa TVSH, është më pak se 80 000 euro për shërbimet ose 1 milion euro për punimet, me kusht që vlera agregate e këtyre loteve të mos kalojë 20% të vlerës agregate të loteve në tërësi.

(b) Nëse një propozim për blerjen e furnizimeve të ngjashme mund të rezultojë në kontrata të shpallura fituese në të njëjtën kohë në formën e loteve të veçanta, merret parasysh vlera totale e çmuar e të gjitha loteve kur zbatohet neni 7 shkronjat (a) dhe (b).

Nëse vlera agregate e loteve është e njëjtë ose më e madhe se kufiri i përcaktuar në nenin 7, kjo direktivë zbatohet për shpalljen e fituesit të çdo loti.

Megjithatë, autoritetet kontraktuese mund të mos e zbatojnë këtë për lotet vlera e çmuar e të cilave, pa TVSH, është më pak se 80 000 euro, me kusht që kostoja agregate e këtyre loteve të mos kalojë 20% të vlerës agregate të loteve në tërësi.

6. Sa u përket kontratave të furnizimit publik, në lidhje me qiranë dhe blerjen me këste të produkteve, vlera që duhet marrë si bazë për të llogaritur vlerën e çmuar të kontratës është si vijon:

(a) në rastin e kontratave me afat të përcaktuar, nëse ky afat është më pak ose i barabartë me 12 muaj, vlera totale e çmuar për afatin e kontratës, ose nëse afati i kontratës është më shumë se 12 muaj, vlera totale duke përfshirë vlerën e mbetur të çmuar;

(b) në rastin e kontratave pa afat të përcaktuar ose afati i të cilave nuk mund të përcaktohet, vlera mujore e shumëfishuar me 48.

7. Në rastin e kontratave për furnizim ose shërbim publik që kanë natyrë të rregullt ose që synohet të rishikohen brenda një periudhe të përcaktuar, llogaritja e vlerës së çmuar të kontratës bazohet në sa më poshtë:

(a) ose në vlerën totale faktike të kontratave të njëpasnjëshme të të njëjtit lloj, të shpallura fituese gjatë 12 muajve paraprirës ose gjatë vitit financiar të përshtatur, nëse është e mundur, për të marrë parasysh ndryshimet në sasi ose në vlerë që do të ndodhnin gjatë 12 muajve pas kontratës fillestare;

(b) ose në vlerën totale të çmuar të kontratave të njëpasnjëshme të shpallura fituese gjatë 12 muajve pas dorëzimit të parë, ose gjatë vitit financiar, nëse ky është më shumë se 12 muaj.

Zgjedhja e metodës që do të përdoret për të llogaritur vlerën e çmuar të një kontrate publike nuk mund të bëhet me synim përjashtimin e saj nga fusha e veprimit e kësaj direktive.

8. Në lidhje me kontratat për shërbime publike, vlera që duhet të merret si bazë për llogaritjen e vlerës së çmuar të kontratës, sipas rastit, është si më poshtë:

(a) për llojet e mëposhtme të shërbimeve:

(i) shërbime sigurimi: prim i pagueshëm dhe forma të tjera shpërblimi;

(ii) shërbime bankare dhe të tjera shërbime financiare: tarifa, komisione, interesa dhe forma të tjera shpërblimi;

(iii) kontrata projektimi: tarifa, komisione të pagueshme dhe forma të tjera shpërblimi;

(b) për kontratat për shërbim që nuk tregojnë një çmim total;

(i) në rastin e kontratave me afat të përcaktuar, nëse ky afat është më i shkurtër ose i barabartë me 48 muaj: vlera totale për afatin e tyre të plotë;

(ii) në rastin e kontratave pa një afat të përcaktuar ose me një afat më të gjatë se 48 muaj: vlera mujore e shumëzuar me 48.

9. Në lidhje me marrëveshjet kuadër dhe sistemet dinamike të blerjes, vlera që duhet të merret parasysh është vlera totale e llogaritur pa TVSH e të gjitha kontratave të parashikuara për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër ose sistemit dinamik të blerjes.

Seksioni 2 Situata specifike

Neni 10 **Prokurimi në fushën e mbrojtjes**

Kjo direktivë zbatohet për kontratat publike të shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese në fushën e mbrojtjes, sipas nenit 296 të Traktatit.

Neni 11

Kontratat publike dhe marrëveshjet kuadër të shpallura fituese nga organe qendrore blerëse

1. Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë që autoritetet kontraktuese të blejnë punime, furnizime dhe/ose shërbime nëpërmjet një organi qendror blerës.

2. Autoritetet kontraktuese që blejnë punime, furnizime dhe/ose shërbime nëpërmjet një organi qendror blerës, në rastet e përcaktuara në nenin 1 pika 10, konsiderohen se e kanë respektuar këtë direktivë sa kohë që e ka respektuar organi qendror blerës.

Seksioni 3

Kontratat e përjashtuara

Neni 12

Kontratat në sektorët e shërbimeve ujore, energjetike, të transportit dhe postare

Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike që, sipas Direktivës 2004/17/KE, janë shpallur fituese nga autoritetet kontraktuese që ushtrojnë një ose më shumë veprimtari, të përmendura në nenet 3 deri në 7 të asaj direktive, dhe që janë shpallur fituese për kryerjen e këtyre veprimtarive, ose për kontratat publike që janë përjashtuar nga fusha e veprimit të asaj direktive sipas nenit 5 pika 2 dhe neneve 19, 26 dhe 30 të saj.

Megjithatë, kjo direktivë vazhdon të zbatohet për kontratat publike të shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese që kryejnë një ose më shumë nga veprimtaritë e përmendura në nenin 6 të Direktivës 2004/17/KE, dhe të shpallura fituese për këto veprimtari, në masën që Shteti Anëtar në fjalë përfiton nga mundësia e përmendur në paragrafin e dytë të nenit 71 të kësaj direktive që të shmangë zbatimin e saj.

Neni 13

Përjashtime specifike në fushën e telekomunikacionit

Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike me qëllim parësor lejimin e autoriteteve kontraktuese të ofrojnë ose shfrytëzojnë rrjete publike të telekomunikacionit ose të ofrojnë për publikun një ose më shumë shërbime telekomunikacioni.

Neni 14

Kontratat e fshehta dhe kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie

Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike nëse deklarohen të fshehta, kur përmbushja e tyre duhet të shoqërohet nga masa të veçanta sigurie, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Shtetin Anëtar përkatës, ose kur e kërkon mbrojtja e interesave thelbësore të atij Shteti Anëtar.

Neni 15

Kontratat e shpallura fituese sipas rregullave ndërkombëtare

Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike që rregullohen nga rregulla të ndryshme procedurale dhe që shpallen fituese:

- (a) sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare të lidhur në përputhje me Traktatin ndërmjet një Shteti Anëtar dhe një ose më shumë vendeve të treta, dhe që mbulon furnizime ose punime të synuara për zbatimin ose shfrytëzimin e përbashkët të një pune nga Shtetet nënshkruese, ose shërbimet e synuara për zbatimin ose shfrytëzimin e përbashkët të një projekti nga Shtetet nënshkruese; të gjitha marrëveshjet i komunikohen Komisionit i cili mund të konsultojë Komitetin Këshillimor për Kontratat Publike të përmendura në nenin 77;
- (b) sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare në lidhje me stacionimin e trupave, dhe në lidhje me sipërmarrjet e një Shteti Anëtar ose një vendi të tretë;
- (c) sipas procedurës së veçantë të një organizate ndërkombëtare.

Neni 16

Përjashtime specifike

Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat për shërbim publik për:

- (a) blerjen ose dhënien me qira, me çfarëdo mjeti financiar, të tokës, ndërtesave ekzistuese, ose pronave të tjera të paluajshme ose të drejtave në lidhje me to; megjithatë, kontratat për shërbim financiar të lidhura në të njëjtën kohë, përpara ose pas kontratës për blerjen ose qiradhënien, në çfarëdo formë, i nënshtrohen kësaj direktive;
- (b) blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e programit të synuar për transmetim nga transmetues dhe kontratat për kohën e transmetimit;
- (c) shërbime arbitrazhi dhe pajtimi;

(d) shërbime financiare në lidhje me emetimin, shitjen, blerjen ose transferimin e letrave me vlerë apo instrumenteve të tjera financiare, sidomos transaksionet e kryera nga autoritetet kontraktuese për të mbledhur para ose kapital dhe shërbimet e bankave qendrore;

(e) kontrata punësimi;

(f) shërbime për kërkim dhe zhvillim që nuk përfshijnë ato ku përfitimet akumulohen veçanërisht për autoritetin kontraktues për t'u përdorur nga ky i fundi në kryerjen e veprimtarive të veta, me kusht që shërbimi i ofruar të shpërblehet tërësisht nga autoriteti kontraktues.

Neni 17

Koncesionet për shërbim

Kjo direktivë, pa cenuar zbatimin e nenit 3, nuk zbatohet për koncesionet për shërbim të përkufizuara në nenin 1 pika 4.

Neni 18

Kontratat për shërbim të fituara në bazë të një të drejte ekskluzive

Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat për shërbime publike të shpallura fituese nga një autoritet kontraktues për një tjetër autoritet kontraktues ose për një shoqatë autoritetesh kontraktuese në bazë të një të drejte ekskluzive që gëzojnë sipas një ligji apo akti nënligjor të publikuar, e që është në përputhje me Traktatin.

Seksioni 4

Rregulla të veçanta

Neni 19

Kontratat e rezervuara

Shtetet Anëtare mund të rezervojnë të drejtën të marrin pjesë në procedura për shpalljen e kontratës publike fituese nga qendrat e punës, ose të parashikojnë që këto kontrata të zbatohen në kontekstin e programeve të punësimit në qendra pune, ku shumica e punonjësve janë persona me aftësi të kufizuara fizike të cilët, për shkak të aftësisë shumë të kufizuar, nuk mund të vazhdojnë të punojnë në kushte normale.

Kjo dispozitë duhet të përmendet shprehimisht në njoftimin e kontratës.

KAPITULLI III

Rregullat për kontratat për shërbime publike

Neni 20

Kontratat për shërbime të renditura në Shtojcën II A

Kontratat që kanë për objekt shërbimet e renditura në Shtojcën II A shpallen fituese në përputhje me nenet 23 deri në 55.

Neni 21

Kontratat për shërbime të renditura nga Shtojcën II B

Kontratat që kanë si objekt shërbimet e renditura në Shtojcën II B rregullohen vetëm nga neni 23 dhe neni 35 pika 4.

Neni 22

Kontratat e përziera që përfshijnë shërbimet e renditura në Shtojcën II A dhe shërbimet e renditura në Shtojcën II B

Kontratat që kanë si objekt shërbimet e renditura si në Shtojcën II A ashtu dhe në Shtojcën II B shpallen fituese, në përputhje me nenet 23 deri në 55, nëse vlera e shërbimeve të renditura në Shtojcën II A është më e madhe se vlera e shërbimeve të renditura në Shtojcën II B. Në raste të tjera, kontratat shpallen fituese në përputhje me nenin 23 dhe nenin 35 pika 4.

KAPITULLI IV

Rregulla specifike që rregullojnë specifikimet dhe dokumentet e kontratës

Neni 23

Specifikime teknike

1. Specifikimet teknike, siç e përcakton paragrafi 1 i Shtojcës VI, përcaktohen në dokumentacionin e kontratës, siç janë njoftimet e kontratës, dokumentet e kontratës ose dokumente shtesë. Subjektet kontraktuese, kur është e mundur, duhet të përcaktojnë specifikime teknike për të marrë parasysh mundësinë e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit.

2. Specifikimet teknike ofrojnë të njëjtën mundësi pjesëmarrjeje për ofertuesit dhe nuk kanë efekt krijimin e pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës.

3. Pa cenuar rregullat teknike kombëtare të detyrueshme, në masën që janë në përputhje me legjislacionin komunitar, specifikimet teknike formulohen:

(a) ose në lidhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën VI dhe, sipas radhës së preferencës, për standarde kombëtare që transpozojnë standarde europiane, miratime teknike europiane, specifikime të përbashkëta teknike, standarde ndërkombëtare, sisteme të tjera reference teknike, të krijuara nga organe europiane standardizimi ose, nëse këto nuk ekzistojnë, në lidhje me standardet kombëtare, aprovimet teknike kombëtare, ose specifikimet teknike kombëtare në lidhje me projektimin, llogaritjen dhe ekzekutimin e punimeve dhe përdorimin e produkteve. Çdo tekst që bën lidhjen shoqërohet me fjalët “ose i/e njëjtë”;

(b) ose në lidhje me kërkesat e zbatimit apo funksionale; këto të fundit mund të përfshijnë karakteristika mjedisore. Megjithatë, këto parametra duhet të jenë mjaftueshëm të sakta që të bëjnë të mundur që ofertuesit të përcaktojnë objektin e kontratës dhe të lejojnë autoritetet kontraktuese të shpallin fituese një kontratë;

(c) ose në lidhje me kërkesat e zbatimit apo funksionale, siç përmendet në shkronjën (b), duke ju referuar specifikimeve të përmendura në shkronjën (a) si mjet për të prezumuar përputhjen me këto kërkesa zbatimi ose funksionale;

(d) ose duke përmendur specifikimet e përmendura në shkronjën (a) për disa karakteristika, dhe kërkesat e zbatimit ose funksionale të përmendura në shkronjën (b) për karakteristika të tjera.

4. Nëse një autoritet kontraktues bën lidhjen me specifikimet e përmendura në pikën 3 shkronja (a), ai nuk mund të refuzojë ofertën me arsyen se produktet dhe shërbimet e tenderuara nuk përmbushin specifikimet të cilat është mbështetur, nëse ofertuesi në ofertën e tij i provon në mënyrë të kënaqshme autoritetit kontraktues, me çfarëdo mjeti të duhur, që zgjidhjet që ai propozon të plotësojnë në mënyrë të njëjtë kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike.

Mjetet e duhura mund të përbëhen nga një dosje teknike e prodhuesit ose një raport testimi nga një organ i njohur.

5. Nëse një autoritet kontraktues përdor mundësinë e parashikuar në pikën 3 të përcaktimit të kërkesave të zbatimit ose funksionale, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, produkte ose shërbime e cila përmbush një standard kombëtar që transponon një standard europian, një aprovim teknik europian, një specifikim teknik të përbashkët, një standard ndërkombëtar, një sistem reference teknike të krijuar nga një organ europian standardizimi, nëse këto specifikime trajtojnë kërkesat e zbatimit ose funksionale që ai ka përcaktuar.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet t'i provojë mjaftueshëm autoritetit kontraktues dhe me mjete të duhura që puna, produkti ose shërbimi në përputhje me standardet plotëson kërkesat e zbatimit ose funksionale të autoritetit kontraktues.

Mjetet e duhura mund të përbëhen nga një dosje teknike e prodhuesit ose një raport testimi nga një organ i njohur.

6. Nëse autoritetet kontraktuese përcaktojnë karakteristika mjedisore në lidhje me kërkesat e zbatimit ose funksionale, siç përmenden në pikën 3 shkronja (b), ato mund të përdorin specifikime të detajuara

ose, nëse është e nevojshme, pjesë të tyre, siç e përcaktojnë eko-etiketat (shumë)kombëtare ose europiane ose një tjetër eko-etiketë, nëse:

- këto specifikime janë të përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e furnizimeve ose shërbimeve që janë objekt i kontratës,
- kërkesat për etiketë janë hartuar në bazë të informacionit shkencor,
- eko-etiketat miratohen duke përdorur një procedurë ku mund të marrin pjesë të gjithë aktorët, si organet e qeverisë, konsumatorët, prodhuesit, shpërndarësit dhe organizatat mjedisore, dhe
- të gjitha palët e interesuara mund t'i shikojnë.

Autoritetet kontraktuese mund të tregojnë që produktet dhe shërbimet që kanë eko-etiketën prezumohen se plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e kontratave; ato duhet të pranojnë mjete të tjera të përshtatshme të të provuarit, si një dosje teknike të prodhuesit ose një raport testimi nga një organ i njohur.

7. "Organe të njohura" sipas kuptimit të këtij neni janë laboratorët e testimit dhe kalibrimit dhe organe certifikimi dhe inspektimi që përmbushin standardet e zbatueshme europiane.

Autoritetet kontraktuese pranojnë certifikatat nga organet e njohura të krijuara në Shtete të tjera Anëtare.

8. Specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk kërkojnë një markë prodhimi a burim specifik, ose një proces të veçantë, apo markë tregtare, patentë, lloj apo origjinë a prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa ndërmarrjeve ose produkteve. Një kërkesë e tillë lejohet, në raste përjashtimore, nëse nuk është i mundur një përshkrim mjaft i saktë dhe i kuptueshëm i objektit të kontratës sipas pikave 3 dhe 4; kërkesa duhet të shoqërohet me fjalën ose i/e njëjtë.

Neni 24

Variantet

1. Autoritetet kontraktuese, nëse kriteri për shpalljen e kontratës fituese është oferta me përfitim më të madh ekonomik, mund të autorizojnë ofertuesit që të paraqesin variante.

2. Autoritetet kontraktuese përcaktojnë në njoftimin e kontratës nëse autorizojnë apo jo variante: variantet nuk autorizohen pa këtë përcaktim.

3. Autoritetet kontraktuese që autorizojnë variante në dokumentet e kontratës përcaktojnë kërkesat minimale që duhet të plotësohen nga variantet dhe çdo kërkesë specifike për paraqitjen e tyre.

4. Vetëm variantet që plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara nga këto autoritete kontraktuese merren parasysh.

Në procedurat për shpalljen e kontratave fituese për furnizime ose shërbime publike, autoritetet kontraktuese që kanë autorizuar variante nuk mund të refuzojnë një variant me arsyen e vetme që, nëse është i suksesshëm, do të çojë në një kontratë për shërbim në vend të një kontrate furnizimi, ose në një kontratë furnizimi në vend të një kontrate shërbimi.

Neni 25

Nënkontraktimi

Autoriteti kontraktues në dokumentet e kontratës mund të kërkojë ose atij mund t'i kërkojë nga një Shtet Anëtar t'i kërkojë ofertuesit të tregojë në ofertën e tij çdo pjesë të kontratës që ai mund të synojë të nënkontrakttojë tek të tretë dhe çdo nënkontraktor të propozuar.

Kjo nuk cenon çështjen e përgjegjësisë së operatorit ekonomik parësor.

Neni 26

Kushtet e zbatimit të kontratave

Autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë kushtet e veçanta në lidhje me zbatimin e një kontrate, nëse këto janë në përputhje me legjislacionin komunitar dhe të tregohen në njoftimin e kontratës ose në specifikime. Kushtet që rregullojnë zbatimin e një kontrate, në veçanti, mund të përfshijnë konsiderata sociale dhe mjedisore.

Neni 27

Detyrimet në lidhje me tatimet, mbrojtjen mjedisore, dispozitat e mbrojtjes së punësimit dhe kushtet e punës

1. Një autoritet kontraktues mund të përcaktojë në dokumentet e kontratave, ose të detyrohet nga një Shtet Anëtar që të përcaktojë organin ose organet nga të cilat një kandidat ose një ofertues mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet në lidhje me tatimet, mbrojtjen mjedisore, dispozitat e mbrojtjes së punësimit dhe kushtet e punës që janë në fuqi në Shtetin Anëtar, në rajonin ose në vendin ku do të kryhen punët ose do të ofrohen shërbimet, dhe që janë të zbatueshme për punët e kryera në vend ose për shërbimet e ofruara gjatë zbatimit të kontratës.

2. Autoriteti kontraktues që siguron informacionin e përmendur në pikën 1 u kërkon ofertuesve ose kandidatëve në procedurën e shpalljes së kontratave fituese të tregojnë që ata kanë marrë parasysh, në hartimin e ofertës së tyre, detyrimet që lidhen me dispozitat e mbrojtjes së punësimit dhe kushteve të punës që janë në fuqi në vendin ku do të kryhen punët ose do të ofrohet shërbimi.

Paragrafi i parë nuk cenon zbatimin e dispozitave të nenit 55 në lidhje me shqyrtimin e ofertave jonormale të ulëta.

KAPITULLI V

Procedurat

Neni 28

Përdorimi i procedurave të hapura, të kufizuara dhe me negociim dhe i dialogut konkurrues

Në shpalljen fituese të kontratave publike, autoritetet kontraktuese përdorin procedurat e rregulluara për qëllimet e kësaj direktive.

Ato i shpallin këto kontrata publike fituese nëpërmjet procedurës së hapur ose të kufizuar. Autoritetet kontraktuese, në rrethana specifike të parashikuara shprehimisht në nenin 29, mund të shpallin fituese kontratat e tyre me anë të dialogut konkurrues. Në raste dhe rrethana specifike të përmendura shprehimisht në nenet 30 dhe 31, ato mund të përdorin procedurën me negociim, me apo pa publikim të njoftimit të kontratës.

Neni 29

Dialogu konkurrues

1. Shtetet Anëtare, në rastin e kontratave veçanërisht komplekse, mund të parashikojnë që nëse autoritetet kontraktuese konsiderojnë që përdorimi i procedurës së hapur ose të kufizuar nuk lejon shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit mund të përdorin dialogun konkurrues sipas këtij neni.

Një kontratë publike shpallet fituese vetëm në bazë të kriterit për shpalljen e kontratës fituese për ofertën me përfitim më të madh ekonomik.

2. Autoritetet kontraktuese publikojnë një njoftim kontrate që paraqet nevojat dhe kërkesat e tyre, të cilat ato i përcaktojnë në atë njoftim dhe/ose në një dokument përshkrues.

3. Autoritetet kontraktuese fillojnë dialog me kandidatët e përzgjedhur sipas dispozitave përkatëse të neneve 45 deri në 52, me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e mjeteve që përshtaten më mirë me nevojat e tyre. Ato mund të diskutojnë të gjitha aspektet e kontratës me kandidatët e zgjedhur gjatë këtij dialogu.

Gjatë dialogut, autoritetet kontraktuese sigurojnë trajtim të barabartë mes ofertuesve. Ato sidomos nuk japin informacion në mënyrë diskriminuese i cili mund t'u ofrojë më tepër avantazh disa ofertuesve krahasuar me të tjerët.

Autoritetet kontraktuese nuk mund t'u tregojnë pjesëmarrësve të tjerë zgjidhjet e propozuara ose informacione të tjera konfidenciale të komunikuar nga një kandidat që merr pjesë në dialog, pa pëlqimin e këtij të fundit.

4. Autoritetet kontraktuese mund të parashikojnë që procedura të zhvillohet në fazat vijuese, me qëllim që të ulet numri i zgjidhjeve që do të diskutohen gjatë fazës së dialogut, duke përdorur kriteret e shpalljes së kontratës fituese në njoftimin e kontratës ose në dokumentin përshkrues. Njoftimi i kontratës ose dokumenti përshkrues tregon që mund të përdoret kjo mundësi.

5. Autoriteti kontraktues e vazhdon dialogun deri në identifikimin e zgjidhjes ose zgjidhjeve, nëse është e nevojshme pas krahasimit të tyre, të cilat mund të plotësojnë nevojat e tij.

6. Autoritetet kontraktuese, pasi deklarojnë përfundimin e dialogut dhe pasi informojnë për këtë pjesëmarrësit, u kërkojnë atyre që të paraqesin ofertat e tyre përfundimtare në bazë të zgjidhjes ose zgjidhjeve të paraqitura dhe të specifikuar gjatë dialogut. Këto oferta përmbajnë të gjithë elementet e kërkuara dhe të nevojshme për realizimin e projektit.

Këto oferta mund të sqarohen, specifikohen dhe të harmonizohen me kërkesë të autoritetit kontraktues. Megjithatë, ky sqarim, specifikim, harmonizim ose informacion shtesë nuk mund të përfshijë ndryshime në veçoritë kryesore të ofertës ose ftesës për ofertë, ndryshime të cilat ka mundësi të shtrembërojnë konkurrencën ose të kenë ndikim diskriminues.

7. Autoritetet kontraktuese vlerësojnë ofertat e marra në bazë të kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, të përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në dokumentin përshkrues, dhe zgjedhin ofertën me përfitim më të madh ekonomik sipas nenit 53.

Me kërkesë të autoritetit kontraktues, ofertuesit të identifikuar me ofertën me përfitimin më të madh ekonomik mund t'i kërkohet të sqarojë aspekte të ofertës ose të konfirmojë angazhimin që përmban oferta, me kusht që kjo të mos ndikojë në ndryshimin e aspekteve thelbësore të ofertës dhe të ftesës për ofertë dhe të mos rrezikojë për shtrembërimin e konkurrencës ose të mos shkaktojë diskriminim.

8. Autoritetet kontraktuese mund të specifikojnë çmimet ose pagesat për pjesëmarrësit në dialog.

Neni 30

Raste që justifikojnë përdorimin e procedurës me negociim me publikim paraprak të një njoftimi kontrate

1. Autoritetet kontraktuese mund të shpallin kontratat publike fituese me anë të procedurës me negociim pas publikimit të një njoftimi kontrate, në rastet e mëposhtme:

(a) në rast të ofertave të parregullta ose dorëzimit të ofertave që janë të papranueshme sipas dispozitave kombëtare që janë në përputhje me nenet 4, 24, 25, 27 dhe Kapitullin VII, në përgjigje të një procedure të hapur ose të kufizuar, ose një dialogu konkurrues, në masën që kushtet fillestare të kontratës nuk janë ndryshuar në thelb.

Autoritetet kontraktuese nuk kanë pse të publikojnë një njoftim kontrate nëse përfshijnë në një procedurë me negociim të gjithë, ose vetëm ofertuesit që plotësojnë kriteret e neneve 45 deri në 52, dhe që gjatë procedurës paraprake të hapur ose të kufizuar ose dialogut konkurrues, paraqiten oferta në përputhje me kërkesat formale të procedurës së tenderimit;

(b) në raste të jashtëzakonshme, kur natyra e punëve, furnizimeve ose shërbimeve a rreziqet që lidhen me to, nuk lejojnë vendosjen paraprake të çmimeve të përgjithshme;

(c) në rastin e shërbimeve, inter alia të shërbimeve brenda kategorisë 6 të Shtojcës II A dhe shërbimeve intelektuale siç janë shërbimet që përfshijnë projektimin e punëve, në masën që natyra e shërbimeve që duhet të ofrohen të jetë e tillë që specifikimet e kontratës të mos përcaktohen me saktësi të mjaftueshme që lejon shpalljen e kontratës fituese nëpërmjet përzgjedhjes së ofertës më të mirë, sipas rregullave për procedurat e hapura ose të kufizuara;

(d) në lidhje me kontratat për punë publike, për punët që janë kryer vetëm për qëllim kërkimi, testimi ose zhvillimi dhe jo për të siguruar përfitim ose rikuperuar kostot e kërkimit dhe zhvillimit.

2. Autoritetet kontraktuese, në rastet e përmendura në pikën 1 negociojnë me ofertuesit ofertat që kanë paraqitur ata, me qëllim që t'i përshtatin me kërkesat që kanë përcaktuar në njoftimin e kontratës, specifikimet dhe dokumentet shtesë, nëse ka, dhe që të gjendet oferta më e mirë në përputhje me nenin 53 pika 1.

3. Gjatë negociatave, autoritetet kontraktuese sigurojnë trajtim të barabartë të të gjithë ofertuesve. Ato sidomos nuk japin informacion në mënyrë diskriminuese i cili mund t'u ofrojë më tepër avantazh disa ofertuesve krahasuar me të tjerët.

4. Autoritetet kontraktuese mund të parashikojnë që procedura me negociim të zhvillohet në fazat vijuese, me qëllim që të ulet numri i zgjidhjeve që do të negociohen, duke përdorur kriteret e shpalljes së kontratës fituese në njoftimin e kontratës ose në specifikime. Njoftimi i kontratës ose specifikimet tregojnë nëse është përdorur apo jo kjo mundësi.

Neni 31

Rastet që justifikojnë përdorimin e procedurës me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës

Autoritetet kontraktuese mund të shpallin fituese kontrata publike me anë të një procedure me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës në rastet e mëposhtme:

(1) për kontrata për punë publike, kontrata për furnizime publike dhe kontrata për shërbime publike;
(a) nëse nuk janë paraqitur oferta ose oferta të përshtatshme ose aplikime në përgjigje të një procedure të hapur ose të kufizuar, me kusht që të mos ndryshohen në thelb kushtet fillestare të kontratës dhe me kusht që Komisionit t'i dërgohet një raport, nëse e kërkon;

(b) nëse, për arsye teknike ose artistike, ose për arsye që lidhen me mbrojtjen e të drejtave ekskluzive, kontrata mund të fitohet vetëm nga një operator i veçantë ekonomik;

(c) në masën që është tepër e nevojshme nëse, për arsye urgjence ekstreme të shkaktuara nga ngjarje të paparashikuara nga autoritetet kontraktuese në fjalë, nuk mund të respektohet afati kohor për procedura të hapura, të kufizuara ose me negociim me publikimin e një njoftimi kontrate të përmendur në nenin 30. Rrethanat për të justifikuar urgjencën ekstreme në asnjë rast nuk mund t'i atribuohen autoritetit kontraktues;

(2) për kontratat për furnizime publike:

(a) nëse produktet e përfshira janë prodhuar vetëm për qëllim kërkimi, për eksperiment, studim ose zhvillim; kjo dispozitë nuk mbulon prodhimin sasior që ka për synim arritjen e leverdishmërisë tregtare apo mbulimin e kostove të kërkimit dhe zhvillimit;

(b) për dërgesa shtesë nga furnizuesi fillestar që janë ose zëvendësim i pjesshëm i furnizimeve të zakonshme ose instalimeve, ose zgjerim i furnizimeve ose instalimeve ekzistuese, nëse një ndryshim i furnizuesit do ta detyronte autoritetin kontraktues të siguronte material me karakteristika të ndryshme teknike, përdorimi ose mirëmbajtja e të cilit do të rezultonte në papajtueshmëri ose vështirësi të shpërpjesëtueshme teknike; kohëzgjatja e këtyre kontratave si dhe e kontratave të përsëritura si rregull i përgjithshëm nuk mund të kalojë tre vjet;

(c) për furnizime të kuotuar dhe të blera në tregun e mallrave;

(d) për blerje të furnizimeve në kushte veçanërisht fitimprurëse nga një furnizues i cili është duke mbyllur veprimtarinë tregtare, ose nga administratorët apo likuiduesit e një shoqërie tregtare në procedurë falimentimi, marrëveshjeje me kreditorët ose në një procedurë tjetër të ngjashme sipas akteve ligjore dhe nënligjore kombëtare;

(3) për kontrata publike për shërbime, nëse kontrata në fjalë ndjek një konkurs projektimi dhe sipas rregullave të zbatueshme duhet të shpallet fituese për kandidatin e suksesshëm ose për një prej kandidatëve të suksesshëm, në rastin e fundit ftohen të gjithë kandidatët e suksesshëm që të marrin pjesë në negociata;

(4) për kontrata për punë publike dhe kontrata për shërbime publike:

(a) për shërbime ose punë shtesë që nuk janë përfshirë në projektin, të konsideruar fillimisht ose në kontratën fillestare, por që nëpërmjet rrethanave të paparashikuara janë bërë të nevojshme për kryerjen e punëve ose shërbimeve të përshkruara në to, me kushtin që kontrata të jetë shpallur fituese për operatorin ekonomik që kryen këto punë ose shërbime:

- nëse këto punime ose shërbime shtesë nuk mund të ndahen teknikisht apo ekonomikisht nga kontrata fillestare, pa shkaktuar problem të madh për autoritetet kontraktuese, ose

- nëse këto punime ose shërbime, edhe pse mund të ndahen nga zbatimi i kontratës fillestare, janë rreptësisht të nevojshme për përfundimin e saj.

Megjithatë, vlera agregate e kontratave të shpallura fituese për punë ose shërbime shtesë nuk mund të kalojë 50% të vlerës së kontratës fillestare;

(b) për punë ose shërbime të reja që kanë të bëjnë me përsëritjen e punëve ose shërbimeve të ngjashme, të cilat i janë besuar operatorit ekonomik për të cilin të njëjtat autoritete kontraktuese kanë shpallur fituese kontratën fillestare, me kusht që këto punë ose shërbime të jenë në përputhje me një projekt bazë për të cilin është shpallur fituese kontrata fillestare sipas procedurës së hapur ose të kufizuar.

Sapo projekti i parë të paraqitet për ofertë, tregohet përdorimi i mundshëm i kësaj procedure dhe kostoja totale e llogaritur e punëve ose shërbimeve vijuese merret parasysh nga autoritetet kontraktuese kur zbatojnë dispozitat e nenit 7.

Kjo procedurë mund të përdoren vetëm gjatë tre viteve pas përfundimit të kontratës fillestare.

Neni 32

Marrëveshjet kuadër

1. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktuese të lidhin marrëveshje kuadër.

2. Për qëllim të lidhjes të një marrëveshjeje kuadër, autoritetet kontraktuese ndjekin rregulloren e brendshme, të përmendura në këtë direktivë, për të gjitha fazat deri në shpalljen e kontratës fituese bazuar në atë marrëveshje kuadër. Palët në marrëveshje kuadër zgjidhen me anë të përdorimit të kriterëve për shpalljen e kontratës fituese në përputhje me nenin 53.

Kontratat bazuar në një marrëveshje kuadër shpallen fituese sipas procedurave të përcaktuara në pikën 3 dhe 4. Këto procedura mund të përdoren vetëm ndërmjet autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë që janë fillimisht palë në marrëveshjen kuadër.

Palët, në shpalljen fituese të kontratave bazuar në një marrëveshje kuadër, në asnjë rrethanë nuk mund të bëjnë ndryshime thelbësore të kushteve të përcaktuara në atë marrëveshje kuadër, sidomos në rastin e përmendur në pikën 3.

Afati i marrëveshjes kuadër nuk mund të jetë më shumë se katër vjet, përveç rasteve të jashtëzakonshme të justifikuara, sidomos nga objekti i marrëveshjes kuadër.

Autoritetet kontraktuese nuk mund të përdorin marrëveshje kuadër në formën e papërshtatshme ose në mënyrë të tillë që të pengojnë, kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën.

3. Nëse një marrëveshje kuadër është lidhur me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e mbështetura në këtë marrëveshje shpallen fituese brenda kufijve të përcaktuar në marrëveshjen kuadër.

Autoritetet kontraktuese, për shpalljen e këtyre kontratave fituese, mund të konsultojnë me shkrim operatorin palë në marrëveshjen kuadër për t'i kërkuar plotësimin e ftesës sipas nevojës.

4. Nëse një marrëveshje kuadër lidhet me disa operatorë ekonomikë, këta të fundit duhet të jenë të paktën tre në numër, sa kohë që numri i operatorëve ekonomikë është i mjaftueshëm për të plotësuar kriteret e përzgjedhjes dhe/ose ka oferta të pranueshme që plotësojnë kriteret për t'u shpallur fituese.

Kontratat e bazuara në marrëveshje kuadër të lidhura me disa operatorë ekonomikë mund të shpallen fituese ose:

- me anë të zbatimit të afateve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër pa rihapjen e konkurrencës, ose
- kur në marrëveshjen kuadër nuk janë përcaktuara të gjitha kushtet, nëse palët marrin përsëri pjesë në konkurrim bazuar në kushte të njëjta dhe, nëse është e nevojshme, të formuluar më saktësisht

dhe, sipas rastit, bazuar në kushte të tjera të përmendura në specifikimet e marrëveshjes kuadër, në përputhje me procedurën e mëposhtme:

- (a) autoritetet kontraktuese, për çdo kontratë që duhet shpallur fituese, konsultojnë me shkrim operatorët ekonomikë që mund të zbatojnë kontratën;
- (b) autoritetet kontraktuese caktojnë një afat kohor që është i mjaftueshëm për të mundësuar paraqitjen e ofertave për çdo kontratë specifike, duke pasur parasysh faktorët si kompleksiteti i objektit të kontratës dhe koha e nevojshme për të dërguar ofertat;
- (c) ofertat paraqiten me shkrim dhe përmbajtja e tyre mbetet konfidenciale deri në mbarimin e afatit të përcaktuar për përgjigje;
- (d) autoritetet kontraktuese shpallin çdo kontratë fituese për ofertuesin që ka paraqitur ofertën më të mirë në bazë të kriterëve për shpalljen e kontratës fituese të përcaktuara në specifikime të marrëveshjes kuadër.

Neni 33

Sistemet dinamike të blerjes

1. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktuese të përdorin sisteme dinamike blerjeje.

2. Autoritetet kontraktuese, për një krijuar një sistem dinamik blerjeje, ndjekin rregullat e procedurës së hapur në të gjitha fazat deri në shpalljen kontratave fituese që duhet të lidhen sipas këtij sistemi. Të gjithë ofertuesit që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes dhe që kanë paraqitur një ofertë indikative, e cila respekton specifikimet dhe ndonjë dokument shtesë të mundshëm, pranohen në sistem; ofertat indikative mund të përmirësohen në çdo kohë nëse vazhdojnë të jenë në përputhje me specifikimet. Me qëllim krijimit të sistemit dhe shpalljen e kontratave fituese sipas sistemit, autoritetet kontraktuese përdorin vetëm mjete elektronike në përputhje me nenin 42 pikat 2 deri në 5.

3. Për qëllimet e krijimit të sistemit dinamik të blerjes, autoritetet kontraktuese:

- (a) publikojnë një njoftim kontrate duke e bërë të qartë që bëhet fjalë për një sistem dinamik blerjeje;
- (b) tregojnë në specifikim, mes çështjeve të tjera, natyrën e blerjeve të parashikuara sipas atij sistemi, si edhe të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me sistemin e blerjes, pajisjen elektronike të përdorur dhe rregulla dhe specifikime teknike të lidhjes;
- (c) ofrojnë me anë të mjeteve elektronike, pas publikimit të njoftimit dhe deri në mbarim të afatit të sistemit, liri shikimi të pakufizuar, të drejtpërdrejtë dhe të plotë në specifikimin dhe çdo dokument tjetër shtesë, dhe tregojnë në njoftim adresën e internetit ku mund të shihen këto dokumente.

4. Autoritetet kontraktuese i japin çdo operatori ekonomik gjatë gjithë periudhës së sistemit dinamik të blerjes mundësinë të paraqesë një ofertë indikative dhe të pranohet në sistem, sipas kushteve të përmendura në pikën 2. Ato e plotësojnë vlerësimin brenda afatit maksimal prej 15 ditësh nga data e paraqitjes së ofertës indikative. Megjithatë, ato mund ta zgjasin periudhën e vlerësimit nëse nuk ka dalë ndërkohë ndonjë ftesë për ofertë.

Autoritetet kontraktuese njoftojnë ofertuesin e përmendur në paragrafin e parë, sa më shpejt që të jetë e mundur, për pranimin e tij në sistemin dinamik të blerjes ose për refuzimin e ofertës së tij indikative.

5. Çdo kontratë specifike i nënshtrohet një ftese për ofertë. Përpara nxjerrjes së ftesës për ofertë, autoritetet kontraktuese publikojnë një njoftim të thjeshtuar kontrate, duke ftuar të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar të paraqesin një ofertë indikative në përputhje me pikën 4, brenda një afati kohor që nuk mund të jetë më pak se 15 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të thjeshtuar. Autoritetet kontraktuese nuk mund të vijojnë me tenderimin deri në përfundimin e vlerësimit të të gjitha ofertave indikative të marra brenda këtij afati kohor.

6. Autoritetet kontraktuese ftojnë të gjithë ofertuesit e pranuar në sistem të paraqesin oferta për çdo kontratë specifike të fituar sipas sistemit. Për këtë qëllim, ato përcaktojnë një afat kohor për paraqitjen e ofertave.

Ato shpallin fituese kontratën e ofertuesit që ka paraqitur ofertën më të mirë, në bazë të kriterëve për shpalljen e kontratës fituese të përcaktuara në njoftimin e kontratës për krijimin e sistemit dinamik të blerjes. Këto kriterë, sipas nevojës, mund të formulohen me më tepër saktësi në ftesën e përmendur në paragrafin e parë.

7. Sistemi dinamik i blerjes nuk mund të zgjasë më shumë se katër vjet, përveçse në raste përjashtimore të justifikuara.

Autoritetet kontraktuese nuk mund ta përdorin këtë sistem për të penguar, kufizuar ose shtrembëruar konkurrencën.

Për operatorët ekonomikë ose palët në sistem nuk mund të vihen tarifa.

Neni 34

Kontratat për punë publike: rregulla të veçanta për banesat sociale të subvencionuara

Në rastin e kontratave publike për projektimin dhe ndërtimin e banesave sociale të subvencionuara, madhësia dhe ndërlíkimi i të cilave si edhe kohëzgjatja e çmuar e punës për të cilat kërkojnë që planifikimi të bazohet nga fillimi në bashkëpunimin e ngushtë brenda një ekipi të përbërë nga përfaqësues të autoriteteve kontraktuese, ekspertë dhe sipërmarrës të cilët do të jenë përgjegjës për kryerjen e punëve, mund të miratohet një procedurë e veçantë për përzgjedhjen e sipërmarrësit më të përshtatshëm për t'u përfshirë në ekip.

Autoritetet kontraktuese përfshijnë, në veçanti, në njoftimin e kontratës një përshkrim sa më të saktë që të jetë e mundur për punët që do të kryhen, me qëllim që sipërmarrësit e interesuar të kenë mundësi të krijojnë një ide të vlefshme të projektit. Gjithashtu, autoritetet kontraktuese, në përputhje me kriteret e përzgjedhjes të përmendura në nenet 45 deri në 52, përcaktojnë në këto njoftime kontratash kushtet personale, teknike, ekonomike dhe financiare që duhet të plotësohen nga kandidatët.

Autoritetet kontraktuese, nëse miratohet kjo procedurë, zbatojnë nenet 2, 35, 36, 38, 39, 41, 42, 43 dhe 45 deri në 52.

KAPITULLI VI

Rregullat për shpalljen dhe transparencën

Seksioni 1

Publikimi i njoftimeve

Neni 35

Njoftimet

1. Autoritetet kontraktuese bëjnë të ditur me anë të një njoftimi paraprak informues të publikuar nga Komisioni ose nga ata vetë në "profilin e blerësit", siç e përshkruan pika 2 shkronja (b) e Shtojcës VIII:

(a) kur bëhet fjalë për furnizime, vlerën totale të çmuar të kontratave ose marrëveshjeve kuadër sipas fushës së produktit, të cilat synojnë të shpallin fituese gjatë 12 muajve vijues, nëse vlera totale e çmuar, duke pasur parasysh nenet 7 dhe 9 është e njëjtë ose më e madhe se 750 000 euro.

Zona e produktit përcaktohet nga autoritetet kontraktuese në mbështetje të nomenklaturës FPP;

(b) kur bëhet fjalë për shërbime, vlerën totale të çmuar të kontratave ose marrëveshjeve kuadër në secilën kategori të shërbimeve të renditura në Shtojcën II A, të cilat synojnë të shpallin fituese gjatë periudhës vijuese 12 mujore, nëse vlera totale e çmuar, duke pasur parasysh dispozitat e neneve 7 dhe 9, është e njëjtë ose më e madhe se 750 000 euro;

(c) kur bëhet fjalë për punime, karakteristikat thelbësore të kontratave për punë ose marrëveshjeve kuadër që synojnë të shpallin fituese, vlera e çmuar e të cilëve është e barabartë ose më e madhe se kufiri monetar i specifikuar në nenin 7, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 9.

Njoftimet e përmendura në shkronjat (a) dhe (b) i dërgohen Komisionit ose publikohen në profilin e blerësit sa më shpejt që të jetë e mundur pas fillimit të vitit buxhetor.

Njoftimi i përmendur në shkronjën (c) i dërgohet Komisionit ose publikohet në profilin e blerësit, sa më shpejt që të jetë e mundur, pas vendimit që miraton planifikimin e kontratave për punime ose marrëveshjeve kuadër që autoritetet kontraktuese synojnë të shpallin fituese.

Autoritetet kontraktuese që publikojnë një njoftim informues në profilet e blerësve të tyre i përcjellin Komisionit, në rrugë elektronike, një njoftim të publikimit të njoftimit paraprak informues, në përputhje me formatin dhe procedurat e detajuara për përcjelljen elektronike të njoftimeve të përmendur në pikën 3 të Shtojcës VIII.

Publikimi i njoftimeve të përmendura në shkronjat (a), (b) dhe (c) është i detyrueshëm vetëm nëse autoritetet kontraktuese zgjedhin mundësinë e shkurtimeve të afateve kohore për marrjen e ofertave siç e përcakton neni 38 pika 4.

Ky paragraf nuk zbatohet për procedurat me negociim pa publikim paraprak të një njoftimi kontrate.

2. Autoritetet kontraktuese që dëshirojnë të shpallin një kontratë fituese ose një marrëveshje kuadër me anë të procedurave të hapura, të kufizuara ose, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 30, me negociim me publikimin e një njoftimi kontrate, ose sipas kushteve të përcaktuara në nenin 29, me anë të një dialogu konkurrues, bëjnë të ditur synimin e tyre me anë të një njoftimi kontrate.

3. Autoritetet kontraktuese që dëshirojnë të krijojnë një sistem dinamik blerjeje bëjnë të ditur synimin e tyre me anë të një njoftimi kontrate.

Autoritetet kontraktuese që dëshirojnë të shpallin një kontratë fituese bazuar në një sistem dinamik blerjeje e bëjnë të ditur synimin e tyre me anë të një njoftimi kontrate të thjeshtuar.

4. Autoritetet kontraktuese që kanë shpallur fituese një kontratë publike ose kanë lidhur një marrëveshje kuadër dërgojnë njoftimin e rezultateve të procedurës për shpalljen e kontratës fituese jo më vonë se 48 ditë pas shpalljes së kontratës ose përfundimit të marrëveshjes kuadër.

Në rast të marrëveshjeve kuadër të lidhura sipas kuptimit të nenit 32, autoritetet kontraktuese nuk janë të detyruara të dërgojnë njoftim për rezultatin e procedurës së shpalljes së kontratës fituese për çdo kontratë të bazuar në atë marrëveshje.

Autoritetet kontraktuese dërgojnë një njoftim me rezultatin e shpalljes së kontratave fituese në bazë të një sistemi dinamik blerjeje brenda 48 ditëve nga shpallja e çdo kontrate. Megjithatë, ato mund t'i grupojnë këto njoftime çdo tremujor. Në këtë rast, ato i dërgojnë njoftimet e grupuara brenda 48 ditëve nga fundi i çdo tremujori.

Në rastin e kontratave publike të shpallura fituese për shërbime të renditura në Shtojcën II B, autoritetet kontraktuese tregojnë në njoftim nëse pranojnë apo jo publikimin e tij. Komisioni, për këto kontrata shërbimi harton rregulla për krijimin e raporteve statistikore në bazë të këtyre njoftimeve dhe për publikimin e këtyre raporteve në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 77 pika 2.

Informacioni i caktuar për shpalljen e kontratës fituese ose lidhjen e marrëveshjes kuadër mund të mos publikohet nëse nxjerrja e këtij informacioni do të pengonte zbatimin e ligjit, ose do të ishte në kundërshtim me interesin publik, do të dëmtonte interesat legjitime tregtare të operatorëve ekonomikë, privat ose publike, ose do të mund të cenonte konkurrencën e ndershme ndërmjet tyre.

Neni 36

Forma dhe mënyra e publikimit të njoftimeve

1. Njoftimet përfshijnë informacionin e përmendur në Shtojcën VII A dhe sipas rastit, çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga autoriteti kontraktues në formatin e formularëve standardë të miratuar nga Komisioni në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 77 pika 2.

2. Njoftimet e dërguara nga autoritetet kontraktuese tek Komisioni dërgohen ose me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim të cilat përcaktohen në pikën 3 të Shtojcës VIII, ose me mjete të tjera. Në rast të përdorimit të procedurës së përsheptuar të përcaktuar në nenin 38 pika 8, njoftimet duhet të dërgohen ose me telefaks ose me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për dërgimin të përcaktuara në pikën 3 të Shtojcës VIII. Njoftimet publikohen në përputhje me karakteristikat teknike për publikim të përcaktuara në pikën 1 shkronja (a) dhe (b) të Shtojcës VIII.

3. Njoftimet e hartuara dhe të transmetuara me mjete elektronike në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim të cilat përcaktohen në pikën 3 të Shtojcës VIII, publikohen jo më vonë se pesë ditë pas dërgimit të tyre.

Njoftimet që nuk janë dërguar me mjete elektronike në përputhje me formatin dhe procedurat për dërgimin të përcaktuara në pikën 3 të Shtojcës VIII publikohen jo më vonë se 12 ditë pasi janë dërguar, ose në rastin e procedurës së përsheptuar të përmendur në nenin 38 pika 8, jo më vonë se pesë ditë pasi janë dërguar.

4. Njoftimet e kontratave publikohen të plota në gjuhën zyrtare të Komunitetit të zgjedhur nga autoriteti kontraktues; ky variant në gjuhë origjinale përbën tekstin e vetëm origjinal. Një përmbledhje e elementeve të rëndësishme të çdo njoftimi publikohet në gjuhët e tjera zyrtare.

Kostot e publikimit të këtyre njoftimeve nga Komisioni mbulohen nga Komuniteti.

5. Njoftimet dhe përmbajtja e tyre nuk mund të publikohen në nivel kombëtar përpara datës në të cilën i janë dërguar Komisionit.

Njoftimet e publikuara në nivel kombëtar nuk përmbajnë informacion të ndryshëm nga ai që përmbajnë njoftimet dërguar Komisionit ose publikuar në një profil blerësi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 35 pika 1, por përcaktojnë datën e dërgimit të njoftimit tek Komisioni ose të publikimit të tij në profilin e blerësit.

Njoftimet e informacionit paraprak nuk mund të publikohen në profilin e blerësit përpara dërgimit tek Komisioni të njoftimit të publikimit në atë formë; ato tregojnë datën e dërgesës.

6. Përmbajtja e njoftimeve që nuk janë dërguar me mjete elektronike në përputhje me formatin dhe procedurat e dërgimit të përcaktuara në pikën 3 të Shtojcës VIII, kufizohen me afërsisht 650 fjalë.

7. Autoritetet kontraktuese duhet të jenë në gjendje të sjellin provën e datave në të cilat janë dërguar njoftimet.

8. Komisioni i jep autoritetit kontraktues konfirmimin e publikimit të informacionit të dërguar duke përmendur datën e atij publikimi. Ky konfirmim përbën provën e publikimit.

Neni 37

Publikim jo i detyrueshëm

Autoritetet kontraktuese mund të publikojnë në përputhje me nenin 36 njoftimet e kontratave publike që nuk i nënshtrohen kërkesës për publikim të përcaktuar në këtë direktivë.

Seksioni 2

Afatet kohore

Neni 38

Afatet kohore për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje dhe për marrjen e ofertave

1. Në përcaktimin e afateve kohore për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, autoritetet kontraktuese marrin veçanërisht parasysh kompleksitetin e kontratës dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pa cenuar afatet minimale të përcaktuara nga ky nen.

2. Në rast të procedurave të hapura, afati kohor minimal për marrjen e ofertave është 52 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës.

3. Në rastin e procedurave të kufizuara, procedurat me negociim me publikimin e një njoftimi kontrate të përmendura në nenin 30 dhe dialogu konkurrues:

(a) afati minimal kohor për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është 37 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës;

(b) në rastin e procedurave të hapura, afati kohor minimal për marrjen e ofertave është 40 ditë nga data e dërgimit të ftesës.

4. Nëse autoritetet kontraktuese kanë publikuar një njoftim paraprak informacioni, afati minimal për marrjen e ofertave sipas pikës 2 dhe 3 shkronja (b) si rregull i përgjithshëm mund të shkurtohet në 36 ditë, por në asnjë rrethanë më pak se 22 ditë.

Afati kohor fillon nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës në procedura të hapura dhe nga data e dërgimit të ftesës për ofertë në procedura të kufizuara.

Afatet e shkurtuara kohore të përmendura në paragrafin e parë lejohen nëse njoftimi paraprak i informacionit ka përfshirë të gjithë informacionin e kërkuar për njoftimin e kontratës në Shtojcën VII A, sa kohë që ky informacion është në dispozicion në kohën e publikimit të njoftimit dhe që njoftimi i informacionit është dërguar për publikim ndërmjet 52 ditëve dhe 12 muajve përpara datës së dërgimit të njoftimit të kontratës.

5. Nëse njoftimet janë hartuar dhe dërguar me mjete elektronike në përputhje me formatin dhe procedurën e dërgimit të përcaktuar në pikën 3 të Shtojcës VIII, afatet kohore për marrjen e ofertave të përmendura në pikën 2 dhe 4 në procedura të hapura dhe afatet kohore për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje të përmendura në pikën 3 shkronja (a), në procedura të kufizuara, me negociim dhe dialog konkurrues, mund të shkurtohet me 7 ditë.

6. Afatet kohore për marrjen e ofertave të përmendura në pikën 2 dhe 3 shkronja (b) mund të shkurtohen me 5 ditë nëse autoriteti kontraktues ofron liri përdorimi të drejtpërdrejtë të pakufizuar dhe të plotë me mjete elektronike për dokumentet e kontratës dhe çdo dokument plotësues nga data e publikimit të njoftimit në përputhje me Shtojcën VIII, që specifikon në tekstin e njoftimit adresën e internetit ku mund të gjendet ky dokumentacion.

Ky shkurtime mund t'i shtohet atij që përmendet në pikën 5.

7. Nëse, për çfarëdo arsye, specifikimet dhe dokumentet mbështetëse ose informuese shtesë, edhe pse të kërkuara në kohë, nuk janë siguruar brenda afateve kohore të përcaktuara në nenet 39 dhe 40, ose nëse ofertat mund të bëhen vetëm pas një vizite në vend ose pas një kontrolli në vend të dokumenteve në mbështetje të dokumenteve të kontratës, afatet kohore për marrjen e ofertave shtyhen, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të përfshirë të jenë në dijeni të informacionit të nevojshëm për përgatitjen e ofertave.

8. Në rastin e procedurave të kufizuara dhe me negociim me publikimin e një njoftimi kontrate të përmendur në nenin 30, nëse për arsye urgjente afati kohor i përcaktuar në këtë nen është i pamundur, autoritetet kontraktuese mund të vendosin:

(a) një afat kohor për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje që nuk mund të jetë më pak se 15 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës, ose më pak se 10 ditë nëse njoftimi është dërguar me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurën për dërgimin e njoftimeve, që tregohet në pikën 3 të Shtojcës VIII;

(b) në rastin e procedurave të hapura, afati kohor për marrjen e ofertave është jo më pak se 10 ditë nga data e dërgimit të ftesës për ofertë.

Neni 39

Procedurat e hapura: Specifikimet, dokumentet dhe informacioni shtesë

1. Në procedura të hapura, nëse autoritetet kontraktuese nuk ofrojnë liri shikimi të drejtpërdrejtë të plotë dhe të pakufizuar me anë të mjeteve elektronike në përputhje me nenin 38 pika 6 për specifikimet dhe çdo dokument tjetër mbështetës, specifikimet dhe dokumentet plotësues u dërgohen operatorëve ekonomikë brenda 6 ditëve nga marrja e kërkesës, me kusht që kërkesa të jetë bërë në kohë përpara afatit për paraqitjen e ofertave.

2. Informacioni shtesë në lidhje me specifikimet dhe çdo dokument plotësues, me kusht që të jetë kërkuar në kohë, sigurohet nga autoritetet kontraktuese ose departamentet kompetente jo më vonë se 6 ditë përpara afatit kohor të caktuar për marrjen e ofertave.

Neni 40

Ftesa për të paraqitur oferta, për të marrë pjesë në dialog ose për të negociuar

1. Në procedura të kufizuara, procedura të dialogut konkurrues dhe procedura me negociim me publikimin e një njoftimi kontrate sipas kuptimit të nenit 30, autoritetet kontraktuese ftojnë në të njëjtën kohë dhe me shkrim kandidatët e përzgjedhur të paraqesin ofertat e tyre ose të negociojnë, ose në rastin e një dialogu konkurrues, të marrin pjesë në dialog.

2. Ftesa për kandidatët përfshin ose:

- një kopje të specifikimeve a dokumentit përshkrues dhe dokumentacion mbështetës, ose
- një lidhje për të parë dhe përdorur specifikimet dhe dokumentet e tjera të treguara në pikën e parë, nëse ato vihen direkt në dispozicion me anë të mjeteve elektronike në përputhje me nenin 38 pika 6.

3. Nëse specifikimet, dokumentin përshkrues dhe/ose dokument mbështetës i ka një subjekt tjetër dhe jo autoriteti kontraktues përgjegjës për procedurën e shpalljes së kontratës fituese, ftesa tregon adresën ku mund të kërkohen këto specifikime, dokumentin përshkrues dhe dokumentet mbështetëse dhe, nëse ka, afatin për t'i kërkuar këto dokumente dhe shumën që paguhet për t'i marrë ato dhe çdo procedurë pagese. Departamenti kompetent me të marrë kërkesën ia dërgon menjëherë dokumentacionin operatorit ekonomik.

4. Informacioni shtesë për specifikimet, dokumenti përshkrues ose dokumentet mbështetëse dërgohen nga autoriteti kontraktues ose departamenti kompetent jo më vonë se 6 ditë përpara datës përfundimtare të caktuar për marrjen e ofertave, me kusht që të kërkohet në kohë. Në rast të një procedure të kufizuar ose të përshpejtuar, kjo periudhë është 4 ditë.

5. Gjithashtu, ftesa për të paraqitur ofertë, për të marrë pjesë në dialog ose për të negociuar duhet të përmbajë të paktën:

- (a) lidhjen me njoftimin e kontratës të publikuar;
- (b) afatin për marrjen e ofertave, adresa ku duhet të drejtohen ftesat dhe gjuhën ose gjuhët në të cilat duhet të hartohen ftesat;
- (c) në rastin e dialogut konkurrues, datën dhe adresën e caktuar për fillimin e konsultimit dhe gjuhën ose gjuhët e përdorura;
- (d) përmendjen e çdo dokumenti të mundshëm shoqërues që duhet të paraqitet, ose në mbështetje të deklaratave të verifikueshme nga ofertuesi në përputhje me nenin 44, ose për të plotësuar informacionin e përmendur në atë nen, dhe sipas kushteve të përcaktuara në nenet 47 dhe 48;
- (e) shkallën e rëndësisë relative të kriterëve për shpalljen e një kontrate fituese ose, sipas rastit, radhën e rëndësisë në zbritje të këtyre kriterëve, nëse nuk jepen në njoftimin e kontratës, specifikime ose dokument përshkrues.

Megjithatë, në rastin e kontratave të shpallura fituese në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 29, informacioni i përmendur në shkronjën (b) më sipër nuk jepet në ftesën për të marrë pjesë në dialog, por jepet në ftesën për të paraqitur ofertë.

Neni 41

Informimi i kandidatëve dhe ofertuesve

1. Autoritetet kontraktuese sa më shpejt që të jetë e mundur njoftojnë kandidatët dhe ofertuesit për vendimet e marra në lidhje me përfundimin e një marrëveshjeje kuadër, shpalljen e kontratës fituese, ose pranimin në një sistem dinamik blerjeje, duke përfshirë arsyet për vendimin për të mos lidhur një marrëveshje kuadër ose për të mos shpallur një kontratë fituese për të cilën ka pasur një ftesë për konkurrim ose për të rifilluar procedurën, ose për të zbatuar një sistem dinamik blerjeje; ky informacion jepet me shkrim nëse autoriteteve kontraktuese u kërkohet kjo gjë.

2. Me kërkesë të palës së interesuar, autoritetet kontraktuese, sa më shpejt që të jetë e mundur, njoftojnë:

- çdo kandidat të pasuksesshëm për arsyet e refuzimit të aplikimit të tij,
- çdo ofertues të pasuksesshëm për arsyet e refuzimit të ofertës së tij, përfshirë këtu rastet e përmendura në nenin 23 pikat 4 dhe 5, arsyet për vendimin e tyre të mosbarasvlershmërisë ose vendimin e tyre që punimet, furnizimet ose shërbimet nuk plotësojnë kërkesat e zbatimit ose funksionale,
- çdo ofertues që ka bërë një ofertë të pranueshme të karakteristikave dhe avantazheve relative të ofertuesit të përzgjedhur, si dhe emrin e ofertuesit të suksesshëm ose palëve në marrëveshjen kuadër. Koha e nevojshme për këtë në asnjë rrethanë nuk i kalon 15 ditë nga marrja e kërkesës me shkrim.

3. Megjithatë, autoritetet kontraktuese mund të vendosin të mos nxjerrin informacionin e përmendur në pikën 1 në lidhje me shpalljen e kontratës fituese, lidhjen e marrëveshjeve kuadër ose pranimin në një sistem dinamik blerjeje nëse nxjerrja e këtij informacioni do të pengonte zbatimin e ligjit, ose do të ishte në kundërshtim me interesin publik, do të dëmtonte interesat legjitime tregtare të operatorëve ekonomikë, privat ose publik, ose do të mund të cenonte konkurrencën e ndershme ndërmjet tyre.

Seksioni 4 Komunikimi

Neni 42

Rregullat e zbatueshme për komunikimin

1. I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit të përmendur në këtë titull mund të bëhet me anë të postës, faksit, mjeteve elektronike në përputhje me pikat 4 dhe 5, me telefon në rastet dhe rrethanat e përmendura në pikën 6, ose me kombinim të këtyre mjeteve, sipas zgjedhjes së autoritetit kontraktues.

2. Mjetet e komunikimit të zgjedhura përgjithësisht duhet të jenë në dispozicion dhe kështu nuk kufizojnë mundësinë e hyrjes së operatorëve ekonomik në procedurat e tenderimit.

3. Komunikimi dhe shkëmbimi e ruajtja e informacionit bëhet në mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe konfidencialitetit të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje dhe që autoritetet kontraktuese të shqyrtojnë përmbajtjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, vetëm pas mbarimit të afatit kohor të përcaktuar për paraqitjen e tyre.

4. Mjetet që duhen përdorur për komunikimin e mjeteve elektronike, si dhe karakteristikat e tyre teknike, duhet të jenë mosdiskriminuese, përgjithësisht në gatishmëri dhe të afta për të ndërvepruar me produktet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përdorim të përgjithshëm.

5. Rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për pajisjet për transmetimin elektronik dhe marrjen e ftesave dhe për pajisjet për marrjen elektronike të kërkesave për pjesëmarrje:

(a) informacioni në lidhje me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ftesave dhe kërkesave për pjesëmarrje, duke përfshirë kodimin, vihet në dispozicion të palëve të interesuara. Gjithashtu, pajisjet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje plotësojnë kërkesat e Shtojcës X;

(b) Shtetet Anëtare, në përputhje me nenin 5 të Direktivës 1999/93/KE mund të kërkojnë që ftesat elektronike të shoqërohen me nënshkrim elektronik të avancuar në përputhje me pikën 1 të saj.

(c) Shtetet Anëtare mund të prezantojnë ose të mbajnë skema të akreditimit vullnetar me synim nivelet e përforcuara të ofrimit të shërbimit të certifikimit për këto pajisje;

(d) ofertuesit ose kandidatët marrin përsipër të paraqesin, përpara mbarimit të afatit kohor të përcaktuar për paraqitjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje, dokumentet, certifikatat dhe deklaratat e përmendura në nenet 45 deri në 50 dhe 52 nëse nuk ekzistojnë në format elektronik.

6. Rregullat e mëposhtme zbatohen për dërgimin e kërkesave për pjesëmarrje:

(a) kërkesat për pjesëmarrje në procedura për shpalljen e kontratave publike fituese mund të bëhen me shkrim ose me telefon;

- (b) nëse kërkesat për pjesëmarrje bëhen me telefon, duhet të dërgohet një konfirmim me shkrim përpara mbarimit të afatit të caktuar për marrjen e tyre;
- (c) autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë që kërkesat për pjesëmarrje të bëra me faks të konfirmohen me postë ose mjete elektronike, nëse kjo është e nevojshme për qëllim të provës ligjore. Çdo kërkesë e tillë, së bashku me afatin kohor për dërgimin e konfirmimit me postë ose mjete elektronike duhet të shprehet nga autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës.

Seksioni 5 Raportet

Neni 43

Përmbajtja e raporteve

Për çdo kontratë, marrëveshje kuadër dhe krijim të një sistemi dinamik blerjeje, autoritetet kontraktuese hartojnë një raport me shkrim që përfshin të paktën sa më poshtë:

- (a) emrin dhe adresën e autoritetit kontraktues, objektin dhe vlerën e kontratës, marrëveshjen kuadër ose sistemin dinamik të blerjes;
- (b) emrat e kandidatëve ose ofertuesve të suksesshëm dhe arsyet për përzgjedhjen e tyre;
- (c) emrat e kandidatëve ose ofertuesve të refuzuar dhe arsyet për refuzimin e tyre;
- (d) arsyet për refuzimin e ofertave që kanë rezultuar jonormale të ulëta;
- (e) emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe arsyet pse është përzgjedhur oferta dhe, nëse dihet, pjesa e kontratës ose marrëveshjes kuadër të cilën ofertuesi i suksesshëm synon të nënkontraktojë me palë të treta;
- (f) për procedura me negocim, rrethanat e përmendura në nenet 30 dhe 31 që justifikojnë përdorimin e këtyre procedurave;
- (g) sa i përket dialogut konkurrues, rrethanat e përcaktuara në nenin 29 që justifikojnë përdorimin e kësaj procedure;
- (h) arsyet, nëse është e nevojshme, pse autoriteti kontraktues ka vendosur të mos shpallë fituese një kontratë ose marrëveshje kuadër ose të krijojë një sistem dinamik blerjeje.

Autoritetet kontraktuese marrin masat e duhura për të dokumentuar progresin e procedurave të shpalljes së fituesit të kryera me anë të mjeteve elektronike.

Raporti, ose veçoritë kryesore të tij, i komunikohet Komisionit, nëse e kërkon.

KAPITULLI VII Zhvillimi i procedurës

Seksioni 1 Dispozita të përgjithshme

Neni 44

Verifikimi i përshtatshmërisë dhe zgjedhja e pjesëmarrësve dhe shpallja e kontratave fituese

1. Kontratat shpallen fituese në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 53 dhe 55 duke pasur parasysh nenin 24 pas kontrollit të përshtatshmërisë të operatorëve ekonomikë që nuk janë përjashtuar sipas neneve 45 dhe 46 nga autoritetet kontraktuese në përputhje me kriteret e gjendjes ekonomike dhe financiare, njohuritë profesionale dhe teknike ose aftësitë e përmendura në nenet 47 deri në 52, dhe sipas rastit, në përputhje me rregullat e mosdiskriminimit dhe kriteret e përmendura në pikën 3.

2. Autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë që kandidatët dhe ofertuesit të plotësojnë nivelet minimale të aftësive në përputhje me nenet 47 dhe 48.

Shtrirja e informacionit të përmendur në nenet 47 dhe 48 dhe nivelet minimale të aftësive të nevojshme për një kontratë specifike duhet të lidhen dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Këto nivele minimale tregohen në njoftimin e kontratës.

3. Në procedura të kufizuara, procedura me negociim me publikimin e një njoftimi kontrate dhe procedura me dialog konkurrues, autoritetet kontraktuese mund të kufizojnë numrin e kandidatëve të përshtatshëm që do të ftojnë për ofertë, për negociim ose për dialog nëse kanë në dispozicion një numër të përshtatshëm kandidatësh. Autoritetet kontraktuese tregojnë në njoftimin e kontratës kriteret ose rregullat objektive dhe mosdiskriminuese që synojnë të zbatojnë, numrin minimal të kandidatëve që synojnë të ftojnë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.

Në procedurë të kufizuar, numri minimal është pesë. Në procedurë me negociim me publikim të një njoftimi kontrate dhe procedurë me dialog konkurrues, numri minimal është tre. Në çdo rast, numri i kandidatëve të ftuar është i mjaftueshëm për të siguruar konkurrencën e vërtetë.

Autoritetet kontraktuese ftojnë disa kandidatë të paktën në numër të barabartë me numrin minimal të përcaktuar paraprakisht. Nëse numri i kandidatëve që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes dhe nivelet minimale të aftësive janë nën numrin minimal, autoriteti kontraktues mund të vazhdojë procedurën duke ftuar kandidatë me aftësitë e kërkuara. Në kontekst të kësaj procedure të njëjtë, autoriteti kontraktues mund të mos përfshijë operatorë të tjerë ekonomikë që nuk kërkuan të marrin pjesë, ose operatorë që nuk kanë aftësitë e kërkuara.

4. Nëse autoritetet kontraktuese ushtrojnë mundësinë e pakësimit të numrit të zgjidhjeve që do të diskutohen ose të ofertave që do të negociohen, siç e parashikon nenet 29 pika 4 dhe 30 pika 4, ato veprojnë duke zbatuar kriteret për shpalljen e kontratës fituese të shprehura në njoftimin e kontratës, në specifikime ose në dokumentin përshkruar. Në fazën e fundit, numri i arritur do të garantojë konkurrencën e vërtetë sa kohë që ka zgjidhje të mjaftueshme ose kandidatë të përshtatshëm.

Seksioni 2

Kriteret për përzgjedhjen cilësore

Neni 45

Situata personale e kandidatit ose ofertuesit

1. Çdo kandidat ose ofertues që ka marrë dënim me vendim të formës së prerë, për të cilin autoriteti kontraktues është në dijeni, për një ose më shumë arsye të përmendura më poshtë, përjashtohet nga pjesëmarrja në një kontratë publike:

(a) pjesëmarrje në organizatë kriminale, siç e përcakton neni 2 pika 1 i Veprimit të Përbashkët të Këshillit 98/733/DPB [20];

(b) korrupsion, siç e përkufizon përkatësisht neni 3 i Aktit të Këshillit, datë 26 maj 1997 [21], dhe neni 3 pika 1 e Veprimit të Përbashkët të Këshillit 98/742/DPB [22];

(c) mashtrim sipas kuptimit të nenit 1 të Konventës në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Europiane [23];

(d) pastrim parash siç e përcakton neni 1 i Direktivës së Këshillit 91/308/KEE, datë 10 qershor 1991, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllim të pastrimit të parave [24].

Shtetet Anëtare specifikojnë në përputhje me të drejtën e tyre kombëtare dhe duke pasur parasysh të drejtën komunitare, kushtet e zbatimit të kësaj pike.

Ato mund të parashikojnë një shmangie nga kërkesa e përmendur në paragrafin e parë për kërkesat parësore në interes të përgjithshëm.

Për qëllimet e kësaj pike, autoritetet kontraktuese, sipas rastit, u kërkojnë kandidatëve ose ofertuesve të sigurojnë dokumentet e përmendura në pikën 3 dhe, në rast se kanë dyshime në lidhje me situatën personale të këtyre kandidatëve ose ofertuesve, mund të kërkojnë gjithashtu nga autoritetet kontraktuese që të marrin informacionin që e konsiderojnë të nevojshëm për situatën personale të kandidatëve ose ofertuesve të përfshirë. Në rastet kur informacioni ka të bëjë me një kandidat ose ofertues në një shtet të ndryshëm nga ai i autoritetit kontraktues, autoriteti kontraktues mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente. Duke pasur parasysh të drejtën kombëtare të Shtetit Anëtar ku janë kandidatët ose ofertuesit, këto kërkesa lidhen me personat fizikë dhe/ose juridikë, duke përfshirë, nëse duhet, anëtarët e këshillit të administrimit të shoqërive tregtare dhe çdo person me të drejtë përfaqësimi, vendimi ose kontrolli në drejtim të kandidatit ose ofertuesit.

2. Çdo operator ekonomik mund të përjashtohet nga pjesëmarrja në një kontratë nëse ai operator ekonomik:

- (a) ka falimentuar ose do të falimentojë, veprimtaria e tij administrohet nga gjykata, ka filluar një marrëveshje me kreditorët, ka pezulluar veprimtarinë tregtare ose është në situatë të ngjashme që krijohet nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve dhe rregullave kombëtare;
 - (b) i nënshtrohet procedurës për shpalljen e falimentimit, për urdhër të falimentimit të detyrueshëm ose administrimit nga gjykata, ose një marrëveshjeje me kreditorët apo çdo procedure tjetër të ngjashme sipas ligjeve dhe rregullave kombëtare;
 - (c) është dënuar me vendim gjykate i cili ka forcën *res judicata* sipas dispozitave ligjore të vendit ku është kryer shkelja në lidhje me sjelljen profesionale;
 - (d) ka qenë fajtor për sjellje të rëndë profesionale të provuar me çdo mënyrë që mund të tregojnë autoritetet kontraktuese ;
 - (e) nuk ka përmbushur detyrimet në lidhje me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore në përputhje me dispozitat ligjore të vendit ku është vendosur ose me ato të vendit të autoritetit kontraktues;
 - (f) nuk ka përmbushur detyrimet në lidhje me pagimin e taksave sipas dispozitave ligjore të vendit ku është vendosur ose me ato të vendit të autoritetit kontraktues;
 - (g) është fajtor për deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar sipas këtij seksioni ose për mosdhënie të këtij informacioni.
- Shtetet Anëtare specifikojnë në përputhje me të drejtën e tyre kombëtare dhe duke pasur parasysh të drejtën komunitare, kushtet e zbatimit të kësaj pike.

3. Autoritetet kontraktuese pranojnë sa më poshtë si prova të mjaftueshme që asnjë nga rastet e specifikuar në pikat 1 ose 2 shkronjat (a), (b), (c), (e) ose (f) nuk zbatohet për operatorin ekonomik:

- (a) në lidhje me pikën 1 dhe 2 shkronjat (a), (b) dhe (c), nxjerrjen e një ekstrakti nga “regjistri gjyqësor” ose në pamundësi të kësaj, të një dokumenti të ngjashëm të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor ose administrativ në vendin e origjinës ose në vendin prej nga vjen ai person për të treguar plotësimin e këtyre kërkesave;
- (b) në lidhje me pikën 2 shkronjat (e) dhe (f), një vërtetim të lëshuar nga autoriteti kompetent në Shtetin Anëtar të përfshirë.

Nëse vendi në fjalë nuk i lëshon këto dokumente ose vërtetime, ose nëse këto nuk mbulojnë të gjitha rastet e specifikuar në pikën 1 dhe 2 shkronjat (a), (b) dhe (c), ato mund të zëvendësohen me një deklaratë nën betim ose, në Shtetet Anëtare ku nuk parashikohen deklaratat nën betim, me një deklaratë solemne të bërë nga personi në fjalë përpara një autoriteti kompetent gjyqësor ose administrativ, një noteri ose organi kompetent profesional ose tregtar, në vendin e origjinës ose në vendin prej nga vjen ai person.

4. Shtetet Anëtare përcaktojnë autoritetet dhe organet kompetente për të lëshuar dokumente, vërtetime ose deklarata të përmendura në pikën 3 dhe vënë në dijeni Komisionin në lidhje me to. Ky njoftim nuk cenon ligjin për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 46

Përshtatshmëria për ndjekjen e veprimtarisë profesionale

Çdo operatori ekonomik që dëshiron të marrë pjesë në një kontratë publike mund t’i kërkohe të provojë përfshirjen e tij në një nga regjistrat profesionale ose tregtare, siç e parashikon Shteti Anëtar ku është krijuar ai, ose të japë një deklaratë nën betim ose një vërtetim siç e përshkruan Shtojca IX A për kontratat publike për punë, Shtojca IX B për kontratat publike për furnizim dhe Shtojca IX C për kontratat publike për shërbim.

Në procedura për shpalljen e kontratave publike fituese, nëse kandidatët ose ofertuesit duhet të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë, me qëllim që të jenë në gjendje të kryejnë në vendin e tyre të origjinës shërbimin në fjalë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë prej tyre këtë autorizim ose anëtarësim.

Neni 47

Gjendja ekonomike dhe financiare

1. Prova e gjendjes ekonomike dhe financiare të operatorit ekonomik, si rregull i përgjithshëm, mund të jepet me anë të një ose më shumë referencave të mëposhtme:
 - (a) deklarata të duhura nga bankat, ose sipas rastit, dokument provues të rëndësishëm që mbulon sigurimin kundër rrezikut profesional;
 - (b) paraqitjen e bilanceve ose ekstrakteve nga bilanci, nëse publikimi i bilanceve kërkohet sipas ligjit të vendit ku ndodhet operatori ekonomik;
 - (c) deklaratë e xhiros së plotë të ndërmarrjes dhe, sipas rastit, të xhiros në fushën që mbulon kontrata maksimalisht tre viteve financiare, në varësi të datës së krijimit të ndërmarrjes ose fillimit të veprimtarisë së operatorit ekonomik, nëse ka informacion për këto xhiro.
2. Një operator ekonomik, sipas rastit dhe për një kontratë të veçantë, mund të mbështetet në aftësitë e subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës ligjore të lidhjeve që ka me ato. Ai duhet të provojë në këtë rast për autoritetin kontraktues që do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull, nëpërmjet një ndërmarrjeje nga këto subjekte për këtë qëllim.
3. Sipas të njëjtave kushte, grupi i operatorëve ekonomikë i përmendur në nenin 4 mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose të subjekteve të tjera.
4. Autoritetet kontraktuese specifikojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë referencën ose referencat e përmendura në pikën 1 që kanë zgjedhur dhe referenca të tjera që duhet të jepen.
5. Nëse operatori ekonomik, për çdo arsye të vlefshme, nuk është në gjendje të japë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues, ai mund të provojë gjendjen e tij ekonomike dhe financiare me një dokument tjetër të cilin autoriteti kontraktues e konsideron të përshtatshëm.

Neni 48

Aftësia teknike dhe/ose profesionale

1. Aftësitë teknike dhe/ose profesionale të operatorëve ekonomikë vlerësohen dhe shqyrtohen sipas pikës 2 dhe 3.
2. Aftësitë teknike të operatorit ekonomik mund të provohen me anë të një ose më shumë prej mënyrave të mëposhtme, sipas natyrës, sasisë ose rëndësisë dhe përdorimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve:
 - (i) lista e punëve të kryera gjatë pesë viteve të shkuara, shoqëruar me vërtetime për ekzekutimin e kënaqshëm të çdo pune të rëndësishme. Këto vërtetime tregojnë vlerën, datën dhe vendin e punës dhe specifikojnë nëse puna është kryer në përputhje me rregullat e tregtisë dhe nëse ka përfunduar si duhet. Autoriteti kompetent, sipas rastit, i paraqet këto vërtetime drejtpërdrejt tek autoriteti kontraktues;
 - (ii) lista e furnizimeve ose shërbimeve kryesore të ofruara gjatë tre viteve të shkuara, me shumat, datat dhe marrësit e përfshirë, privatë apo publikë. Furnizimet dhe ofrimi i shërbimeve provohen:
 - nëse marrësi është autoritet kontraktues, me anë të vërtetimeve të lëshuara ose kundërfirmosura nga autoriteti kompetent;
 - nëse marrësi është blerës privat, me anë të vërtetimit të blerësit, ose në pamundësi të kësaj, thjesht me anë të një deklaratë nga operatori ekonomik;
 - (b) informacion për teknikët ose organet teknike të përfshira, që i përkasin apo jo në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmarrjes së operatorit ekonomik, sidomos ata që janë përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe, në rastin e kontratave publike për punë, ata që mund të thërrasë sipërmarrësi për të kryer një punë;
 - (c) përshkrim i mjeteve dhe masave teknike të përdorura nga furnizues ose ofruesi i shërbimit për të siguruar cilësinë dhe ambientet e kërkimit dhe studimit të sipërmarrësit;
 - (d) nëse produktet ose shërbimet e furnizuara janë komplekse, ose përjashtimisht, kërkohen për një qëllim të veçantë, një kontroll i kryer nga autoritetet kontraktuese ose në emër të tyre nga një organ kompetent zyrtar i vendit ku ndodhet furnizuesi ose ofruesi i shërbimit, që i nënshtrohet marrëveshjes së atij organi për kapacitetin prodhues të furnizuesit ose aftësisë teknike të ofruesit të shërbimit dhe,

nëse është e nevojshme, për mjetet e studimit ose kërkimit që janë në dispozicion të tij dhe masat e kontrollit të sigurisë që do të përdorë;

(e) kualifikime profesionale dhe arsimore të ofruesit të shërbimit ose sipërmarrësit dhe/ose të stafit drejtues të sipërmarrjes dhe, sidomos, të personit ose personave përgjegjës për të ofruar shërbimet ose menaxhuar punën;

(f) për kontrata publike për punë dhe kontrata publike për shërbime, dhe vetëm në raste të duhura, një tregues i masave të menaxhimit mjedisor që operatori ekonomik do të jetë në gjendje të zbatojë kur realizon kontratën;

(g) deklaratë e fuqisë punëtore mesatare vjetore e ofruesit të shërbimit ose sipërmarrësit dhe numrit të stafit drejtues gjatë tre viteve të fundit;

(h) deklaratë të mjeteve, materialit dhe pajisjes teknike në dispozicion të ofruesit të shërbimit ose sipërmarrësit për zbatimin e kontratës;

(i) informacion për pjesën e kontratës që ofruesi i shërbimit synon të nënkontrakttojë mundësisht;

(j) në lidhje me produktet që do të furnizohen:

(i) mostra, përshkrime dhe/ose fotografi, autenticiteti i të cilave duhet të provohet nëse e kërkon autoriteti kontraktues;

(ii) vërtetime të hartuara nga institute zyrtare të kontrollit të cilësisë ose agjenci të njohura që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve të identifikuara qartë me anë të referencave në specifikime ose standarde.

3. Një operator ekonomik, sipas rastit dhe për një kontratë të veçantë, mund të mbështetet në aftësitë e subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës ligjore të lidhjeve që ka me ato. Ai duhet të provojë në këtë rast autoritetit kontraktues që do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për zbatimin e kontratës, për shembull, nëpërmjet një sipërmarrjeje nga këto subjekte për të vënë në dispozicion të operatorit ekonomik burimet e nevojshme.

4. Sipas të njëjtave kushte, grupi i operatorëve ekonomikë i përmendur në nenin 4 mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera.

5. Në procedura për shpalljen fituese të kontratave publike që kanë si objekt furnizimet të cilat kërkojnë punë vendosjeje ose instalimi, ofrimin e shërbimeve dhe/ose ekzekutimin e punës, aftësia e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin ose kryer instalimin ose punën mund të vlerësohet, në veçanti, në lidhje me aftësitë e tyre, eficientë, përvojën dhe besueshmërinë.

6. Autoriteti kontraktues në njoftim ose në ftesën për ofertë specifikon referencën që dëshiron të marrë sipas pikës 2.

Neni 49

Standardet e sigurimit të cilësisë

Nëse autoritetet kontraktuese kërkojnë vërtetime të hartuara nga organet e pavarura që provojnë respektimin nga operatori ekonomik të disa standardeve të sigurimit të cilësisë, ato mbështeten në sistemet e sigurimit të cilësisë bazuar në një sërë standardesh të rëndësishme europiane të certifikuara nga organet që respektojnë serinë e standardeve europiane në lidhje me vërtetimin. Ato njohin vërtetimet e njëjta nga organet e krijuara në Shtete të tjera Anëtare. Ato pranojnë gjithashtu prova të tjera të masave të njëjta të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomikë.

Neni 50

Standardet e menaxhimit mjedisor

Nëse autoritetet kontraktuese, në rastet e përmendura në nenin 48 pika 2 shkronja (f), kërkojnë vërtetime të hartuara nga organe të pavarura që vërtetojnë respektimin nga operatori ekonomik të disa standardeve të menaxhimit mjedisor, ato mbështeten në Skemën Komunitare për Eko-Menaxhim dhe Auditim (EMAS) ose standardet e menaxhimit mjedisor bazuar në standarde të rëndësishme europiane ose ndërkombëtare, të certifikuara nga organet që respektojnë legjislacionin komunitar, ose standarde të rëndësishme europiane ose ndërkombëtare në lidhje me certifikimin. Ato njohin

vërtetimet e njëjta nga organet e krijuara në Shtete të tjera Anëtare. Ato pranojnë gjithashtu prova të tjera të masave të njëjta të menaxhimit mjedisor nga operatorët ekonomikë.

Neni 51

Dokumentacion dhe informacion shtesë

Autoriteti kontraktues mund t'i ftojë operatorët ekonomikë që të plotësojnë ose qartësojnë vërtetimet dhe dokumentet e paraqitura sipas neneve 45 deri në 50.

Neni 52

Listat zyrtare të operatorëve ekonomikë të miratuar dhe certifikimi i organeve të krijuara sipas të drejtës publike ose private

1. Shtetet Anëtare mund të prezantojnë ose lista zyrtare të miratuara të sipërmarrësve, furnizuesve ose ofruesve të shërbimeve, ose certifikim nga organet certifikuese të krijuara sipas të drejtës publike ose private.

Shtetet Anëtare përshtatin kushtet për regjistrimin në këto lista dhe për nxjerrjen e vërtetimeve nga organet certifikuese me dispozitat e neneve 45 pika 1, 45 pika 2 shkronjat (a) deri në (d) dhe (g), 46, 47 pikat 1, 4 dhe 5, 48 pikat 1, 2, 5 dhe 6, 49 dhe, sipas rastit, 50.

Shtetet Anëtare gjithashtu i përshtatin ato me nenet 47 pika 2 dhe 48 pika 3 në lidhje me aplikimet për regjistrim të paraqitura nga operatorët ekonomikë që i përkasin një grupi dhe që kanë burimet të cilat u janë vënë në dispozicion nga shoqëri të tjera tregtare në grup. Në këtë rast, këta operatorë duhet t'i provojnë autoritetit që përcakton listën zyrtare se do i kenë këto burime në dispozicion të tyre gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së vërtetimit, që provon regjistrimin e tyre në listë dhe që gjatë kësaj periudhe këto shoqëri tregtare do të vazhdojnë të plotësojnë kërkesat e përzgjedhjes cilësore, të përcaktuara në nenet e përmendura në paragrafin e dytë, në të cilat bazohen operatorët për regjistrimin e tyre.

2. Operatorët ekonomikë të regjistruar në listat zyrtare ose që kanë një vërtetim për çdo kontratë mund t'i paraqesin autoritetit kontraktues një vërtetim të regjistrimit, të lëshuar nga autoriteti kompetent, ose vërtetimin e lëshuar nga organi kompetent i certifikimit. Vërtetimet tregojnë referencat që kanë bërë të mundur regjistrimin e tyre në listë/për të marrë certifikimin dhe klasifikimin e dhënë në atë listë.

3. Regjistrimi i certifikuar në listat zyrtare nga organet kompetente ose një vërtetim i lëshuar nga organi i certifikimit për qëllimet e autoriteteve kontraktuese të Shteteve të tjera Anëtare nuk përbëjnë prezumim të përshtatshmërisë, përveçse në lidhje me nenet 45 pikat 1 dhe 2 shkronjat (a) deri në (d) dhe (g), 46, 47 pika 1 shkronjat (b) dhe (c) dhe 48 pika 2 paragrafi (i), shkronjat (b), (e), (g) dhe (h) në rastin e sipërmarrësve, me nenin 2 shkronjat (a) paragrafi (ii), (b), (c), (d) dhe (j) në rastin e furnizuesve dhe me nenin 2 shkronjat (a) paragrafi (ii) dhe (c) deri në (i) në rastin e ofruesve të shërbimit.

4. Informacioni që mund të nxirret nga listat zyrtare ose certifikimi nuk mund të vihen në diskutim pa arsye. Në lidhje me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe taksave, mund të kërkohet një vërtetim shtesë nga çdo operator ekonomik i regjistruar sa herë që ofrohet një kontratë. Autoritetet kontraktuese të Shteteve të tjera Anëtare zbatojnë pikën 3 dhe paragrafin e parë të kësaj pike vetëm në favor të operatorëve ekonomikë të krijuar në Shtetin Anëtar që ka listën zyrtare.

5. Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë të Shteteve të tjera Anëtare në listën zyrtare ose për certifikimin e tyre nga organet e përmendura në pikën 1, nuk mund të kërkohet provë ose deklaratë tjetër e ndryshme nga ato që kërkojnë nga operatorët ekonomikë kombëtarë dhe, në çdo rast, vetëm ato që parashikohen në nenet 45 deri në 49 dhe, sipas rastit, në nenin 50.

Megjithatë, operatorët ekonomikë nga Shtetet e tjera Anëtare nuk mund të detyrohen t'i nënshtrohen këtij regjistrimi ose certifikimi për të marrë pjesë në një kontratë. Autoritetet kontraktuese njohin vërtetimet e njëjta nga organet e krijuara në Shtete të tjera Anëtare. Ato pranojnë gjithashtu çdo mjet tjetër të njëjtë prove.

6. Operatorët ekonomikë mund të kërkojnë në çdo kohë që të regjistrohen në listën zyrtare ose për nxjerrjen e një vërtetimi. Ato duhet të njoftohen brenda një kohe të shkurtër të arsyeshme për vendimin e autoritetit që harton listën ose të organit kompetent të certifikimit.

7. Organet certifikuese të përmendura në pikën 1 janë organet që respektojnë standardet europiane të certifikimit.

8. Shtetet Anëtare që kanë lista zyrtare ose organet certifikuese, siç përmendet në pikën 1, detyrohen të vënë në dijeni Komisionin dhe Shtetet e tjera Anëtare për adresën e organit ku duhet të dërgohen aplikimet.

Seksioni 3 Shpallja e kontratës fituese

Neni 53 **Kriteret për shpalljen e kontratës fituese**

1. Pa cenuar ligjet, rregullat ose dispozitat administrative kombëtare, në lidhje me shpërblimin e disa shërbimeve, kriteret mbi të cilat autoritetet kontraktuese mbështesin shpalljen e kontratave publike fituese janë:

(a) nëse shpallet fituese oferta me përfitim më të madh ekonomik sipas këndvështrimit të autoritetit kontraktues, kriteret e ndryshme që lidhen me objektin e kontratës publike në fjalë, për shembull, cilësia, çmimi, meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, karakteristikat mjedisore, koston e funksionimit, koston e përdorimit, shërbim pas shitjes dhe asistencë teknike, datën e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit, ose

(b) vetëm çmimi më i ulët.

2. Autoritetet kontraktuese pa cenuar dispozitat e paragrafit të tretë, në rastin e përmendur në pikën 1 shkronja (a), specifikojnë në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e kontratës, ose në rast të një dialogu konkurrues në dokumentin përshkrues, shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën me përfitim më të madh ekonomik.

Kjo shkallë rëndësie mund të shprehet duke parashikuar një gjerësi variacioni të duhur maksimale.

Nëse sipas autoritetit kontraktues, shkalla e rëndësisë nuk është e mundur për arsye që mund të tregohen, autoriteti kontraktues tregon në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e kontratës, ose në rastin e dialogut konkurrues, në dokumentin përshkrues, kriteret në radhën zbritëse të rëndësisë.

Neni 54 **Përdorimi i ankandeve elektronike**

1. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktuese të përdorin ankande elektronike.

2. Në procedura të hapura, të kufizuara ose me negociim në rastin e përmendur në nenin 30 pika 1 shkronja (a), autoritetet kontraktuese mund të vendosin që shpallja e një kontrate fituese të paraprihet nga një ankand elektronik, nëse specifikimet e kontratës mund të përcaktohen me saktësi.

Në të njëjtat rrethana, ankandi elektronik mund të bëhet me rihapjen e konkurrencës mes palëve në një marrëveshje kuadër, siç e parashikon fjalia e dytë e paragrafit të dytë të pikës 4 të nenit 32, dhe me hapjen e konkurrencës së kontratave që do të shpallen fituese sipas një sistemi dinamik blerjeje të përmendur në nenin 33.

Ankandi elektronik bazohet:

- ose vetëm në çmime nëse kontrata fituese është ajo me çmim më të vogël;
- ose në çmime dhe/ose vlera të reja të veçorive të ofertave të treguara në specifikim, nëse kontrata fituese është oferta me përfitim më të madh ekonomik.

3. Autoritetet kontraktuese që vendosin të zhvillojnë ankand elektronik e shprehin këtë fakt në njoftimin e kontratës.

Specifikimet përfshijnë, inter alia, detajet e mëposhtme:

- (a) veçoritë vlera e të cilave do t'i nënshtrohet ankandit elektronik, me kusht që këto veçori të jenë të matshme dhe të shprehen në shifra ose përqindje;
- (b) çdo kufizim për vlerat që mund të paraqiten, siç rezultojnë nga specifikimet në lidhje me objektin e kontratës;
- (c) informacionin që u vihet në dispozicion ofertuesve gjatë ankandit elektronik dhe, sipas rastit, kur t'u vihet në dispozicion atyre;
- (d) informacioni i rëndësishëm në lidhje me procesin e ankandit elektronik;
- (e) kushtet sipas të cilave ofertuesit do të jenë në gjendje të bëjnë ofertën dhe sidomos dallimet minimale që, sipas rastit, do të kërkohen kur të bëhet oferta;
- (f) informacioni i rëndësishëm në lidhje me pajisje elektronike të përdorura dhe rregullat dhe specifikimet teknike për lidhjen.

4. Autoritetet kontraktuese përpara se të fillojë ankand elektronik bëjnë një vlerësim të plotë fillestar të ofertave në përputhje me kriterin/kriteret e përcaktuara të shpalljes së kontratës fituese dhe rëndësisë që caktohet për ato.

Të gjithë ofertuesit që kanë paraqitur oferta të pranueshme ftohen njëkohësisht me mjete elektronike të paraqesin çmime të reja dhe/ose vlera të reja; ftesa përmban të gjithë informacionin e rëndësishëm për lidhjen individuale me pajisjen elektronike që përdoret dhe përcakton datën dhe kohën e fillimit të ankandit elektronik. Ankand elektronik mund të bëhet në disa faza të njëpasnjëshme. Ankand elektronik nuk mund të fillojë më shpejt se dy ditë pune pas datës së dërgimit të ftesave.

5. Ftesa, nëse kontrata duhet shpallur fituese në bazë të ofertës me përfitim më të madh ekonomik, shoqërohet me rezultatin e një vlerësimi të plotë të ofertuesit përkatës të kryer në përputhje me rëndësinë e parashikuar në pikën e parë të nenit 53 pika 2.

Ftesa shpreh gjithashtu formulën matematike që do të përdoret në ankandin elektronik për të përcaktuar renditjen, përsëri automatike, në bazë të çmimeve të reja dhe/ose vlerave të reja të paraqitura. Kjo formulë përfshin peshimin e të gjitha kriterëve të përcaktuara për të vendosur për ofertën me përfitim më të madh ekonomik, siç e tregon njoftimi i kontratës ose specifikimet; megjithatë për këtë qëllim, gama të tilla reduktohen paraprakisht në një vlerë të specifikuar.

Nëse autorizohen variante, për çdo variant parashikohet një formulë e veçantë.

6. Autoritetet kontraktuese gjatë çdo faze të një ankand elektronik u komunikojnë menjëherë të gjithë ofertuesve të paktën informacionin e mjaftueshëm për të bërë të mundur renditjet e tyre relative në çdo moment. Ato gjithashtu mund të komunikojnë informacion tjetër në lidhje me çmime ose vlera të tjera të paraqitura, me kusht që kjo të përcaktohet në specifikime. Ato gjithashtu mund të shpallin në çdo kohë numrin e pjesëmarrësve në atë fazë të ankandit. Megjithatë, në çdo rast, ato nuk mund të zbulojnë ofertuesit gjatë çdo faze të ankandit elektronik.

7. Autoritetet kontraktuese e mbyllin një ankand elektronik në një ose më shumë nga mënyrat e mëposhtme:

- (a) në ftesën për pjesëmarrje në ankand ato tregojnë datën dhe kohën e caktuar paraprakisht;
- (b) nëse nuk marrin më çmime të reja ose vlera të reja që plotësojnë kërkesat në lidhje me dallimet minimale. Në këtë rast, autoritetet kontraktuese përcaktojnë në ftesën për pjesëmarrje në ankand kohën që do të lejojnë të kalojë pas marrjes së paraqitjeve të fundit përpara se të mbyllin ankandin elektronik;
- (c) nëse është arritur numri i fazave në ankand, i caktuar në ftesën për pjesëmarrje në ankand.

Nëse autoritetet kontraktuese vendosin të mbyllin një ankand elektronik në përputhje me shkronjën (c), mundësisht në kombinim me rregullat e përcaktuara në shkronjën (b), ftesa për pjesëmarrje në ankand tregon afatin kohor për çdo fazë të ankandit.

8. Autoritetet kontraktuese, pas mbylljes së një ankand elektronik, shpallin kontratën fituese në përputhje me nenin 53 në bazë të rezultateve të ankandit elektronik.

Autoritetet kontraktuese nuk mund të përdorin ankandet elektronike të papërshtatshme, as nuk mund t'i përdorin ato në mënyrë të tillë që pengon, kufizon ose shtrembëron konkurrencën ose ndryshon

objektin e kontratës, siç është paraqitur për ofertën në njoftimin e publikuar të kontratës dhe siç është përcaktuar në specifikim.

Neni 55

Oferta jonormale të ulëta

1. Nëse, për një kontratë të caktuar, oferta në lidhje me mallrat, punimet ose shërbimet duket jonormale e ulët, autoriteti kontraktues përpara refuzimit të këtyre ofertave, mund të kërkojë me shkrim detaje të elementeve përbërës të ofertës, që i konsideron të rëndësishme.

Këto detaje në veçanti mund të lidhen me:

- (a) ekonominë e metodës së ndërtimit, procesin e prodhimit ose shërbimet e ofruara;
- (b) zgjidhjet teknike të zgjedhura dhe/ose çdo kusht përjashtimisht të favorshëm në dispozicion të ofertuesit për ekzekutimin e punës, furnizimin e mallrave ose shërbimeve;
- (c) origjinalitetin e punës, furnizimeve, ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- (d) respektimin e dispozitave në lidhje me mbrojtjen e punësimit dhe kushtet e punës në fuqi në vendin ku do të kryhet punimi, shërbimi ose furnizimi;
- (e) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

2. Autoriteti kontraktues i verifikon këto elemente përbërëse në konsultim me ofertuesin, duke pasur parasysh provën e dhënë.

3. Nëse një autoritet kontraktues përcakton që një ofertë është e ulët në mënyrë jonormale për shkak se ofertuesi ka fituar ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet për këtë arsye vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të mjaftueshëm të caktuar nga autoriteti kontraktues, që ndihma në fjalë është dhënë në mënyrë të ligjshme. Nëse autoriteti kontraktues refuzon një ofertë në këto rrethana, ai e vë në dijeni Komisionin për këtë fakt.

TITULLI III

RRUGULLAT PËR KONCESIONET NË PUNËT PUBLIKE

KAPITULLI I

Rregullat që rregullojnë koncesionet në punë publike

Neni 56

Fusha e veprimit

Ky Kre zbatohet për kontratat e koncesionit për punë publike të përfunduara nga autoritetet kontraktuese kur vlera e kontratave është i barabartë ose më i madh se 6 242 000 euro.

Vlera llogaritet në përputhje me rregullat e zbatueshme për kontratat për punë publike të përcaktuara në nenin 9.

Neni 57

Përjashtimet nga fusha e veprimit

Ky Titull nuk zbatohet për koncesionet për punë publike që shpallen fituese:

(a) në rastet e përmendura në nenet 13, 14 dhe 15 të kësaj direktive në lidhje me kontrata publike për punë;

(b) nga autoritetet kontraktuese që kryejnë një ose më shumë veprimtari të përmendura në nenin 3 deri në 7 të Direktivës 2004/17/KE, nëse këto koncesione janë dhënë për të kryer këto veprimtari.

Megjithatë, kjo direktivë vazhdon të zbatohet për koncesionet për punë publike të shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese që kryejnë një ose më shumë nga veprimtaritë e përmendura në nenin 6 të Direktivës 2004/17/KE dhe të shpallura fituese për këto veprimtari, në masën që Shteti Anëtar në fjalë përfiton nga mundësia e përmendur në paragrafin e dytë të nenit 71 të kësaj direktive që të shmangë zbatimin e saj.

Neni 58

Publikimi i njoftimeve në lidhje me koncesionet për punë publike

1. Autoritetet kontraktuese që dëshirojnë të shpallin fituese një kontratë koncesioni për punë publike e bëjnë të ditur synimin e tyre me anë të një njoftimi.
2. Njoftimet e koncesioneve për kontrata publike përfshijnë informacionin e përmendur në Shtojcën VII C dhe sipas rastit, çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga autoriteti kontraktues në përputhje me formularët standardë të miratuar nga Komisioni sipas procedurës së përmendur në nenin 77 pika 2.
3. Njoftimet publikohen në përputhje me nenin 36 pikat 2 deri në 8.
4. Neni 37 për publikimin e njoftimeve zbatohet gjithashtu për koncesionet për punë publike.

Neni 59

Afati kohor

Nëse autoritetet kontraktuese vijojnë me koncesionin për kontrata publike, afati kohor për paraqitjen e aplikimeve për koncesion nuk është më pak se 52 ditë nga data e dërgimit të njoftimit, përvec rastit kur zbatohet neni 38 pika 5.
Zbatohet neni 38 pika 7.

Neni 60

Nënkontraktimi

Autoriteti kontraktues:

- (a) ose i kërkon koncesionarit të shpallë fituese të palët e treta kontratat që përfaqësojnë një minimum prej 30% të vlerës totale të punës, për të cilën do të shpallet fituese kontrata e koncesionit, duke ofruar në të njëjtën kohë mundësinë që kandidatët ta rrisin këtë përqindje të specifikuar në kontratën e koncesionit, ose
- (b) u kërkon kandidatëve për kontratat e koncesionit të specifikojnë në ofertat e tyre përqindjen, nëse ka, ose vlerën totale të punës për të cilën do të shpallet kontrata fituese që synojnë t'ua ngarkojnë palëve të treta.

Neni 61

Ngarkimi i koncesionarit me punë shtesë

Kjo direktivë nuk zbatohet për punët shtesë që nuk përfshihen në projekt koncesioni të konsideruar fillimisht ose në kontrata fillestare, por që nëpërmjet rrethanave të paparashikuara bëhen të nevojshme për kryerjen e punës së përshtuar në to, të cilat autoriteti kontraktues i ngarkon koncesionarit, me kushtin që operatorit ekonomik që kryen këtë punë të shpallet fitues:

- nëse këto punë nuk mund të ndahen teknikisht apo ekonomikisht nga kontrata fillestare, pa shkaktuar problem të madh për subjektet kontraktuese, ose
- nëse këto punë, edhe pse mund të ndahen nga zbatimi i kontratës fillestare, janë rreptësisht të nevojshme në përfundimin e saj;

Megjithatë, vlera agregate e kontratave të shpallura fituese për punë shtesë nuk mund të kalojë 50% të shumës së kontratës fillestare të koncesionit për punë;

KAPITULLI II

Rregullat për kontratat e shpallura fituese nga koncesionarët që janë autoritete kontraktuese

Neni 62

Rregullat e zbatueshme

Nëse koncesionari është autoritet kontraktues siç përcakton neni 1 pika 9, ai vepron në përputhje me dispozitat e përcaktuara nga kjo direktivë për kontratat për punë publike në rastin e punëve që duhet të kryhen nga palët e treta.

KAPITULLI III

Rregullat e zbatueshme për kontratat e shpallura fituese nga koncesionarët që nuk janë autoritete kontraktuese

Neni 63

Rregullat e shpalljes: kufiri monetar dhe përjashtimet

1. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që koncesionarët e punëve publike, të cilët nuk janë autoritete kontraktuese, të zbatojnë rregullat e shpalljes të përcaktuara në nenin 64 kur shpallin kontrata fituese nga palë të treta, nëse vlera e këtyre kontratave është e barabartë ose më e madhe se 6 242 000 euro.

Megjithatë, shpallja kërkohet nëse një kontratë për punë plotëson kushtet e renditura në nenin 31. Vlera e kontratave llogaritet në përputhje me rregullat e zbatueshme për kontratat për punë publike të përcaktuara në nenin 9.

2. Grupet e sipërmarrjeve që janë formuar për të fituar një koncesion ose sipërmarrjeve që lidhen me to nuk konsiderohen palë të treta.

"Sipërmarrje e lidhur" është sipërmarrja mbi të cilën koncesionari mund të ushtrojë ndikim dominues, drejtpërdrejt apo tërthorazi, ose një sipërmarrje që mund të ushtrojë ndikim dominues mbi koncesionarin ose që, ashtu si koncesionari, i nënshtrohet ndikimit dominues të një sipërmarrjeje tjetër si pasojë e pronësisë, pjesëmarrjes financiare ose rregullave që e rregullojnë atë. Ndikimi dominues nga ana e një sipërmarrjeje prezumohet kur ajo, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në lidhje me një sipërmarrje:

(a) ka shumicën e kapitalit të nënshkruar të sipërmarrjes, ose

(b) kontrollon shumicën e votave që u korrespondojnë aksioneve të lëshuara nga sipërmarrja, ose

(c) mund të emërojë më shumë se gjysmën e organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës të sipërmarrjes.

Lista shteruese e këtyre sipërmarrjeve përfshihet në aplikimin për koncesion. Kjo listë përditësohet pas çdo ndryshimi vijues në marrëdhënien ndërmjet sipërmarrjeve.

Neni 64

Publikimi i njoftimit

1. Koncesionarët për punë të cilët nuk janë autoritete kontraktuese dhe që dëshirojnë të shpallin kontrata fituese për punë të një palë e tretë e bëjnë të ditur synimin e tyre me anë të një njoftimi.

2. Njoftimet përfshijnë informacionin e përmendur në Shtojcën VII C dhe sipas rastit, çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga koncesionari i punës sipas formularit standard të miratuar nga Komisioni në përputhje me procedurën e nenit 77 pika 2.

3. Njoftimi publikohet sipas nenit 36 pikat 2 deri në 8.

4. Zbatohet gjithashtu neni 37 për publikimin vullnetar të njoftimeve.

Neni 65

Afatet kohore për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje dhe marrjen e ofertave

Në kontrata për punë të shpallura fituese nga një koncesionar për punë, i cili nuk është autoritet kontraktues, afati kohor i caktuar nga koncesionari për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje nuk është më pak se 37 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës, dhe afati kohor për marrjen e ofertave nuk është më pak se 40 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës ose ftesës për ofertë.

Zbatohet neni 38 pikat 5, 6 dhe 7.

TITULLI IV RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONKURSET E PROJEKTIMIT

Neni 66

Dispozita të përgjithshme

1. Rregullat për organizimin e konkurseve të projektimit janë në përputhje me nenet 66 deri në 74 dhe u komunikohen të interesuarve për pjesëmarrje në konkurs.
2. Pranimi i pjesëmarrësve në konkurse projektimi nuk kufizohet:
 - (a) lidhur me territorin ose pjesën e territorit të një Shteti Anëtar;
 - (b) për arsyet që, sipas ligjit të Shtetit Anëtar ku është organizuar konkursi, atyre do t'u kërkohej të ishin persona fizikë ose juridikë.

Neni 67

Fusha e veprimit

1. Në përputhje me këtë titull, konkurset e projektimit organizohen nga:
 - (a) autoritetet kontraktuese që janë renditur si autoritete të qeverisjes qendrore në Shtojcën IV, duke filluar nga kufiri minimal i barabartë me ose më i madh se 162 000 euro;
 - (b) autoritetet kontraktuese që nuk janë renditur në Shtojcën IV, duke filluar nga kufiri minimal i barabartë me ose më i madh se 249 000 euro;
 - (c) nga të gjitha autoritetet kontraktuese duke filluar nga kufiri minimal i barabartë me ose më i madh se 249 000 euro, nëse konkursi ka të bëjë me shërbimet në kategorinë 8 të Shtojcës II A, kategorinë 5 shërbime telekomunikacionit, pozicionet e të cilave në FPP janë të njëjta me numrat e referencës CPC 7524, 7525 dhe 7526 dhe/ose shërbimet e renditura në Shtojcën II B.
2. Ky titull zbatohet për:
 - (a) konkurset e projektimit të organizuara si pjesë e një procedure që con në shpalljen fituese të një kontrate publike për shërbime;
 - (b) konkurse projektimi me çmime dhe/ose pagesa për pjesëmarrësit.Në rastet e përmendura në shkronjën (a), kufiri monetar është vlera e çmuar pa TVSH e kontratës publike për shërbim, përfshirë çmimet e mundshme dhe/ose pagesat për pjesëmarrësit.
Në rastet e përmendura në shkronjën (b), kufiri monetar është shuma totale e çmimeve dhe pagesave, përfshirë vlerën e çmuar, pa TVSH të kontratës publike për shërbim, që rrjedhimisht mund të lidhet sipas nenit 31 pika 3 nëse autoriteti kontraktues nuk përjashton shpalljen e kontratës fituese në njoftimin e konkursit.

Neni 68

Përjashtime nga fusha e veprimit

Ky Titull nuk zbatohet për:

- (a) konkurse projektimi sipas kuptimit të Direktivës 2004/17/KE të cilat janë organizuar nga autoritetet kontraktuese që kryejnë një ose më shumë veprimtari të përmendura në nenin 3 deri në 7 të asaj direktive dhe që organizohen për ndjekjen e këtyre veprimtarive; nuk zbatohet as për konkurset e përjashtuara nga fusha e veprimit të kësaj direktive.
Megjithatë, kjo direktivë vazhdon të zbatohet për konkurset e projektimit të shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese që kryejnë një ose më shumë nga veprimtaritë e përmendura në nenin 6 të Direktivës 2004/17/KE dhe të shpallura fituese për këto veprimtari, në masën që Shteti Anëtar në fjalë përfiton nga mundësia e përmendur në paragrafin e dytë të nenit 71 të kësaj direktive që të shmangë zbatimin e saj.
- (b) konkurset që janë organizuar në të njëjtat raste siç përcaktohet në nenet 13, 14 dhe 15 të kësaj direktive për kontrata publike për shërbim;

Neni 69

Njoftimet

1. Autoritetet kontraktuese që dëshirojnë të organizojnë një konkurs projektimi bëjnë të ditur synimin e tyre me anë të një njoftimi për konkurs.

2. Autoritetet kontraktuese që kanë zhvilluar një konkurs projektimi dërgojnë një njoftim për rezultatin e konkursit në përputhje me nenin 36 dhe duhet të jenë në gjendje të provojnë datën e dërgimit.

Ky informacion nuk duhet publikuar nëse dhënia e informacionit për rezultatin e konkursit do të pengonte zbatimin e ligjit, do të ishte në kundërshtim me interesin publik, do të prekte ligjshmërinë e interesave tregtare të një ndërmarrjeje të veçantë, private apo publike, ose do të mund të prekte konkurrencën e ndershme ndërmjet ofruesve të shërbimit.

3. Neni 37 për publikimin e njoftimeve zbatohet gjithashtu për konkurset.

Neni 70

Forma dhe mënyra e publikimit të njoftimeve të konkurseve

1. Njoftimet e përmendura në nenin 69 përmbajnë informacionin e përmendur në Shtojcën VII D në përputhje me modelin e njoftimeve standarde të miratuara nga Komisioni në përputhje me procedurën në nenin 77 pika 2.

2. Njoftimi publikohet sipas nenit 36 pikat 2 deri në 8.

Neni 71

Mjetet e komunikimit

1. Neni 42 pikat 1, 2 dhe 4 zbatohet për të gjitha komunikimet në lidhje me konkurset.

2. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit janë të tilla që të sigurojnë ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të të gjithë informacionit të komunikuar nga pjesëmarrësit në konkurs, dhe që juria të sigurojë përmbajtjen e planeve dhe projekteve vetëm pas mbarimit të afatit kohor për paraqitjen e tyre.

3. Rregullat e mëposhtme zbatohen për pajisjet për marrjen elektronike të planeve dhe projekteve:

(a) në dispozicion të palëve vihet informacion në lidhje me specifikimet që është i nevojshëm për prezantimin e planeve dhe projekteve me mjete elektronike, duke përfshirë kodimin. Gjithashtu, pajisjet për marrjen elektronike të planeve dhe projekteve plotësojnë kërkesat e Shtojcës X;

(b) Shtetet Anëtare mund të prezantojnë ose të mbajnë rregulla vullnetare për akreditimin që synojnë përmirësimin e nivelit të shërbimit të certifikimit të ofruar për këto pajisje.

Neni 72

Përzgjedhja e konkurrentëve

Nëse konkurset e projektimi kufizohen me një numër të kufizuar pjesëmarrësish, autoritetet kontraktuese përcaktojnë kritere të qarta dhe mosdiskriminuese përzgjedhjeje. Në çdo rast, numri i kandidatëve të ftuar për të marrë pjesë është i mjaftueshëm për të siguruar konkurrencën e vërtetë.

Neni 73

Përbërja e jurisë

Juria përbëhet ekskluzivisht nga persona fizikë që janë të pavarur nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse pjesëmarrësve në konkurs u kërkohet një kualifikim i veçantë profesional, të paktën një e treta e anëtarëve të jurisë duhet ta ketë këtë kualifikim ose një kualifikim të njëjtë.

Neni 74

Vendimet e jurisë

1. Juria është autonome në vendimet ose opinionet e saj.
2. Ajo shqyrton planet dhe projektet e paraqitura nga kandidatët në mënyrë anonime dhe vetëm në bazë të kritereve të përcaktuara në njoftimin e konkursit.
3. Ajo shënon renditjen e projekteve në një raport, të nënshkruar nga anëtarët e saj, të bazuar në meritat e çdo projekti, së bashku me shënimet dhe çdo pikë që mund të kërkojë qartësim.
4. Anonimiteti duhet të respektohet deri në marrjen e një opinionit ose vendimi nga juria.
5. Kandidatët mund të ftohen, nëse është nevoja, t'u përgjigjen pyetjeve që juria ka shënuar në procesverbal për të qartësuar çdo aspekt të projekteve.
6. Bisedimet ndërmjet anëtarëve të jurisë dhe kandidatëve mbahen në procesverbal.

TITULLI V

DETYRIMET STATISTIKORE, KOMPETENCAT EKZEKUTIVE DHE DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 75

Detyrime statistikore

Për të lejuar vlerësimin e rezultateve të zbatimit të kësaj direktive, Shtetet Anëtare i dërgojnë Komisionit një raport statistikor, të përgatitur në përputhje me nenin 76, që trajton në mënyrë të veçantë kontratat për punë, shërbime dhe furnizime publike të shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit të mëparshëm, jo më vonë se 31 tetori i çdo viti.

Neni 76

Përmbajtja e raportit statistikor

1. Për çdo autoritet kontraktues të përmendur në Shtojcën IV, raporti statistikor detajon të paktën:
 - (a) numrin dhe vlerën e kontratave të shpallura fituese që mbulon kjo direktivë;
 - (b) numrin dhe vlerën e plotë të kontratave të shpallura fituese sipas derogimeve nga Marrëveshja. Sa është e mundur, të dhënat e përmendura në shkronjën (a) të paragrafit të parë ndahen:
 - (a) sipas procedurave të shpalljes fituese të kontratës që janë përdorur; dhe
 - (b) për secilën nga këto procedura, sipas punëve siç jepen në Shtojcën I dhe produkteve dhe shërbimeve siç jepen në Shtojcën II të identifikuara sipas kategorisë së nomenklaturës FPP;
 - (c) sipas shtetësisë së operatorit ekonomik që fiton kontratën.Nëse kontratat janë lidhur sipas procedurës me negociim, të dhënat e përmendura në shkronjën (a) të paragrafit të parë ndahen gjithashtu sipas rrethanave të përmendura në nenet 30 dhe 31 dhe specifikojnë numrin dhe vlerën e kontratave të shpallura fituese, nga Shteti Anëtar dhe vendi i sipërmarrësit të suksesshëm.
2. Për çdo kategori të autoritetit kontraktues që nuk është paraqitur në Shtojcën IV, raporti statistikor detajon të paktën:
 - (a) numrin dhe vlerën e kontratave të shpallura fituese, të ndara sipas paragrafit të dytë të pikës së parë;
 - (b) vlerën e plotë të kontratave të shpallura fituese sipas derogimeve nga Marrëveshja.
3. Raporti statistikor paraqet çdo informacion tjetër statistikor të nevojshëm sipas Marrëveshjes. Informacioni i përmendur në paragrafin e parë përcaktohet sipas procedurës në nenin 77 pika 2.

Neni 77

Komiteti Këshillimor

1. Komisioni ndihmohet nga Komiteti Këshillimor për kontratat publike i krijuar me nenin 1 të Vendimit 71/306/KEE [25] (quajtur më poshtë “Komiteti”).
2. Nëse përmendet kjo pikë zbatohen nenet 3 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.
3. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

Neni 78

Rishikimi i kufijve monetarë

1. Komisioni verifikon kufijtë monetarë të përcaktuara në nenin 7 çdo dy vjet nga hyrja në fuqi e kësaj direktive dhe nëse është e nevojshme i rishikon ato në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 77 pika 2.
Llogaritja e vlerës së këtyre kufijve monetarë bazohet në vlerën mesatare ditore të euros, të shprehur në SDR, gjatë 24 muajve në përfundim të ditës së fundit të gushtit që i paraprin rishikimit, i cili hyri në fuqi që nga 1 janari. Vlera e kufijve monetarë të rishikuar, kur është e nevojshme, rumbullakoset me të mjtën euro më të afërt, për të siguruar respektimin e kufijve monetarë në fuqi të parashikuar nga marrëveshja, të shprehura në SDR.
2. Komisioni, në të njëjtat afate kohore si ato të përmendura për rishikimin sipas pikës 1, në përputhje me procedurën sipas nenit 77 pika 2, harmonizon:
 - (a) kufijtë monetarë të përcaktuar në shkronjën (a) të paragrafit të parë të nenit 8, në nenin 56 dhe paragrafin e parë të nenit 63 pika 1 për kufirin monetar të rishikuar që zbatohet për kontratat për punë publike;
 - (b) kufijtë monetarë të përcaktuar në shkronjën (b) të paragrafit të parë të nenit 8 dhe në nenin 67 pika 1 shkronja (a) për kufirin monetar të rishikuar që zbatohet për kontratat për shërbime publike të lidhura nga autoritetet kontraktuese të përmendura në Shtojcën IV;
 - (c) kufirin monetar të përcaktuar në nenin 67 pika 1 shkronjat (b) dhe (c) për kufirin monetar të rishikuar që zbatohet për kontratat publike për shërbime të shpallura fituese nga autoritetet kontraktuese që nuk janë përfshirë në Shtojcën IV.
3. Vlera e kufijve monetarë e përcaktuar në përputhje me pikën 1 në valutë kombëtare të Shteteve Anëtare që nuk marrin pjesë në bashkimin monetar, normalisht rishikohet çdo dy vjet nga data 1 janar 2004 e më tej. Llogaritja e kësaj vlere bazohet në vlerat mesatare ditore të këtyre valutave, të shprehura në euro, gjatë 24 muajve që përfundojnë ditën e fundit të gushtit që i paraprin rishikimit i cili hyn në fuqi nga 1 janari.
4. Kufijtë monetarë të rishikuar të përmendur në pikën 1 dhe vlerat përkatëse të tyre në valutë kombëtare të përmendur në pikën 3 publikohen nga Komisioni në Gazetën Zyrtare të Bashkimit European në fillim të muajit nëntor pas rishikimit të tyre.

Neni 79

Ndryshimet

1. Në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 77 pika 2, Komisioni mund të ndryshojë:
 - (a) procedurat teknike për metodat e llogaritjes të përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit 78 pika 1 dhe në nenin 78 pika 3;
 - (b) procedurat për hartimin, dërgimin, marrjen, përkthimin, mbledhjen dhe shpërndarjen e njoftimeve të përmendura në nenin 35, 58, 64 dhe 69 dhe raportet statistikore të parashikuara në paragrafin e katërt të nenit 35 pika 4 dhe në nenin 75 dhe 76;
 - (c) procedurat për përmendjen në mënyrë specifike në njoftimet, të zërave specifike në nomenklaturën FPP;
 - (d) listën e organeve dhe kategorive të organeve që rregullohet nga e drejta publike në Shtojcën III, nëse kjo rezulton e nevojshme, në bazë të njoftimeve nga Shtetet Anëtare;

- (e) listën e autoriteteve të qeverisjes qendrore në Shtojcën IV, në vijim të përshtatjeve të nevojshme për të bërë të efektshme Marrëveshjen;
- (f) numrat e referencës në nomenklaturën e paraqitur në Shtojcën II, në masën që kjo të mos ndryshojë qëllimin material të kësaj direktive, dhe procedurat për t'ju referuar në njoftime zërave të veçantë të kësaj nomenklature;
- (g) numrat e referencës në nomenklaturën e paraqitur në Shtojcën II, në masën që kjo të mos ndryshojë qëllimin material të kësaj direktive, dhe procedurat për t'ju referuar në njoftime zërave të veçantë në këtë nomenklaturë brenda kategorive të shërbimeve të renditura në Shtojcë;
- (h) procedurat për dërgimin dhe publikimin e të dhënave të përmendura në Shtojcën VIII për arsye të progresit teknik ose për arsye administrative;
- (i) detajet teknike dhe karakteristikat e pajisjeve për marrjen elektronike të përmendura në shkronjat (a), (f), dhe (g) në Shtojcën X;

Neni 80

Zbatimi

1. Shtetet Anëtare miratojnë ligje ose akte nënligjore të nevojshme për të zbatuar këtë direktivë jo më vonë se data 31 janar 2006. Shtetet Anëtare menjëherë njoftojnë Komisionin për këto masa. Nëse Shtetet Anëtare miratojnë masa të tilla, ato duhet ta përmendin shprehimisht këtë direktivë ose kjo direktivë duhet të përmendet shprehimisht në rastin e publikimit të tyre zyrtar. Metodatat se si do të bëhet ky referim përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të së drejtës së brendshme që ato miratojnë në fushën që mbulon kjo direktivë.

Neni 81

Mekanizmat e monitorimit

Në përputhje me Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989, që koordinon ligjet dhe aktet nënligjore në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për shpalljen fituese të kontratave për punë dhe furnizime publike [26], Shtetet Anëtare sigurojnë zbatimin e kësaj direktive me mekanizma të efektshme, të disponueshme dhe transparente.

Për këtë qëllim, ato mes të tjerash emërojnë, ose krijojnë një organ të pavarur.

Neni 82

Shfuqizime

Shfuqizimi i Direktivës 92/50/KEE, përveç nenit 41 të saj dhe Direktivës 93/36/KEE hyn në fuqi nga data e treguar në nenin 80, pa cenuar detyrimet e Shteteve Anëtare në lidhje me afatet e përcaktuara në Shtojcën XI për transpozimin dhe aplikimin.

Referencat për direktivat e shfuqizuara interpretohen si referenca që i bëhen kësaj direktive dhe lexohen në përputhje me tabelën e përputhshmërisë në Shtojcën XII.

Neni 83

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi ditën e publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 84

Adresa

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Strasburg, më 31 mars 2004.

Për Parlamentin Europian

Presidenti
P. Cox

Për Këshillin
Presidenti
D. Roche

- [1] GZ C 29 E, 30.01.2001, fq. 11 dhe GZ C 203 E, 27.08.2002, fq. 210.
[2] GZ C 193, 10.07.2001, fq. 7.
[3] GZ C 144, 16.05.2001, fq. 23.
[4] Opinioni i Parlamentit European, datë 17 janar 2002 (GZ C 271 E, 07.11.2002, fq. 176), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit, datë 20 mars 2003 (GZ C 147 E, 24.06.2003, fq.1) dhe Qëndrimi i Parlamentit European, datë 2 korrik 2003 (e papublikuar ende në Gazetën Zyrtare). Rezoluta Legjislative e Parlamentit European, datë 29 janar 2004, dhe Vendimi i Këshillit, datë 2 shkurt 2004.
[5] GZ L 209, 24.07.1992, fq. 1. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Direktiva e Komisionit 2001/78/KE (GZ L 285, 29.10.2001, fq 1).
[6] GZ L 199, 09.08.1993, fq. 1. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Direktiva e Komisionit 2001/78/KE .
[7] GZ L 199, 09.08.1993, fq. 54. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Direktiva e Komisionit 2001/78/KE.
[8] GZ L 336, 23.12.1994, fq. 1.
[9] Shihni faqen 1 të kësaj Gazete Zyrtare.
[10] GZ L 199, 9.8.1993, fq. 84. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Direktiva e Komisionit 2001/78/KE (GZ L 285, 29.10.2001, fq 1).
[11] GZ L 18, 21.01.1997, fq. 1.
[12] GZ L 340, 16.12.2002, fq. 1.
[13] GZ L 13, 19.1.2000, fq. 12.
[14] GZ L 178, 17.07.2000, fq. 1.
[15] Direktiva e Këshillit 2000/78/KE, datë 27 nëntor 2000, që përcakton një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion (GZ L 303, 02.12.2000, fq.16).
[16] Direktiva e Këshillit 76/207/KEE, datë 9 shkurt 1976, për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në lidhje me aksesin në punësim, formimin profesional dhe promovimin dhe kushtet e punës (GZ L 39, 14.02.1976, fq. 40). Direktivë e ndryshuar së fundi nga Direktiva 2002/73/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 269, 05.10.2002, fq.15).
[17] Rregullorja (KE) nr. 761/2001 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 19 mars 2001, që lejon pjesëmarrje vullnetare nga organizatat në një skemë komunitare të eko-menaxhimit dhe kontrollit (EMAS) (GZ L 114, 24.04.2001, fq.1).
[18] GZ L 184, 17.07.1999, fq. 23.
[19] GZ L 124, 08.06.1971, fq. 1.
[20] GZ L 351, 29.12.1998, fq. 1.
[21] GZ C 195, 25.06.1997, fq. 1.
[22] GZ L 358, 31.12.1998, fq. 2.
[23] GZ C 316, 27.11.1995, fq. 48.
[24] GZ L 166, 28.06.1991, fq. 77. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Direktiva 2001/97/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 4 dhjetor 2001 (GZ L 344, 28.12.2001, fq.76).
[25] GZ L 185, 16.08.1971, fq. 15. Vendim i ndryshuar nga Vendimi 77/63/KEE (GZ L 13, 15.01.1977, fq. 15).
[26] GZ L 395, 30.12. 1989, fq. 33. Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 92/50/KEE.

SHTOJCA I

Lista e veprimtarive të përmendura në nenin 1 pika 2, shkronja (b) [1]

KSVE (1)

KODI FPP			SEKSIONI F		NDËRTIMI
Ndarja	Grupi	Klasa	Lënda	Shënime	
45			Ndërtim	Kjo ndarje përfshin: ndërtimin e ndërtesave dhe veprave të reja, restaurimin dhe riparime të zakonshme	45000000
	45.1		Përgatitja e objektit		45100000

		45.11	Shembja dhe trajtimi i rrënojave; lëvizja e dherave	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> — shembjen e ndërtesave dhe strukturave të tjera — pastrimin e objektit të ndërtimit — lëvizjen e dherave: gërmimi, fusha e groposjes, nivelimi dhe gradimi i objekteve të ndërtimit — gërmimi i hendekëve, zhvendosja e gurëve, shpërthimi, etj. — përgatitjen e objektit për shfrytëzim mineral: zhvendosja e mbingarkesave dhe zhvillimeve të tjera dhe përgatitja e zonave dhe pronave minerare <p>Kjo klasë përfshin gjithashtu:</p> <ul style="list-style-type: none"> — ndërtimin e sistemit të kullimit të objektit — kullimin e tokave bujqësore dhe pyjore 	45110000
		45.12	Shpimi provë dhe shpimi me sondë	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> — shpimin provë, shpimin provë me sondë dhe marrjen e mostrave kryesore për qëllime ndërtimi, gjeofizike, gjeologjike dhe të ngjashme <p>Kjo klasë përjashton:</p> <ul style="list-style-type: none"> — shpimin për naftë prodhimi ose të gazit, shiko klasën 11.20 — shpimin e puseve të ujit, shiko klasën 45.25 — gërmimin e puseve, shiko klasën 45.25 — eksplorimin për fusha të naftës dhe gazit, studimin sizmik, gjeologjik dhe gjeofizik shiko klasën 74.20 	45120000
	45.2		Ndërtim i ndërtesave të plota ose pjesëve të tyre; inxhinieri civile		45200000

KSVE (1)

Kodi FPP			SEKSIONI F		NDËRTIMI
Ndarja	Grupi	Klasa	Lënda	Shënime	

		45.21	Ndërtim i përgjithshëm i ndërtesave dhe veprave inxhinierike civile	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <p>ndërtimin e të gjitha llojeve të ndërtesave, ndërtimi i ndërtesave inxhinierike civile, ura, duke përfshirë ato për autostrada të ngritura, viadukte, tunele dhe nënkalime tubacione të distancave të gjata, linja të energjisë elektrike dhe komunikimit tubacione urbane, komunikacioni urban dhe linjat e energjisë elektrike</p> <p>vepra urbane ndihmëse</p> <p>montimi dhe ngritja e ndërtesave të parafabrikuara në vend</p> <p>Kjo klasë përjashton:</p> <p>veprimtari shërbimi sipas rastit në nxjerrje e naftës dhe gazit, shiko klasën 11.20</p> <p>ngritjen e ndërtesave të parafabrikuara të përfunduara nga pjesë të prodhuara vetë jo prej betoni, shiko ndarjet 20, 26 dhe 28</p> <p>punët e ndërtimit, përveç ndërtesave, për stadiume, pishina, palestra, fusha tenisi, fusha golfi dhe instalime të tjera sportive, shiko klasën 45.23</p> <p>instalime ndërtese, shiko grupin 45.3</p> <p>përfundim ndërtese, shiko grupin 45.4</p> <p>veprimtari arkitekturore dhe inxhinierike, shiko klasën 74.20</p> <p>menaxhim projekti për ndërtim, shiko klasën 74.20</p>	45210000
		45.22	Ngritja e mbulimit të tarracës dhe e karabinasë	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <p>ngritjen dhe mbulimin e taracës, dhe izolimin nga uji</p>	45220000
		45.23	Ndërtimi i autostradave, rrugëve, aeroporteve dhe objekteve sportive	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <p>ndërtimi i autostradave, rrugëve, rrugëve të tjera të këmbësorëve dhe të mjeteve ndërtimi i hekurudhave ndërtimi i pistave të aeroporteve</p> <p>punët e ndërtimit, përveç ndërtesave, për stadiume, pishina, palestra, fusha tenisi, fusha golfi dhe instalime të tjera sportive</p> <p>vendosjen e sinjalistikës horizontale në rrugë dhe parqe makinash</p> <p>Kjo klasë përjashton:</p> <p>zhvendosjen paraprake e dherave, shih klasën 45.11</p>	45230000

KSVE (1)

KODI FPP			SEKSIONI F		NDËRTIMI
Ndarja	Grupi	Klasa	Lënda	Shënime	

		45.24	Përgatitja e projekteve të ujit	Kjo klasë përfshin ndërtimin e: rrugëve ujore, limaneve dhe veprave lumore, porteve të jahteve, portave, etj. punëve të thellimit me dragë nën sipërfaqet e digave dhe moleve	45240000
		45.25	Punë ndërtimi të tjera që përfshijnë zanatet e veçanta	Kjo klasë përfshin: veprimtari ndërtimi të specializuara në një aspekt të përbashkët për lloje të ndryshme strukturash që kërkojnë aftësi ose pajisje të specializuara: ndërtimin e themeleve, duke përfshirë vendosjen e shtyllave shpimin dhe ndërtimin e puseve të ujit, gjurmimin e puseve ngritjen e elementeve të çelikut që nuk prodhohen vetë përkuljen e çelikut shtrimin i tullave dhe vendosjen e gurëve ngritjen dhe çmontimin e skelave dhe platformave të punës, duke përfshirë marrjen me qira të skelave dhe platformave të punës ngritjen e oxhakëve dhe furrave industriale Kjo klasë përjashton: marrjen me qira të skelave pa ngritje dhe çmontim, shiko klasën 71.32	45250000
	45.3		Instalimet e ndërtesës		45300000
		45.31	Instalimi i telave dhe montimeve elektrike	Kjo klasë përfshin: instalimin në ndërtesë ose projekte të tjera ndërtimi të: telave dhe montimeve elektrike, sistemeve të telekomunikacionit, sistemeve elektrike të ngrohjes, antenave rezidenciale, alarmeve të zjarrit sistemeve të alarmit kundër vjedhjes, ashensorëve dhe shkallëve lëvizëse, përçuesve të ndriçimit, etj.	45310000

KSVE (1)

KODI FPP			SEKSIONI F		NDËRTIMI
Ndarja	Grupi	Klasa	Lënda	Shënime	
a					

		45.32	Veprimtari të punës izoluese	Kjo klasë përfshin: instalimi në ndërtesë ose projekte të tjera ndërtimi të izolimit termik, akustik ose kundër dridhjes Kjo klasë përfshin: përfshihet: izolimi kundër ujit, shiko klasën 45.22	45320000
		45.33	Puna hidraulike	Kjo klasë përfshin: instalimin në ndërtesë ose projekte të tjera ndërtimi të: pajisjeve hidraulike dhe sanitare, montimeve të gazit ngrohjes, ventilimit, ftohjes ose -- pajisjeve të ajrit të kondicionuar dhe sistemeve të spërkatësve kundër zjarrit Kjo klasë përfshin: instalimin e sistemeve elektrike të ngrohjes	45330000
		45.34	Instalime të tjera të ndërtesës	Kjo klasë përfshin: instalimin e sistemeve të ndriçimit dhe të sinjalizimit për rrugë, hekurudha, aeroporte dhe limane instalimin në ndërtesë ose projekte të tjera të montimeve dhe pajisjeve n.e.c.	45340000
	45.4		Përfundimi i ndërtesës		45400000
		45.41	Suvatimi	Kjo klasë përfshin: vendosjen në ndërtesë dhe projekte të tjera ndërtimi të suvatimit dhe stukimit të brendshëm dhe të jashtëm , duke përfshirë veshjen me listela	45410000
		45.42	Instalime mobilierie	Kjo klasë përfshin: instalimi i dyerve që nuk prodhohen vetë, dritareve, kornizat e dyerve dhe dritareve, kuzhinat e montuara, shkallët, montimet e dyqaneve dhe si këto, të drurit dhe materialeve të tjera përfundimi i të brendshmes si tavane, mbulesa muresh druri, ndarje të lëvizshme, etj. Kjo klasë përfshin: përfshihet: shtrimin e parketit dhe të mbulesave të dyshemeve të drurit, shiko ndarjen 45.43	45420000

KSVE (1)

KODI FPP			SEKSIONI F		NDËRTIMI
Ndarja	Grupi	Klasa	Lënda	Shënime	

	45.43	Mbulesa dysHEMEJE dhe muri	Kjo klasë përfshin: shtrimin, vënien, varjen dhe montimin në ndërtesa ose projekte të tjera ndërtimi të: mureve të qeramikës, betonit ose gurit të prerë ose pllakave të dyshemesë parketin dhe mbulesat e tjera të dyshemesë, mbulesat me qilima dhe me lino, duke përfshirë të gomës dhe plastikës mbulesa dysHEMEJE ose muri prej teracoje, mermeri, graniti ose ardëze letrat e murit	45430000
	45.44	Lyerja dhe vendosje e xhamave	Kjo klasë përfshin: lyerjen e pjesëve të brendshme dhe të jashtme të ndërtesave, lyerjen e strukturave inxhinierike civile, instalimin e xhamave, pasqyrave, etj. Kjo klasë përjashton: instalimin e dritareve, shiko klasën 45.42	45440000
	45.45	Përfundime të tjera të ndërtimit	Kjo klasë përfshin: instalimin e impiantit të pastrimit me avull të pishinave private, shpërthimin e rërës dhe veprimtari të ngjashme për ndërtimin e pjesëve të jashtme punë të tjera të përfundimit të ndërtimit n.e.c. Kjo klasë përjashton: pastrimin e brendshëm të ndërtesave dhe strukturave të tjera	45450000
	45.5	Marrja me qira e pajisjeve të ndërtimit dhe shembjes me përdorues		45500000
	45.50	Marrja me qira e pajisjeve të ndërtimit dhe shembjes me operator	Kjo klasë përjashton: Marrja me qira e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit dhe shembjes pa operator	45500000

(1) Në rast të një dallimi në interpretim ndërmjet FPP dhe KSVE, zbatohet nomenklatura KSVE.

[1] Rregullore e Këshillit (KEE) nr. 3037/90, datë 9 tetor 1990 për klasifikimin statistikor të veprimtarive ekonomike në Komunitetin Europian (GZ L 293, 24.10.1990, fq. 1), Rregullore e ndryshuar nga Rregullorja e Komisionit (KEE) nr. 761/93 (GZ L 83, 03.04.1993, fq. 1).

SHTOJCA II Shërbime të përmendura në nenin 1 pika 2 shkronja (d)

SHTOJCA II A[1]

Kategoria nr.	Lënda	Numri i referencës CPC (1)	Numri i referencës FPP
1	Shërbime mirëmbajtjeje dhe riparimi	6112, 6122, 633, 886	Nga 50100000 deri në 50982000 (me përjashtim të 50310000 deri në 50324200 dhe 50116510-9, 50190000-3, 50229000-6, 50243000-0)
2	Shërbimet e transportit rrugor (2), duke përfshirë shërbimet me automjet të blinduar dhe shërbimet e shpejta, me përjashtim të transportit të postës	712 (me përjashtim të 71235), 7512, 87304	Nga 60112000-6 deri në 60129300-1 (me përjashtim të 60121000 deri në 60121600, 60122200-1, 60122230-0), dhe nga 64120000-3 deri në 64121200-2

3	Shërbimet e transport ajror të udhëtarëve dhe mallrave, me përjashtim të transportit të postës	73 (me përjashtim të 7321)	nga 62100000-3 deri në 62300000-5 (me përjashtim të 62121000-6, 62221000-7)
4	Transporti rrugor (3) dhe ajror i postës	71235), 7321	60122200-1, 60122230-0 62121000-6, 62221000-7
5	Shërbimet e telekomunikacioneve	752	Nga 64200000-8 deri në 64228200-2 72318000-7, dhe nga 72530000-9 deri në 72532000-3
6	Shërbime financiare: (a) Shërbime sigurimesh (b) Shërbime bankare dhe investimesh (4)	me përjashtim të 81, 812, 814	Nga 66100000-1 deri në 66430000-3 dhe Nga 67110000-1 deri në 67262000-1 (4)
7	Shërbime kompjuterike dhe të lidhura me to	84	Nga 50300000-8 deri në 50324200-4, Nga 72100000-6 deri në 72591000-4 (me përjashtim të 72318000-7 dhe nga 72530000-9 deri në 72532000-3)
8	Shërbime kërkimi dhe zhvillimi (5)	85	Nga 73000000-2 deri në 73300000-5 (me përjashtim të 73200000-4, 73210000-7, 7322000-0)
9	Shërbime e kontabilitetit, auditimit dhe llogarimbajtjes	862	Nga 74121000-3 deri në 74121250-0
10	Shërbime e kërkimit të tregut dhe sondazhit të opinionit publik	864	Nga 74130000-9 deri në 74133000-0 dhe 74423100-1, 74423110-4
11	Shërbimet e konsultimit të menaxhimit (6) dhe shërbimet e lidhura me to	865, 866	Nga 73200000-4 deri në 73220000-0, Nga 74140000-2 deri në 74150000-5 (me përjashtim të 74142200-8) dhe 74420000-9, 74421000-6, 74423000-0, 74423200-2, 74423210-5, 74871000-5, 93620000-0,

Kategoria nr.	Lënda	Numri i referencës CPC (1)	Numri i referencës FPP
12	Shërbime arkitekturore; shërbime inxhinierike dhe shërbime inxhinierike të integruara; shërbime urbanistike dhe të inxhinierisë së peizazhit; shërbime të lidhura me konsultimin shkencor dhe teknik; shërbime të testimit teknik dhe analizës	867	Nga 74200000-1 deri në 74276400-8 dhe Nga 74310000-5 deri në 74323100-0 dhe 74874000-6
13	Shërbime publiciteti	871	nga 74400000-3 deri në 74422000-3 (me përjashtim të 74420000-9, 74421000-6)
14	Shërbime të pastrimit të ndërtesave dhe shërbime të menaxhimit të pronës	874, 82201 82206	Nga 70300000-4 deri në 70340000-6 dhe Nga 74710000-9 deri në 74760000-4
15	Shërbime botimi dhe shtypshkrimi me bazë tarife ose kontrate	88442	Nga 78000000-7 deri në 78400000-1

16	Shërbime të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe asgjësimi të mbeturinave; shërbime sanitare dhe të ngjashme	94	Nga 90100000-8 deri në 90320000-6 dhe 50190000-3, 50229000-6, 50243000-0,
----	---	----	---

(1) Nomenklatura CPC (versioni i përkohshëm), i përdorur për të përcaktuar fushën e veprimit të Direktivës 92/50/KEE.

(2) Me përjashtim të shërbimeve të transportit hekurudhor të mbuluara nga kategoria 18.

(3) Me përjashtim të shërbimeve të transportit hekurudhor të mbuluara nga kategoria 18.

(4) Me përjashtim të shërbimeve financiare në lidhje me lëshimin shitjen, blerjen, ose transferimin e letrave me vlerë instrumente financiare të tjera, dhe shërbime të bankës qendrore. Përjashtohen gjithashtu: shërbimet që përfshijnë blerjen ose qiramarrjen, sipas çfarëdo procedure financiare, të toke, ndërtese ekzistuese, ose prone tjetër të paluajtshme ose që lidhen me të drejta të tyre; megjithatë, shërbimet financiare të ofruara në të njëjtën kohë, para ose pas kontratës së blerjes ose qiramarrjes në çfarëdo, formë, i nënshtrohen kësaj direktive.

(5) Me përjashtim të shërbimeve të kërkimit dhe zhvillimit të ndryshme nga ato ku the përfitimet i shtohen ekskluzivisht për autoritetin kontraktues për përdorim në drejtimin e çështjeve të veta me kusht që shërbimi i ofruar të shpërblehet plotësisht nga autoriteti kontraktues.

(6) Me përjashtim të shërbimeve të arbitrazhit dhe të pajtimit.

[1] Në rast se ka ndonjë ndryshim në interpretim ndërmjet nomenklaturës FPP dhe CPC, përdoret nomenklatura CPC.

SHTOJCA II B

Kategoria nr.	Lënda	Numri i referencës CPC	Numri i referencës FPP
17	Shërbime hotelerie dhe restoranti	64	Nga 55000000-0 deri në 55524000-9 dhe Nga 93400000-2 deri në 93411000-2
